



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Integritit European
Ministarstvo Evropske Integracije - Ministry of European Integration

**Plani i veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-
Asociimit**

Dhjetor 2012
Prishtinë

Fjala hyrëse e Kryeministrit



Në rrjedhën e një dekade, Republika e Kosovës është ballafaquar me shumë sfida të thella dhe komplekse.

Dalë nga një shtet i shkatërruar nga lufta, të shpartalluar nga regjimi shtypës, dhe duke u ngjitur në një demokraci funksionale, me institucione të qëndrueshme dhe ekonomi të tregut të lirë, ku liria e fjalës, fesë, dhe të drejtat e tjera themelore janë garantuar në një mënyrë jo të lehtë. Megjithatë, ne ia arritëm.

Më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Deri më sot, pavarësia e Kosovës është njohur nga gjithsej 95 vende, nga të cilat 22 janë Shtete Anëtare të BE-së. Republika e Kosovës është anëtare në institucionet kryesore ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, etj.

Sot, ne jemi përpara një agimi të ri për Republikën e Kosovës. Një epoke të re. Një epoke të Integritimit Evropian. Kosova fuqimisht beson që *Evropianizimi* është mënyra më e mirë për të ecur përpara në përmirësimin e standardeve të jetesës dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik për të gjithë qytetarët. Perspektiva e anëtarësimit në BE është me rëndësi të madhe strategjike për Kosovën.

Procesi i Evropianizimit është më shumë se vetëm miratimi i *acquis* së BE-së dhe përmbushjes së normave dhe standardeve të BE-së. Në shtete të ndryshme si Polonia, Hungaria, dhe Estonia me trashëgimi të ndryshme historike dhe ekonomike dhe tradita politike, procesi i anëtarësimit në BE ka sjellë një transformim të shpejtë të marrëdhënieve shtet-qytetar, reformë të qëndrueshme të administratës publike dhe një cikël të drejtë të zhvillimit ekonomik, investime të huaja direkte dhe zbutjen e varfërisë duke arritur grupet më të rrezikuara dhe zonat e largëta. Fuqia e njëjtë transformuese e procesit të integritimit evropian në mënyrë të barabartë ka çuar në ndryshime pozitive në fqinjësinë tonë të afërt.

Këshilli i Bashkimit Evropian, më 11 Dhjetor 2012, ka konfirmuar që Kosova do të fillojë negociatat për MSA-në, pasi që standardet për fillimin e tyre janë përmbushur. Kjo do të shënojë një hap të madh drejt marrëdhënieve Kosovë-BE.

Qeveria ka shprehur vazhdimisht përkushtimin e saj të lartë për agjendën e BE-së - në vepra, po aq sa edhe me fjalë. Bërthama e përkushtimit tonë qëndron në mbështetjen e madhe të qytetarëve tanë për reformat që do të transformojnë vendin tonë në një anëtar krenar të familjes Evropiane.

Ekziston një rrugë e gjatë përpara nesh. Sundimi i Ligjit është prioritet kyç. Ne jemi të vendosur që të tregojmë përkushtimin tonë të patundur në fushën e sundimit të ligjit duke themeluar një dosje të besueshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Shërbimi publik dhe funksionimi efektiv i shtetit mbështetet në një administratë publike profesionale, efikase dhe transparente. Ne kemi vënë në vend një legjislacion të fuqishëm dhe modern për të

siguruar respektimin e minoriteteve dhe të drejtave themelore. Reformat strukturore ekonomike do të ulin rolin jo-efikas të shtetit dhe do të krijojnë një mjedis miqësor të biznesit për agjentët ekonomikë. Ne jemi duke zbatuar projekte infrastrukturore që do të jenë thelbësore për zhvillimin tonë ekonomik.

Në fjalën përmbyllëse, unë do të doja të shprehë falënderimet e mia për të gjithë kolegët që kanë punuar shumë në përgatitjen e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Plani i Veprimit për MSA-në përfaqëson përgjigjen e Qeverisë për vizionin e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Progresi përgjatë linjave që kemi përshkruar në këtë dokument do të sjellë qytetarët më afër BE-së dhe sigurojë që Kosova është një vend më i mirë, i ancoruar vendosmërisht në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

Hashim Thaçi

Kryeministri i Republikës së Kosovës

1.Kriteret Politike.....	15
1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit.....	15
1.1.1. Legjislativi.....	15
1.1.2. Ekzekutivi dhe Presidenca	16
1.1.3. Administrata Publike	17
1.1.4. Sektori i sigurisë.....	19
1.1.5. Sistemi gjyqësor	20
1.1.6. Lufta kundër korrupsionit	22
1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare.....	23
1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	24
1.2.1. Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale	24
1.2.2. Respektimi dhe Mbrojtja e Pakicave dhe të Drejtave Kulturore	26
2. KRITERET EKONOMIKE	28
2.1. Situata dhe stabiliteti ekonomik.....	28
2.1.1. Situata ekonomike	28
2.1.2. Politikat fiskale.....	30
2.2. Liberalizimi i tregut dhe çmimeve.....	31
2.3. Privatizimi, zhvillimi i sektorit privat dhe reforma financiare.....	32
2.3.1. Privatizimi dhe zhvillimi i sektorit privat	32
2.3.2. Reforma e sektorit financiar	34
3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR OBLIGIMET QË DALIN NGA MSA-ja.....	35
3.1. Dialogu politik.....	35
3.2. Bashkëpunimi regjional.....	35
3.3. Lëvizja e lirë e mallrave	36
Politika tregtare	36
Tregtia me mallra industriale	38
Tregtia me mallra bujqësore dhe peshkimit	39
3.4. Levizja e lire e punetoreve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit.....	41
3.4.1. Lëvizja e lire e punëtorëve	41
3.4.2. E drejta e themelimit (establishment)	42
3.4.3. Tregtia e shërbimeve	43
3.4.4. Pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e lire e kapitalit.....	44
3.5. Përafrimi, implementimi dhe përforsimi i legjislacionit.....	45
3.5.1. Konkurenca	45
3.5.2. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.....	47
3.5.3. Prokurimi Publik	48
3.6. Drejtësia dhe çështjet e brendshme.....	52

3.6.1. Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit.....	52
3.6.2. Azili, migrimi, politika e vizave, kontrolli i kufijve	53
3.6.3. Shpërlarja e parave	54
3.6.4. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin.....	56
3.7. Politika e bashkëpunimit	57
3.7.1. Bashkëpunimi ekonomik, monetar, statistikor dhe mbrojtja e interesit financiar të BE-së	57
Statistikat	57
3.7.2. Promovimi dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, NVM-të dhe turizmi	58
3.7.3. Bujqësia	61
3.7.4. Doganat, Tatimet dhe kontrolli financiar.....	61
3.7.4.1. Doganat	64
3.7.4.2. Tatimet.....	65
3.7.4.3. Kontrolli Financiar	66
3.7.5. Punësimi, politika sociale, politika e shëndetit publik, arsimit dhe trajnimit dhe hulumtimi i teknologjisë dhe zhvillimi	68
3.7.5.1. Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik	68
3.7.5.2. Arsimit, trajnimit, hulumtimi dhe inovacioni	72
3.7.6. Shërbimet kulturore, audio vizuale, të telekomunikacionit, postare dhe shoqëria informative	73
3.7.7. Transporti	76
3.7.8. Energjia, përfshirë sigurinë bërthamore.....	78
3.7.9. Mjedisi	78
3.8. Bashkëpunimi financiar.....	80

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKMDhP	Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
AMPSK	Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara
APP	Agjencia për Prokurim Publik
AP	Avokati i Popullit
APIK	Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
ARBK	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (<i>Central European Free Trade Agreement</i>)
DK	Doganat e Kosovës
DML	Departamenti i Mjekësisë Ligjore
DPI	Departamenti i Pronësisë Intelektuale
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (<i>European Common Aviation Area</i>)
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GP	Grupi Punues
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
IFS	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IBA	Zonë e rëndësishme e Zogjve (<i>Important Bird Area</i>)
IPA	Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimit
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi/et Komunal/e
KKK	Korniza e Kurrikulumi të Kosovës
KKDFE	Kompania Kosovare e Distributimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike
KNF	Kualifikimi ndërkombëtarë për funksionalitet

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPIS	Sistemi i identifikimit të parcelave të tokës(<i>Land Parcel Identification System</i>)
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administrates Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFSK	Ministria e Forcës dhe Sigurisë
MIE	Ministria e Integrimit European
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPF	Monitorimi i Punës së Fëmijëve
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PV	Plani i Veprimit
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

SHKCAK	Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
TQNJ	Trafikimi me Qenie Njerëzore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPI	Zyra për Pronësi Industriale
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

Marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian

Në vitin 1999, BE-ja propozoi themelimin e Procesit të Stabilizim Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, si kornizë për udhëzimin e përpjekjeve për anëtarësim.

Në Nëntor të vitit 2000, procesi i Stabilizim Asociimit zyrtarisht u fillua në samitin e Zagrebit. Në Zagreb, BE-ja nënvizoi se perspektiva Evropiane e vendeve të Ballkanit perëndimor do të përcaktohet në bazë të progresit të tyre drejt një demokracie të qëndrueshme, sundimit të ligjit ekonomisë të tregut dhe bashkëpunim regjional. Këshilli i Evropës në Selanik i mbajtur në Qershor të vitit 2003, konfirmoi se e ardhmja e vendeve të Ballkanit perëndimor është në BE.

Që nga Selaniku, Kosova është e përfshirë në kornizën e procesit të Stabilizim Asociimit. Në Prill të vitit 2005, Komisioni Evropian ka miratuar komunikatën "E Ardhmja Evropiane për Kosovën". Në vitin 2006, Këshilli ka miratuar Partneritetin e parë Evropian. Partneriteti i dytë Evropian për Kosovën është miratuar në vitin 2008. Si një përgjigje kundrejt prioritetëve të Partneritetit Evropian, Qeveria ka miratuar Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian në vitin 2008, dhe e ka rishikuar atë çdo vit, pas publikimit të Raportit të Progresit.

Më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës shpalli Kosovën si shtet të pavarur. Që nga 16 Dhjetori 2012, nëntëdhjetë e pesë (95) shtete e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Në Tetor 2009, KE ka publikuar Komunikatën "Kosova - Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane" në të cilën Komisioni Evropian ka propozuar thellimin dhe forcimin e perspektivës Evropiane të Kosovës.

Iniciativat kryesore sipas propozimit ishin: (1) Përmirësimi i dialogut politik dhe teknik në Procesin e Dialogut të Stabilizim Asociimit; (2) Dialogu i vizave me perspektivë të liberalizimit eventual të vizave; (3) Zgjerimi i Masave Tregtare Autonome dhe marrëveshja e mundshme tregtare me Bashkimin Evropian; (4) Korniza e marrëveshjes me Kosovën mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së saj në programet e Komunitetit; (5) Aktivizimi i komponentit IPA për bashkëpunim ndër-kufitar (komponenti II).

Megjithatë, Kosova ende nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Kushtet për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me shtetet e Ballkanit Perëndimor janë vendosur në Konkluzionet e Këshillit të Prillit të vitit 1997. Elementet kryesore përfshijnë një angazhim të besueshëm për të ndërmarrë reformat demokratike, respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, minoritetet dhe lirinë e shprehjes, dhe zgjedhjet e rregullta dhe të lira. Në këmbim të përputhjes me kushtet përkatëse, BE-ja i ofron vendeve kryerjen e marrëdhënieve kontraktuale profesionale: Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit.

Në këtë aspekt, në Tetor të vitit 2012 Komisioni Evropian ka publikuar studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Dokumenti përshkruan progresin që Kosova ka arritur në tre vitet e fundit dhe shqyrton nëse Kosova është e gatshme për të filluar negociimin e një MSA-je. Studimi konfirmoi se Kosova "...është kryesisht e gatshme për të filluar negociatat për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit."

Megjithatë, në mënyrë që të fillojnë negociatat për MSA-në, Kosova duhet të vazhdojë mirëbesimin e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të arritura në mes të Beogradit dhe Prishtinës

deri më tani dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive në gamën e plotë të çështjeve me anë të lehtësimit të BE-së.

Në këtë kuptim, Komisioni do të propozojë direktiva të negociimit për një marrëveshje të tillë, pasi që Kosova të ketë përmbushur prioritetet afatshkurtra në fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së minoriteteve dhe të tregtisë.

Në këtë aspekt, më 12 Dhjetor 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme mbajti shënim të Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) në mes të BE-së dhe Kosovës dhe qëllimit të Komisionit për të propozuar direktiva të negociimit për MSA-në, pasi që Kosova të ketë përmbushur prioritetet afatshkurtra, të cilat janë identifikuar në Studimin e Fizibilitetit.

Këshilli arriti në përfundim që do të vendosë të hapë negociatat për një MSA me Kosovën, në bazë të një raporti të paraqitur nga ana e Komisionit dhe HR/VP në vjeshtë të vitit 2013. Këshilli do të vlerësojë raportin gjatë Presidencës së ardhshme. Duke pasur parasysh që vlerësimi është pozitiv, Këshilli do të miratojë direktivat e negociimit.

Në Janar të vitit 2012, Komisioni Evropian ka vendosur të fillojë dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën. Më 14 Qershor 2012, KE ka dorëzuar një udhërrëfyes për liberalizimin e vizave. Krah për krah kësaj ngjarje është mbajtur edhe Takimi i Lartë Zyrtar. Më 1 Shtator 2012, Kosova ka dorëzuar raportin e parë të gatishmërisë në KE. Pritet që KE-ja do të japë vlerësimin e parë të zbatimit të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave në Janar të vitit 2013.

Rezulton që nga përvoja e negociatave të mëparshme të anëtarësimit, BE-ja ka prezantuar një qasje të re në negociatat për gjyqësorin dhe të drejtat themelore dhe mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, dhe i ka dhënë një rol të rëndësishëm çështjeve të sundimit të ligjit, duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në qendër të politikës së zgjerimit të BE-së. Qasja e re siguron trajtimin e çështjeve të përmendura më lartë në fazat e hershme të procesit të zgjerimit.

Në vazhden e kësaj, KE-ja dhe Kosova kanë nisur një Dialog të Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit më 30 Maj 2012. Dialogu i Strukturuar do të ofrojë një forum të nivelit të lartë me një objektiv të dyfishtë: (1) vendosja e prioritetëve për reforma në fushën e sundimit të ligjit, dhe (2) monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i progresit të Kosovës drejt përmbushjes së prioritetëve. Puna e nën-komitetit të DPSA-së mbi Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, si dhe takime të rregullta të Bordit të Përbashkët për Koordinim mbi Sundimin e Ligjit që do të shërbejnë si forume përcjellëse në objektiven e dyfishtë të Dialogut të Strukturuar. Takimi tjetër i Dialogut të Strukturuar do të mbahet në Shkurt të vitit 2013.


Më 16 Dhjetor 2012, Bordi i Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka vendosur që të lejojë Kosovën të bëhet anëtare e BERZH-it. Ky nuk është vetëm shembulli i fundit i përparimit të Kosovës drejt integritit në komunitetin ndërkombëtar, por kjo gjithashtu do të lejojë që Kosova të përfitojë nga një financim më i madh dhe do të kontribuojë në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës.

Në Dhjetor të vitit 2009 Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme ka mirëpritur Komunikatën e lëshuar në muajin Tetor të vitit 2009 “Kosova – Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane” dhe, në mes të tjerash, ka ftuar Komisionin për të hapur pjesëmarrjen e Kosovës në programet e Bashkimit. Në Dhjetor të vitit 2012, Këshilli i Punëve të Jashtme ka autorizuar Komisionin të hapë negociatat mbi një marrëveshje kornizë në emër të Unionit (BE-së) me Kosovën dhe të kthehet prapa tek Këshilli në gjysmën e parë të vitit 2013.

Që nga viti 2010, Komisioni dhe Kosova kanë përfunduar tre cikle të Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit. Takimet e nën-komitetit të DPSA-së mbahen në shtatë fusha tematike dhe gjetjet e tyre janë të përmbledhura në takimin vjetor plenar të DPSA-së. DPSA-ja ka dëshmuar një mekanizëm efektiv për monitorimin dhe këshillimin e Kosovës mbi masat që duhet të ndërmerren për të zbatuar agjendën e saj reformuese Evropiane.

BE-ja mbetet donatori më i madh në Kosovë, duke siguruar më shumë burime për kokë banori në Kosovë sesa në çdo vend tjetër të botës. BE-ja është duke mbështetur Kosovën përmes disa instrumenteve të ndryshme të financimit: Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillimi dhe Stabilizimi (CARDS), Instrumenti për Stabilitet (IfS), dhe Instrumenti për Ndhimën e Para-Anëtarësisimit (IPA). Nga viti 1999 deri në vitin 2011, BE-ja ka dhënë mbi 2.3 miliardë € të ndihmës financiare dhe afërsisht 1 miliard € në mbështetje të pranisë ndërkombëtare në Kosovë.

Në konferencën e donatorëve për Kosovën për vitin 2008, Komisioni premtoi një shumë prej më shumë se 500 milion €. Në kornizën financiare 2007-2013, BE-ja ka vënë në dispozicion më shumë se 630 € milion për Kosovën nën IPA. Ndhimja IPA aktualisht është kryesisht e përqendruar mbi sundimin e ligjit, ekonominë, tregtinë dhe industrinë, dhe reformën e administratës publike. Në përputhje me komunikatën e Komisionit të lëshuar në Tetor të vitit 2009 “Kosova – Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane” dhe mbi konkluzionet e Këshillit mbi Çështjet e Përgjithshme në Dhjetor të vitit 2009 Komponenti për Bashkëpunim Ndërkufitar IPA (komponenti II) është aktivizuar për Kosovën në vitin 2010. Për të rritur përfshirjen e shoqërisë civile në dialogun politik dhe të zhvillimit të Kosovës, një shumë prej 3.3 milion € është vënë në dispozicion nën Programin e Asistencës për Shoqërinë Civile 2011 -2013.



Grafi 1: Asistenca Financiare e BE-së për Kosovën (planifikuar dhe ndarë për periudhën 2007 - 2012, në miliona €)

Komponentët	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Ndihma Tranzicionale dhe Faza e Ndërtimit të Institucioneve	68,3	184,7	106,1	66,1	66,9	68,2
Bashkëpunimi ndërkufitar	0	0	0	1,2	1,8	1,8
GJITHSEJ	68,3	184,7	106,1	67,3	68,7	70,0

Kosova ka një rrugë të gjatë dhe të vështirë në udhëtimin e saj drejt anëtarësimit të BE. Megjithatë, reformat që kemi përpara janë para së gjithash në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Ambiciet evropiane të Kosovës gëzojnë mbështetje të fortë nga publiku i gjerë në Kosovë.

Studimi i Fizibilitetit i KE-së për vitin 2012 dhe konkluzionet e Dhjetorit të vitit 2012 kanë vendosur një rrugë të qartë për pranimin e Kosovës në BE. Në bazë të procesit të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor ekziston një numër i madh i hapave formal që do të shënojnë rrugën e integritimit Evropian të Kosovës në BE:

1. Komisioni Evropian vlerëson që Kosova ka përmbushur kriteret e hapjes së negociatave për MSA-në;
2. Mandati i Këshillit të KE-së për të filluar negociatat për MSA-në me Kosovën;
3. Negociatat e MSA-së kanë përfunduar dhe MSA-ja është nënshkruar (pjesa e përkohshme hyn në fuqi);
4. Zbatimi i kënaqshëm i MSA-së dhe aplikimi për statusin e kandidatit;
5. Përgjigja e pyetësorit dhe mendimi i KE-së mbi aplikimin (avis);
6. Këshilli vendos për dhënien e statusit të kandidatit dhe i jep KE-së mandatin për të filluar bisedimet e pranimit;
7. Shqyrtimi dhe negociimi i kapitujve individual përmes konferencave ndërqeveritare;
8. Përfundimi i negociatave dhe mendimi i KE-së mbi gatishmërinë e Kroacisë për të hyrë në BE;
9. Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit dhe statusi i shtetit anëtar;
10. Anëtarë i BE-së.

Metodologjia dhe Struktura e Planit të Veprimit të MSA-së

Plani i Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Plani i Veprimit MSA) paraqet strategjinë kyçe të Qeverisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Në këtë rol Plani i Veprimit të MSA-së është një pasardhës i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) dhe ndërtohet mbi strukturën di -si (know-how) atë institucionale dhe strukturën politike të themeluar përgjatë viteve.

Plani i Veprimit për MSA-n përfaqëson një sërë masash prej 200 të programuara dhe të përshtatshme, implementimi i të cilave përmbush dy objektiva kyçe: (1) përmbushja e standardeve për fillimin e negociatave për MSA-në; dhe (2) zbatimi i detyrimeve që do të merren përsipër nga MSA-ja.

Bazat për përgatitjen e Planit të Veprimit për MSA-në kanë qenë:

- Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës si dhe Stafi shoqërues në Përpunimin e Dokumentit;
- Prioritetet e Partneritetit Evropian 2008;
- Raporti i Progresit 2011;
- Konkluzionet e Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit 2012;
- Konkluzionet e Dialogut të Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit;
- Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave.

Gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit për MSA-në, nën koordinimin e Ministrisë së Integrimeve Evropiane, janë ofruar të dhëna nga të gjitha institucionet shtetërore. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Financave, Plani i Veprimit për MSA-në është harmonizuar me Ligjin mbi Buxhetin 2013, Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2013, dhe Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2013.

Plani i Veprimit për MSA-në është i ndarë në dy pjesë kryesore: (1) përshkrimi dhe (2) tabela e veprimeve.

Pjesa përshkruese e Planit të Veprimit për MSA-në ka tre pjesë: (1) Kriteret Politike; (2) Kriteret Ekonomike; dhe (3) Aftësia për të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja.

Secila pjesë e përshkrimit, përveç kriterit ekonomik ofron (4) lloje të të dhënave:

1. Progresin e bërë në kapitullin përkatës në drejtim të zbatimit ligjor, institucional dhe të implementimit të politikave;
2. Sfidat kryesore që kapitulli përkatës ballafaqohet në zbatimin ligjor, institucional dhe të politikave;
3. Hapja e etapës për fillimin e negociatave për MSA-së dhe përshkrimi i masave që duhet të ndërmerren (nëse hapja e etapës është identifikuar në kapitullin përkatës);
4. Një objektivë që duhet të plotësohet në mënyrë që të merren përsipër detyrimet nën MSA-në dhe përshkrimi i masave që duhet të ndërmerren.

Si shtojcë e këtij dokumenti është një tabelë e detajuar e veprimeve që qartazi identifikon objektivat që duhet të plotësohen, masat që duhet të merren, institucionet përgjegjëse, afatin e zbatimit dhe koston financiare.

Plani i Veprimit MSA ka një total prej 200 masave, nga të cilat 47 masa janë nën kapitullin e kriterëve politike, 19 nën kapitullin e kriterëve ekonomike dhe rreth 133 nën aftësitë për të marrë përsipër detyrimet që rezultojnë nga kapitulli MSA.

Në përputhje me parimet SMART, janë ngritur tregues të matshëm të nivelit të aktivitetëve. Kostoja e përgjithshme e Planit të Veprimit për MSA-në është vlerësuar të jetë 740,746,749.15 €; nga të cilat 583,996,308.65 € janë planifikuar të mbulohen nga buxheti kombëtar 76,390,410.00 € nga donatorët; me hendekun financiar prej 80,360,030.50 €.

Plani i Veprimit për MSA-në do të shërbejë si strategji kyçe e Qeverisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE; si e tillë ajo do të shërbejë si një pikë referimi për institucionet shtetërore kur të vendoset për prioritetet vjetore, planet e rekrutimit, planet strategjike për investime, planet për TI dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, ndihmën e donatorëve, si dhe komunikimin dhe

aktivitetet informuese. Kjo qasje do të sigurojë që masat e marra janë jetësuar nga angazhimet e bëra në këtë dokument.

Monitorimi dhe Rishikimi i Planit të Veprimit për MSA-në

Pasi që të miratohet Plani i Veprimit i MSA-së nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet që të dorëzohet për komente tek Komisioni Evropian. Pasi që të merren, komentet e KE-së do të jenë pjesë integrale e dokumentit.

Monitorimi i Planit të Veprimit të MSA-së do të bëhet me anë të monitorimit elektronik dhe sistemit të raportimit që është zhvilluar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian. Që nga viti 2010, Ministria e Integritimit Evropian ka përdorur bazën sistematike të të dhënave M&R për përgatitjen e raporteve zyrtare për Komisionin Evropian. Për më tepër, që nga viti 2012, Ministria e Integritimit Evropian ka filluar hartimin e raporteve statistikore tremujore që janë diskutuar rregullisht në mbledhjen e Qeverisë.

Në përputhje me praktikën e vendosur, të gjitha veprimet përcjellëse që do të rrjedhin nga cikli i DSPA-së i vitit 2013 do të integrohen në kuadër të sistemit të monitorimit dhe raportimit të Planit të Veprimit për MSA-në .

Strukturat e integritimit për koordinim evropian – Këshilli Ministror, Grupi Punues dhe 7 Komisione Ekzekutive- do të shërbejnë si një mekanizëm institucional mbështetës që do të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Veprimit për MSA-në.

Në mënyrë që të sigurohet që Plani i Veprimit i MSA-së mbetet një dokument i gjallë, ai duhet që të rishikohet rregullisht.

Duke marrë parasysh rëndësinë e dokumentit, Plani i Veprimit për MSA-në do të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për informacion.

1. Kriteret Politike

1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit

1.1.1. Legjislativi

Kushtetuta e Kosovës mishëron parimet dhe vlerat më të larta të demokracisë, duke përcaktuar rendin kushtetues parlamentar në të cilën Kuvendi luan rolin kryesor ligjvënës si dhe ushtron rol mbikëqyrës mbi Ekzekutivin. Korniza institucionale për legjislacion dhe kontroll të ekzekutivit është në vend dhe funksionale. Funksionet e proceseve legjislative si dhe kontrollit të ekzekutivit ushtrohen përmes Komisioneve Parlamentare, prej të cilave 4 janë Komisione të përhershme, 9 janë Komisione funksionale, 1 Komision ad-hoc dhe 1 nën-komision i përcaktuar për mandate, imunitete dhe rregullore të punës. Rol të rëndësishëm në ndërtimin e rendit dhe funksionimit demokratik ka luajtur Gjykata Kushtetuese, vendimet e së cilës janë respektuar dhe janë zbatuar me përpikëri nga Kuvendi dhe institucionet tjera. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në vjeshtën e viti 2010, Presidenti i Kosovës dha dorëheqje. Gjykata luajti rol të rëndësishëm edhe në procesin e rizgjedhjes së Kryetarit të Republikës së Kosovës i cili u rizgjodh në përputhje me Kushtetutën.

Legjislatura e Kuvendit zgjidhet përmes votës së lirë të qytetarëve, një e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve tjera në fuqi. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme (nr. 03/L-073) dhe ligjin për Zgjedhjet Lokale (nr. 03L-072) të cilat definojnë procedurat e zgjedhjeve për zgjedhjen e organeve qendrore dhe lokale si dhe të drejtën e votuesit që të votoj. Që nga 2008 janë organizuar një palë zgjedhje të përgjithshme si dhe dy palë zgjedhje për komunat e Kosovës. Kushtetuta e Kosovës garanton përfaqësimin etnik si dhe përfaqësimin gjinor në Kuvend. Nga 120 vende në Kuvend, 20 janë të garantuara për minoritete. Numri aktual i përfaqësimit etnik është 26 deputet apo 21.6%. Ndërsa 40 janë anëtare femra që përbëjnë 33.3% të numrit total të deputeteve.

Kuvendi në masë të madhe ka forcuar kapacitetet e saj administrative si dhe është përmirësuar në masë të madhe përgatitja e legjislacionit si dhe mbikëqyrja e Kuvendit. Kuvendi që nga 2008 e deri me sot ka miratuar 352 ligje.

Megjithatë, mbesin sfida të cilat vështirësojnë funksionimin më adekuat të Kuvendit. Reforma Kushtetuese dhe ajo Zgjedhore janë të ndërlidhura dhe ngecjet në këtë drejtim shkaktojnë vonesa në reforma demokratike, në funksionimin e rendit kushtetues si dhe në reformë të sistemit zgjedhor në Kosovë. Plani Strategjik i Kuvendit 2013-2018, si dhe Rregullorja e Re e Kuvendit ende nuk janë miratuar. Kapacitetet e Kuvendit për monitorim dhe hulumtime mbeten të mangëta, sidomos Departamenti i Kuvendit për Çështje Ligjore dhe Procedurale. Procedura legjislative duhet të forcohet për të siguruar ekspertizë ndër-sektoriale dhe përputhshmëri me *acquis*. Koordinimi mes Kuvendit dhe Qeverisë ka nevojë të përmirësohet, dhe njëkohësisht Kuvendi ka nevojë të rris mbikëqyrjen dhe kontrollin e shpenzimeve buxhetore të Ekzekutivit. Mungon baza ligjore për statusin e shërbyesve civil e cila në një masë të madhe do të siguronte pavarësinë e shërbyesve civil si dhe do të rregullonte funksionet dhe mandatin e shërbyesve civil të Kuvendit.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova do të angazhohet për forcimin e mëtejshëm të parimeve demokratike të qeverisjes së saj. Respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe të sundimit të ligjit në përgjithësi do të formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve në një MSA-së.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*, Kuvendi do të shtoj përpjekjet e saj për përmbylljen e procesit të Reformës Kushtetuese dhe asaj Zgjedhore. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, Kuvendi do të miratoj Projekt-ligjin për statusin e shërbyesve civil të Kuvendit, Planin Strategjik të Kuvendit 2013-2018, Rregulloren e Re në përputhje me mandatin e legjislativit, si dhe do të miratoj planin strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore. Për të përmirësuar koordinimin mes kuvendit dhe ekzekutivit, kuvendi do të emëroj një zyrtarë të lartë që në bashkëpunim me koordinatorin e emëruar nga qeveria do të koordinojnë procesin legjislativ dhe planin e punës së kuvendit dhe ekzekutivit. Kuvendi do marr masa që në përputhje me mandatin e saj të ngrit kapacitetet për përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis* si dhe monitorimin e implementimit të politikave.

1.1.2. Ekzekutivi dhe Presidenca

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbën bazën ligjore për strukturën dhe funksionimin e Qeverisë, për me tepër struktura dhe funksionet e Qeverisë rregullohen me Ligjin për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës si dhe Rregullorja për Rregullat e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për fushëveprimin e Përgjegjësive Administrative të zyrës së Kryeministrit.

Institucionet kyçe përgjegjëse për koordinimin e planifikimit strategjik, koordinimin e politikave si dhe strategjisë legjislative të qeverisë janë në vend dhe funksionale. Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) ka për qëllim ngritjen kapaciteteve për planifikim strategjik dhe monitorim. Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ), është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve mes Zyrës së Kryeministrit dhe pjesës tjetër të administratës. Sekretariati i Qeverisë së bashku me ZPS-në është përgjegjës për koordinimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës, bazuar në inputet e të gjitha ministrive dhe organeve të tjera ekzekutive. Plani vjetor i punës është i përbërë nga Planit i Punës së Qeverisë dhe Planit i Punës së Ministrive. Zyra e Kryeministrit përgatit Programin vjetor legjislativ të qeverisë, e cila rrjedh nga Plani Vjetor i Punës së Qeverisë. Ky program është përgatitur nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatën e Qeverisë, Ministrinë e Financave, ZPS-në dhe MIE-në. Programi, që rendit legjislacionin e propozuar për vitin e ardhshëm, përcakton afatin kohor për hartimin e legjislacionit dhe institucioni/et përgjegjëse.

Qeveria ka kapacitete të mira për të hartuar legjislacionin dhe ka potencial për të rritur përafrimin e legjislacionit me *acquis* në periudhë të shkurtër kohore dhe gjithashtu koordinimi ndërministror i politikave është përmirësuar gjatë tre viteve të fundit.

Sa i përket Presidencës, Presidentja në mënyrë aktive zbaton detyrat e saj kushtetuese dhe merr hapa për të kundërshtuar legjislacionin në qoftë se nuk është në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane. Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm në procesin e decentralizimit, për derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka ndërmarrë hapa për të siguruar një monitorim më efikas të strukturave të qeverisjes lokale. Në përgjithësi Kosova ka vendosur institucionet e nevojshme të ekzekutivit dhe ka pasur edhe stabilitet të mjaftueshëm politik që ka mundur përparim në procesin e reformave të saj.

Megjithatë Kosova ka nevojë që të përmirësoj ende qeverisjen e saj me fokus të veçantë në zbatimin e agjendës ambicioze të reformave të BE-së. Qeveria duhet të sigurojë që agjenda e saj

legjislative më mirë të korrespondoj me kapacitetet e ministrive individuale dhe me buxhetin në dispozicion. Koordinimi mes qeverisë dhe Kuvendit gjithashtu ka nevojë për forcim të mëtutjeshëm. Përpjekjet për zbatimin e decentralizimit duhet të vazhdojnë, duke përfshirë forcimin e administratës në nivel komunal.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sipas MSA-së, Kosova do të duhet të respektoj dhe zbatoj parimet demokratike të qeverisjes. Për më tepër, qeverisja e Kosovës do të duhet të sigurohet nëpërmjet një ekzekutiv të përshtatshëm dhe më efektiv në të gjitha nivelet e administratës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Qeveria do të siguroj ngritjen kapacitetet për zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe planifikimit strategjik si dhe do të siguroj që agjenda legjislative të korrespondoj me kapacitetet individuale të ministrive dhe buxhetin aktual. Për të arritur këtë Qeveria do të bëj harmonizimin e strategjisë legjislative me planin vjetor të punës dhe buxhetin, si dhe harmonizimin e KASH-it dhe të buxheti vjetor me deklaratën e prioritetëve të Qeverisë, gjithashtu do të siguroj që plani vjetor punës të jete i bazuar në deklaratën e prioritetëve të Qeverisë dhe të prioritetëve të ministrive. Për të përmirësuar harmonizimin e legjislacionit vendor me *acquis*, koordinimin e politikave dhe absorbimin e asistencës qeveria do të miratoj draft-ligjin mbi aktet normative, rregullat e procedurës mbi aktet ligjore, si dhe do të hartoj standardet për draftim ligjor. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve , në një periudhë afatshkurtër, Qeveria planifikon të zhvilloj vlerësimin e performancës të zyrave ligjore dhe departamenteve për integrim evropian dhe koordinim të politikave në mënyrë që të rris efektshmërinë e përmbushjes së obligimeve shtetërore në kuadër të MSA. Përmes këtij mekanizmi Qeveria synon ngritjen e cilësisë si dhe përshtetimin e përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së, dhe në të njëjtën kohë përmirësimin e koordinimit dhe menaxhimit të politikave, përfshirë ngritjen e absorbimit të asistencës së BE-së.

Me qëllim forcimin e kapacitetet e administratës në nivelin lokal qeveria do të miratoj Rregulloren për performancën komunale, si dhe do të miratoj pakon e dokumenteve profesionale për zhvillimin e kapaciteteve në komuna. Gjithashtu me qëllim të përfundimit të procesin e decentralizimi Qeveria do të shtoj përpjekjet për themelimin e komunës së Mitrovicës së Veriut.

1.1.3. Administrata Publike

Administrata publike në Kosovë karakterizohet me legjislacion të avancuar primar dhe sekondar si dhe kornizën e konsoliduar afat-gjate strategjike. Tri ligjet bazike, Ligji për Shërbimin Civil, Ligji për Pagat e Shërbyesve Civil dhe Ligji mbi Administratën Shtetërore përbëjnë bazën ligjore për statusin e shërbyesve civil, respektivisht për përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, si dhe për rregullimin dhe menaxhimin e brendshëm institucional të organeve ekzekutive. Korniza Strategjike afat-mesme ndërthen në veti një plan ambicioz për ndërmarrjen e reformave të përgjithshme në nivel horizontal. Strategjia përmes 12 objektivave synon ndërmarrjen e reformave kyçe, sidomos sa i përket fushave prioritare siç janë planifikimi dhe menaxhimi i politikave, ndërlidhja mes planifikimit buxhetor me prioritetet e Qeverisë, ri-organizimit të sistemit të shërbimit civil, përmirësimin e auditimit si dhe ngritjen e cilësisë së prokurimit.

Institucionet kyçe përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e reformës së administratës publike janë të themeluara dhe funksionale. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë dhe PV për RAP është Komisioni Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike. Ndërsa, në nivel teknik strukturat për koordinim, drejtim dhe planifikim strategjik përbëhen nga trekëndëshi institucional, Ministria e Administratës Publike, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave.

Me qëllim të koordinimit të punës për zbatimin e Planit të Veprimit për Reformën e Administratës Publike është themeluar Grupi Punues me Nën-grupet e veta Punuese, të cilat korrespondojnë me 12 objektivat kyçe të strategjisë. Për secilën objektiv janë të caktuar koordinatorët përgjegjës për monitorimin e implementimit të objektivave strategjike. Departamenti për Menaxhimin e RAP-it në kuadër të MAP shërben si sekretariat i KNRAP-it dhe bartës kryesor për koordinimin dhe monitorimin e implementimit të politikave në kuadër të reformës së AP.

Edhe përkundër arritjeve të mëdha në fushën e reformave të administratës, mbesin sfida të cilat vështirësojnë implementimin më efektiv të reformave, që ndërlidhën me kompletimin e kornizës ligjore si dhe me ngritjen e kapaciteteve për monitorim dhe implementim të reformave. Edhe përkundër miratimit të legjislacionit bazik të lartpërmendur, mbetet të kompletohet baza ligjore me miratimin e Projekt-ligjit për Procedurat Administrative si dhe Projekt-ligjit mbi Qeverinë. Këto dy ligje përbëjnë bazën për shtyrjen e reformave të përgjithshme. Ndërsa sfida afatshkurta, mbeten miratimi si dhe implementimi i 3 akteve nënligjore që ndërlidhën drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit për shërbim civil dhe ligjit për pagat e shërbyesve civil. Miratimi i tyre është parakusht për hapjen e negociatave për MSA. Në aspekt të përmbushjes së sfidave afat-shkurta nga Studimi i Fizibilitetit, që drejtpërdrejt bie në fushë-përgjegjësinë e RAP, është edhe zgjidhja e përhershme për hapësira për Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe sigurimi i qëndrueshëm financiar. Në kontekst më të gjerë sfidat e ndërlidhura me IAP ndërlidhen me plotësim-ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit i cili duhet të jetë në përputhje me Rekomandimet e Venecias. Si dhe përmes miratimit të Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik. Përmes këtij të fundit, përveç tjerash, do të zgjidhej çështja e nivelit të pagave e cila do të duhej të ishte në nivel të Ministrave dhe Gjykatësve.

Ndër të tjera, sfiduese mbetet kalimi në sistemin e ri të pagave si dhe në përgatitjen e bazës ligjore që ndërlidhet me miratimin e rregulloreve të reja të brendshme të ekzekutivit në pajtim me ligjin për administratën shtetërore. Esenciale për zbatimin e reformave është alokimi i mjaftueshëm i mjeteve financiare si dhe atyre njerëzore për zbatimin e politikave. Në aspektin institucional sfida mbesin kapacitetet e limituara të administratës publike të cilat bazohen në një varg faktorësh historik, social dhe politik, siç janë mungesa e përvojës administrative dhe institucionale, sistemi arsimor në zhvillim dhe mungesa e vullnetit politik për reforma thelbësore në administratë publike. Ekzistimi i kapaciteteve efektive administrative për zbatimin e obligimeve që sjellë anëtarësimi në BE është një nga kriteret kyçe të procesit të integritit – i njohur si kriteri i Madridit.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshjen Stabilizim Asociimi, Studimit i Fizibilitetit ka identifikuar këto kriteret afat-shkurta që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

1. Miratimi i legjislacionit të nevojshëm sekondar të ligjeve të shërbimit civil dhe pagat për shërbimin civil
2. Të ndahen hapësirat për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të sigurohet pavarësia buxhetore përmes obligimit të Qeverisë që të përfshin propozim buxhetin e IAP-it, pa ndryshime eventuale, në propozim buxhetin e përgjithshëm që dorëzohet nga Qeveria në Kuvend

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit, Qeveria e Kosovës do të miratoj 3 aktet nënligjore për zbatimin e ligjit për shërbimin civil dhe ligjit për pagat e shërbyesve civil, respektivisht Projekt rregulloren për kushtet e kufizimit të se drejtës për grevë në shërbime të veçanta në Shërbimin Civil, Projekt rregulloren për procedurat e përkujdesjes për nëpunësit civil për shkak të paaftësisë fizike apo mendore ose problemeve shëndetësore, si dhe Projekt rregulloren për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë. Po ashtu, do të sigurohen hapësirat afatgjata për Avokatin e Popullit.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimi, Kosova duhet të fuqizon më tutje përkushtimin në përmirësimin e profesionalizmit, efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike në të gjitha nivelet, që është fundamentale për zbatimin e suksesshëm të reformave të nevojshme në të ardhmen. Qëllimi përfundimtar i këtyre reformave do të mundësonte funksionimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, institucionet Kosovës do të miratojnë Projektligjin për Procedurat Administrative; Projektligjin mbi Qeverinë; Projektligjin mbi Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik, Projektligjin për IKAP-in, si dhe do të plotësohet/ndryshohet Ligji për Avokatin e Popullit që të jetë në përputhje me rekomandimet e Venecias. Ndër të tjera Qeveria do të marr masa për të përshpejtuar implementimin e ligjit për pagat e shërbyesve civil, duke siguruar sistematizimin e vendeve të punës, si dhe kalimin në sistemin e ri të pagave. Qeveria do të marr masa për përshpejtimin e miratimit të rregulloreve të brendshme në pajtim me ligjin për administratë shtetërore.

1.1.4. Sektori i sigurisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe ligjet relevante, si Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës rregullojnë sektorin e sigurisë sipas standardeve më të larta demokratike. Korniza ligjore siguron dhe mundëson kontroll civil dhe demokratik mbi forcat e rendit dhe sigurisë të cilat ushtrohen përmes organit më të lartë institucional, Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht përmes Komisionit Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Politikat dhe drejtimi strategjik i sektorit të sigurisë udhëhiqet prej Këshillit të Sigurisë së Kosovës i cili kryesohet nga Kryeministri i vendit dhe nën mbikëqyrjen e Kuvendit.

Kosova është në fazën e rishikimit të sektorit të sigurisë i cili pritet të vlerësoj mjedisin e sigurisë në Kosovë dhe si rrjedhojë të prodhojë strukturën e ardhshme strategjike për sektorin e sigurisë. Ky rishikim është i planifikuar të përfundoj në verë të viti 2013.

Sfidë në sektorin e sigurisë mbetet rritja e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, si dhe ngritja e kapaciteteve mbrojtëse.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova do të ketë nevojë të forcoj edhe më tej kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Kosova do ndërmarr masa për rritje të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë. Institucionet e Kosovës do të zhvillojnë rishikimin e sektorit të sigurisë sipas planit të parashikuar, si dhe do të miratojnë Strategjinë Nacionale të Sigurisë.

1.1.5. Sistemi gjyqësor

Në sistemin gjyqësor të Kosovës gjatë viteve të fundit është evidentuar progres. Është miratuar korniza reformuese ligjore, Ligji për Gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Prokurorinë e Shtetit dhe Këshillin Prokurorial duke arritur progres substancial në reformimin dhe strukturimin e një sistemi të ri gjyqësor te pavarur, efikas dhe të paanshëm konform legjislacionit, që përbën një reformë të madhe gjyqësore dhe prokuroriale.

Janë themeluar institucionet kyçe për hartimin, monitorimin dhe implementimin e legjislacionit në fuqi, duke ri-funksionalizuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe themelimin dhe funksionalizimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Po ashtu është themeluar Gjykata Kushtetuese si autoritet përfundimtar në interpretimin e Kushtetutës dhe e pavarur në kryerjen e përgjegjësiave të saj, duke lëshuar një numër të konsiderueshëm të vendimeve me karakter politik të respektuara nga të gjitha autoritetet dhe liderët politik.

Nga viti 2011 me hyrjen në fuqi të ligjit për Gjykatat dhe Prokurorin e Shtetit ka pasur progres në përmirësimin e pagës duke i ngritur ato në nivel të kënaqshëm me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në punë. Po ashtu është evidentuar progres në drejtim të reduktimit të lëndëve të vjetra, KGJK ka miratuar Strategjinë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, duke i trajtuar 55% të 160 000 rasteve të evidentuara nga viti 2008, deri më sot.

Megjithë progresin në sistemin e gjyqësorit, sfiduese mbetet rishikimi i kornizës ligjore të paketës së gjyqësorit e cila duhet të siguroj pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e Venecias. Rishikimi i Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, duhet të sigurojë mekanizma të efektshëm në zvogëlimin e rasteve të grumbulluara dhe të pazgjidhura në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të lëndëve. Sfiduese mbetet zhvillimi i sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve si dhe ngritja e kapaciteteve për menaxhimin me sistemin e të dhënave. Në këtë aspekt sidë mbetet ndërlidhja dhe unifikimi i të dhënave të gjitha gjykatave të Kosovës si dhe ndërlidhja e sistemit me KPK. Në aspektin institucional sfidë mbetet reformimi i sistemit gjyqësor dhe forcimi i kapaciteteve të stafit administrativ. Po ashtu sfidë mbetet alokimi i mjeteve buxhetore si dhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe komunitetin pakicë për të cilat korniza ligjore rezervon një numër të konsiderueshëm të pozitave. Mungon qasje proaktive e institucioneve në iniciimin e hetimit të rasteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Esenciale mbetet qasja në drejtësi në pjesën veriore të Kosovës, sistemi gjyqësor i Kosovës ka nevojë që të përmirësojë qeverisjen e saj me fokus të veçantë qasjen e gjykatësve vendorë në Gjykatën e Qarkut në veri pasi që deri më tani kjo gjykatë posedon vetëm 6 gjyqtarë dhe 2 prokurorë ndërkombëtarë të EULEX-it, si dhe krijimi i mekanizmave për zbatimin e ligjit në hetimin dhe gjykimin e rasteve penale.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshjen Stabilizim Asociimit, Studimit i Fizibilitetit ka identifikuar këtë kritere afat-shkurtë që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

- Gjatë plotësim ndryshimit të pakos së ligjeve për reformën e gjyqësorit, të sigurohet që kompetencat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të mbesin të pa ndryshueshme

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për *hapjen e negociatave* për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Institucionet e Kosovës do të sigurojnë që gjatë fazës së plotësim ndryshimit të pakos së ligjeve të gjyqësorit të mos preken kompetencat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Kuvendi do të miratoj paketën e ligjeve të gjyqësorit duke siguruar që kompetencat e PSRK të jenë në pajtim me rekomandimet e Komisionit Evropian.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të fuqizon më tutje përkushtimin në përmirësimin e profesionalizmit, efciences dhe efektivitetit të administratës publike në të gjitha nivelet, që është fundamentale për zbatimin e suksesshëm të reformave të të nevojshme në të ardhmen. Qëllimi përfundimtar i këtyre reformave do të mundësonte funksionimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*, institucionet e Kosovës do të vazhdojnë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore në përputhje me standardet e BE-së, duke krijuar një sistem të pavarur, efikas, dhe të paanshëm me qëllim të zbatimit dhe fuqizimit të legjislacionit dhe vendimeve gjyqësore, krahas ekzekutimit të rasteve.

Pakoja reformuese e gjyqësorit do të ndryshohet, duke evituar dobësimin e sistemit të drejtësisë krahas ri-strukturimit të gjykatave. Korniza ligjore për përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së do të ndryshohet. Të gjitha procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve do të bëhen në pajtim me standardet evropiane dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, duke siguruar që shumica e anëtarëve të përzgjedhur të jenë nga ana e gjyqësorit. Me synim të zvogëlimit të rasteve të grumbulluara KGJK do të miratoj Strategjinë për Reduktimin e Lëndëve të vjetra dhe njëkohësisht do të rrit numrin e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës. Në një periudhë afat-mesme KGJK do të funksionalizoj sistemin për menaxhimin e lëndëve dhe njëkohësisht do të zhvilloj planin e trajnimeve për menaxhimin me sistemin e të dhënave.

Gjithashtu Kosova duhet të sigurojë masat mbrojtëse për gjyqtarë, prokurorë, dëshmitarë, dhe stafit të gjykatës, kundër kërcënimeve apo frikësimeve, pengimin e gjykimit të drejtë, si dhe sigurimin e hapësirave të përshtatshme në përputhje me procedurat gjyqësore në bazë të ligjit për gjykatat dhe prokuroritë. Në këtë drejtim KGJK do të nënshkruaj PSO me Policinë e Kosovës për ofrimin e mbrojtjes së afërt për gjyqtarë si dhe do të zhvilloj PSO për caktimin e masave të sigurisë për qasje në objekte të gjykatave. KGJK dhe KPK do të trajtojnë me prioritet rastet e shkeljeve disiplinore apo penale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të raportuara në komisionet disiplinore, si dhe trajtimi i rasteve të ndjeshme me karakter politik me qëllim të përmirësimit të reputacionit të sistemit gjyqësor.

Institucionet e Kosovës do të sigurojnë proaktivitet në hetime për inicimin e rasteve në çështjet për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Në këtë drejtim, Qeveria do të plotësoj/ndryshoj Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështje Penale..

1.1.6. Lufta kundër korrupsionit

Në fushën e luftimit të korrupsionit Qeveria ka krijuar kornizën e nevojshme të politikave dhe asaj ligjore kundër korrupsionit si dhe ka themeluar institucionet kyçe me qëllim të zbatimit të legjislacionit dhe politikave kundër korrupsionit. Është miratuar korniza ligjore kundër korrupsionit, , Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, , Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji për Deklarimin, origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, origjinën, dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Personat Zyrtar.

Institucionet kyçe përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e luftimit të korrupsionit janë të themeluara dhe funksionale. Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, si dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit. Ndërsa, në nivel teknik janë themeluar strukturat për koordinimin e politikave për zbatimin e legjislacionit kundër korrupsionit dhe parandalimin dhe hetimin e veprimeve korruptive. Është themeluar Task Forca kundër Korrupsionit brenda Prokurorisë Speciale dhe Këshilli Nacional Kombëtar si trup koordinues nën udhëheqjen e Presidentes që ka për qëllim bashkërendimin e punës dhe te aktiviteteteve te institucioneve e agjencive ne kuadër te kompetencave dhe te fushëveprimit te tyre.

Policia e Kosovës ka themeluar Departamentin kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, ndërsa janë krijuar struktura të përbashkëta në mes të hetuesve policorë dhe prokurorisë duke krijuar Task-forcën anti-korrupsion me qëllim të parandalimit dhe hetimit të veprimeve korruptive, krimeve ekonomike dhe atyre financiare.

Megjithatë në fushën anti-korrupsion, sfiduese mbetet përmirësimi i kornizës ligjore në luftimin e korrupsionit, dhe harmonizimi i legjislacionit me *aquis*. Në veçanti ligji për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë duhet të qartësoj mandatet e raportimit, si dhe ekzekutimin e sanksioneve më bindëse dhe proporcionale. Sfidë mbetet edhe plotësim/ndryshimi i ligjit për financimin e partive politike në mënyrë që donacionet të adresohen në formë transparente nga subjektet juridike që sigurojnë mallra dhe shërbime për administratën publike, si dhe obligimin e partive politike në hapjen e një llogarie të vetme bankare dhe përcaktimi i afateve në publikimin e raporteve financiare. Ndërsa sfidë afat-shkurtë mbetet miratimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit nga Kuvendi i Kosovës. Në aspektin institucional mbetet sfiduese mungesa e veprimeve me proaktive nga AKK pasi që mungon një mekanizëm i veçantë i hetimeve në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për *Marrëveshjen Stabilizim Asociimit*, Studimit i Fizibilitetit ka identifikuar këto kritere afat-shkurta që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

- *Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit.*

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për *hapjen e negociatave* për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Institucionet e Kosovës do të sigurohen që në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me EULEX të krijojnë mekanizma koordinues për ngritjen e hetimeve të rasteve të korrupsionit, si dhe do të merren masa për ngritjen e rezultateve në implementimin e politikave kundër-korrupsion. Kuvendi i Kosovës do të miratoj Strategjinë Kundër Korrupsion.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të fuqizon më tutje përkushtimin në përmirësimin e profesionalizmit, efciences dhe efektivitetit të administratës publike në të gjitha nivelet, që është fundamentale për zbatimin e sukseshëm të reformave të të nevojshme në të ardhmen. Qëllimi përfundimtar i këtyre reformave do të mundësonte funksionimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*, institucionet e Kosovës do të krijojnë hapa konkrete në kompletimin e kornizës ligjore në përputhje me standardet e BE-së. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit do të ndryshohet duke adresuar obligimet përkatëse të raportimit. Po ashtu do të Plotësohet/ndryshohet Ligji për Deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit, duke parashikuar ekzekutimin e sanksioneve më bindëse dhe proporcionale.

Kuvendi do të Plotësoj/ndryshoj Ligjin për Financimin e Partive Politike duke i adresuar transparencën e donacioneve nga subjektet juridike që sigurojnë mallra dhe shërbime për administratën publike, si dhe obligimin e partive politike në hapjen e një llogarie të vetme bankare dhe përcaktimi i afateve në publikimin e raporteve financiare. Po ashtu do të merren masa për krijimin e një mekanizmi të veçantë të hetimeve në mes të AKK dhe institucioneve zbatuese të ligjit që do të ndihmojë në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit.

1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare

Kosova ka plotësuar në masë të madhe të gjitha kushtet e dala nga Propozimi Gjithëpërfshirës i Pakos së Ahtisarit, dhe si rrjedhojë më 10 Shtator 2012 Grupi Drejtues Ndërkombëtar ka shpallur të përmbyllur fazën e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, dhe të mandatit të Zyrës së Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Megjithatë, Kosova ka arritur pajtim me Bashkimin Evropian për zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në Qershor të vitit 2014. Në këtë drejtim Kuvendi ka miratuar Ligjin mbi ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe BE-së mbi misionin e EULEX-it për sundim të ligjit në Kosovë. Në Nëntor 2012, Qeveria e Kosovës dhe Misioni EULEX në takimin e radhës të Bordit të Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit nënshkruan '*Kompakt Marrëveshjen për Sundimin e Ligjit*' si dhe aprovuan '*Termet e përditësuara të Referencës*' të cilat vendosin objektivat e përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit si dhe përcaktojnë mandatet e qarta për ndarjen e detyrave.

Kosova në masë të madhe ka shtuar përpjekjet për shtimin e njohjeve të Kosovës shtet të pavarur dhe si rrjedhojë numri i njohjeve ka arritur në 95. Institucionet kanë shtuar aktivitetet për anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar dhe si rrjedhojë Kosova tash është anëtare në disa organizata rajonale dhe mekanizma tjerë ndërkombëtarë. Kosova është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe e Bankës Botërore me të cilat ka marrëveshje mbështetëse. Në Nëntor të vitit 2012, Kosova ka shënuar progres të madh duke u anëtarësuar në Bankën

Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, që i mundëson Kosovës qasje në fonde për financimin e projekteve me qëllim të zhvillimit ekonomik. Kosova në vitin 2012, me sukses ka kryesuar takimet e rregullta të CEFTA-s, dhe vazhdon të jetë kontribuuese në nivel të barabartë me shtetet e tjera të rajonit.

Përkundër arritjeve në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ende mbetin sfida të cilat vështirësojnë pozitën e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Mosnjohja nga 5 vendet anëtare të BE-s paraqesin sfidë në rrugën e Kosovës drejt procesit të integritimit Evropian. Po ashtu mungesa e njohjeve të mjaftueshme pengon anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë si në OKB, OSBE apo Këshill të Evropës, si rrjedhojë Kosova nuk është në gjendje të përfitoj plotësisht nga mekanizmat e vlerësimit të konventave përkatëse.

Megjithatë për të adresuar këto sfida Qeveria e Kosovës do të shtoj aktivitetet diplomatike për shtimin e njohjeve si dhe anëtarësim në mekanizmat relevant ndërkombëtar. Qeveria do të miratoj Strategjinë e Politikës së Jashtme përmes së cilës synohet shtimi i njohjeve të reja si dhe anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtar.

1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

1.2.1. Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale

Të drejtat dhe liritë themelore tanimë kanë një bazë ligjore solide dhe rregullohen në bazë të parimeve të parapara me kushtetutë, gjegjësisht Kapitulli II-Të Drejtat dhe Liritë Themelore si dhe ligjeve tjera relevante. Kushtetuta ka të inkuorporuara marrëveshjet kryesore ndërkombëtare dhe instrumentet drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj. Kushtetuta siguron epërsinë e këtyre marrëveshjeve në rast konflikti me legjislacionin e brendshëm. Kushtetuta gjithashtu parasheh të drejtën e individëve të paraqesin para gjykatës kushtetuese shkeljet e të drejtave të tyre nga ana e autoriteteve publike si dhe Ombudspersoni mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese. Korniza bazike ligjore zgjerohet me Ligjin kundër Diskriminimit, Ligjin Kundër Dhunës në Familje, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Skemën e Asistencës Sociale, Ligjin për Asistencën Financiare Familjeve me Femijë me Aftësi të Kufizuara, Ligjin për Pensionet për Personat me Aftësi të Kufizuara, Ligjin për Aftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjin i Punës si dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur i cili gjerësisht është në përputhje me standardet e BE-së. Sa i përket dokumenteve strategjike, gjer më tani Qeveria ka miratuar Strategjinë për të Drejtat e Njeriut (tani në proces të rishikimit), Strategjinë për Persona me Aftësi të Kufizuara, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve si dhe Programin e Kosovës kundër dhunës në familje. Të gjitha këto kanë si objektiv sigurimin e mbrojtjes, monitorimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive fundamentale.

Institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtat e njeriut janë të themeluara dhe funksionale. Në nivel qendror është Zyra për Qeverisje të Mirë, pranë Zyrës së Kryeministrit, e mandatuara për ruajtjen dhe promovimin e parimeve të të drejtave dhe lirive themelore. Më tej, janë të themeluara njësitë për të drejtat e njeriut pranë institucioneve tjera në nivel qendror dhe në atë lokal. Lidhur me çështjet e barazisë gjinore, në nivel qendror e mandatuara është Agjencia për Barazi Gjinore-Zyra e Kryeministrit dhe janë caktuar zyrtare të kësaj fushe në të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe atë lokal. Për çështjen e të zhdukurve, përgjegjës është Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur, si dhe Kuvendi i Kosovës ka një

Komitet të specializuar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticione dhe ka mandat shqyrtimin e projektligjeve dhe sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin ndërkombëtarë dhe evropian.

Edhe përkundër arritjeve në fushën e të drejtave fundamentale, mbesin sfida të cilat vështirësojnë implementimin efektiv të kornizës ligjore sa i përket mbrojtjes, promovimit dhe monitorimit të të drejtave të njeriut. Shumëllojshmëria e strukturave e ndërlikon ndarjen e kompetencave qartazi mes këtyre institucioneve dhe vështirëson dukshëm efikasitetin në zbatimin e kornizës ligjore. Më shumë duhet të bëhet në fushën e lirisë së shprehjes për tu siguruar respektimi në praktikë. Rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve duhet hetuar dhe ndjekur penalisht. Gjersa, lidhur me të drejtat pronësore duhet të punohet në zbatimin dhe respektimin e tyre, zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara dhe më tej zbatimin e vendimeve gjyqësore e administrative. Ministria e Drejtësisë duhet të kompletoj legjislacionin sekondar për implementimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të rritur profesionalizmin e stafit korrektues. Në të njëjtën kohë, duhet të vazhdohet me adresimin e çështjeve të tjera si përpjekjet e mëtejshme rreth mosndëshkimit dhe qasjen në drejtësi, sidomos për grupet më të cënueshme të shoqërisë duke përfshirë viktimat e trafikimit. Për më tepër, mbetet një shqetësim humanitar fati i personave të zhdukur gjatë konflikteve në vitet 1990 (1770 raste deri në gusht 2012). Zbatimi i ligjit për mbrojtjen kundër dhunës në familje duhet të përmirësohet si dhe zbatimi i legjislacionit anti-diskriminim mbetet një sfidë. Personat me aftësi të kufizuara hasin në vështirësi sa i përket qasjes në punësim, mallra dhe shërbime, transport dhe arsim. Zbatimi i të drejtës sindikale dhe tregtare duhet të përmirësohet më tej.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, Kosova duhet të respektojë dhe zbatojë parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, sikurse përcaktohet në dokumentet kryesore ndërkombëtare siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Respektimi i parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sundimit të ligjit në përgjithësi do të formoj bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve në MSA-së. Kosova do të duhej të sigurojë të drejtat dhe liritë themelore të jenë të garantuara dhe zbatimi i tyre të përmirësohet gradualisht.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim, Qeveria e Kosovës do të ndërmerr hapat për kompletimin e kornizës ligjore me dekretimin e Kodit të ri Penal. Për tu siguruar qasja në punësim për personat me aftësi të kufizuara, Qeveria do të bëjë plotësim-ndryshimin e ligjit për aftësimin, riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara në mënyre që të sigurohet përfshirja e nevojave të veçanta gjatë hartimit të politikave të punësimin. Për më tepër, do të hartohet një rregullore e cila do të adreson çështjen e thjeshtëzimit të strukturave përgjegjëse në fushën e të drejtave të njeriut. Lidhur me bashkëpunimin rajonal për të zhdukurit, do të arrihet një memorandum mirëkuptimi me EULEX-in si dhe do të sigurohet pjesëmarrja aktive në hartimin/finalizimin e listës rajonale për personat e zhdukur. Sa i përket adresimit të të drejtave sindikale dhe tregtare Qeveria do të përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve të punës me hartimin e strategjisë për zhvillimin e Inspektoratit të Punës duke përfshirë këtu edhe planin e trajnimeve. Rreth përmirësimit të implementimit të ligjit kundër diskriminimit, do të hartohet plani i veprimit që do të mbulojë periudhën kohore 2013-2015. Ministria e Drejtësisë do të kompletoj miratimin e legjislacionit sekondar për implementimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Rreth

shërbimit korrektues, Qeveria do të vazhdojë me përmirësimin e kushteve për të burgosurit nëpër Qendrat Korrektuese dhe atyre të Paraburgimit si dhe do të hartojë plan të trajnimeve për të vazhduar me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit korrektues. Për më tepër, do të bëhet monitorim statistikor për së afërmi dhe në mënyrë të rregullt, sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative që prekin të drejtat pronësore, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që trajtojnë rastet të cilat involvojnë grupet e cenuara dhe u sigurojnë qasje në drejtësi, si dhe rastet kundër dhunës në familje. Në këtë drejtim, parashihet reformimi i sistemit përmbarues, gjë e cila do të realizohet me rastin e miratimit të Projektligjit për Procedurë Përmbarimore. Ky Ligj do të reformoj sistemin përmbarues në përputhje me kërkesat për nënshkrim të MSA. Me anë të këtij Ligji në Kosovë do të arrihet zbatimi më efikas i legjislacionit në fuqi dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të karakterit civil dhe administrativ.

1.2.2. Respektimi dhe Mbrojtja e Pakicave dhe të Drejtave Kulturore

Respektimi dhe mbrojtja e pakicave dhe të drejtave kulturore në Kosovë është e rregulluar jo vetëm me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (kapitulli III). Konventat ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës në përputhshmëri me Kushtetutën janë Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe marrëveshje tjera ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Kosovës, si aneksi mbi të drejtat kushtetuese, të drejtat e komuniteteve, decentralizimin dhe aneksi mbi trashëgiminë kulturore. Ekziston edhe legjislacioni i avancuar primar dhe sekondar që lidhet me këto të drejta. Ligjet themelore përfshijnë Ligjin mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligji për Hoqën e Madhe, Ligji për Transmetuesin Publik, Ligji për Liritë Fetare në Kosovë dhe Ligji Kundër Diskriminimit. Përveç tyre, këto të drejta janë të rregulluara edhe me legjislacion sekondar, siç është Rregullorja mbi Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Rregullorja për Zyrën e Komisionarit të Gjuhëve. Po ashtu, është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit të komuniteteve RAE dhe Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013, objektivat e të cilës janë krijimi i një komuniteti të qëndrueshëm, kthimi i qëndrueshëm dhe ri-integrimi i personave të zhvendosur brenda vendit, si dhe ri-integrimi ekonomik i komuniteteve. Për monitorimin e Strategjisë dhe Planit Nacional i Veprimit për komunitetet RAE janë themeluar Grupi Teknik Punues, i ngarkuar me monitorimin e kësaj strategjie, i cili takohet katër herë në vit, dhe Komiteti Drejtues Ndërinstitucional, i cili takohet dy herë në vit. Po ashtu, është themeluar një grup punues për reformimin e Zyrës së Komisionarit për gjuhët, i cili mbanë një numër takimesh të kryesuara nga ZÇK-ja.

Institucionet kyçe përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit, si ato në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal, janë të themeluara dhe funksionale. Në nivel qendror është Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, Këshilli Konsultativ për Komunitete (Presidenca), Komisioni Parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, si dhe Komisioni për Komunitete.

Përkundër progresit në kompletimin e kornizës ligjore dhe strategjike, sfide mbetet implementimi efikas i tyre. Veçanërisht sfida mbetet implementimi i legjislacionit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe Kishës Ortodokse Serbe, në veçanti ligjet për Qendrën Historike të Prizrenit dhe ai për Hoqën e Madhe. Po ashtu nevojitet progres i mëtejshëm në zbatimin e

Strategjisë dhe Planit të Veprimit të komuniteteve RAE, përfshirë ndarjen e fondeve të nevojshme lidhur me "Dyzet Veprimet" për të integruar komunitetin RAE. Sfidë afatshkurtër mbetet themelimi i një trupi konsultativ për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Më tej, duhet të punohet në rritjen e përfaqësimit të komuniteti pakicë në administratën publike dhe në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel institucional dhe shoqëror në tërë Kosovën. Duhet të krijohen kushte për serbët dhe për kthimin e personave që dëshirojnë të kthehen. Zyrës së Komisionarit Gjuhësor duhet t'i ndahet buxheti, stafi dhe hapësirat. Duhet të sigurohet transmetimi në gjuhën serbe nga transmetuesi publik. Sulmet fizike të motivuara në baza etnike apo fetare duhet të hetohen dhe kryerësit të sillen para drejtësisë. Qasja në arsim, lufta kundër braktisjes së shkollës, si dhe rezultatet cilësore të arsimit, duhet të plotësojnë plan programin e fundit të komunitetit rom dhe është me rëndësi që incidentet të cilat cenojnë sigurinë e lokacioneve dhe pronave të të kthyerve, të hetohen tërësisht dhe të dërgohen në gjyq.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimi, Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar këto kritere afat-shkurta që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

1. *Miratimi dhe funksionalizimi i një trupi konsultativ për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, përkatësisht të Kishës Ortodokse Serbe.*

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës do të miratojë udhëzimin administrativ për Këshillin Zbatues Monitorues, si dhe të sigurojë funksionalizimin e tij.

Në kuadër të marrëveshjes Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të respektojë dhe zbatojë të drejtat e personave që u përkasin pakicave në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Gjithashtu, Kosova duhet të ofrojë mundësinë e kthimit të personave të zhvendosur të cilët dëshirojnë të kthehen.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja Stabilizim Asociimi, institucionet e Kosovës do të bëjnë funksionalizimin e Zyrës së Komisionarit Gjuhësor, ku do të bëhet alokimi i buxhetit, hapësirave dhe burimeve njerëzore. Sa i përket mbrojtjes së Qendrës Historike të Prizrenit dhe fshatit Hoçë e Madhe, do të themelohen këshillat lokalë për implementimin e ligjeve përkatëse, si dhe do të ndahet buxheti për implementimin e tyre. Më tej do të themelohet kanali televiziv në gjuhën serbe në kuadër të transmetuesit publik. Në drejtim të integritetit të komunitetit RAE në nivel lokal dhe qendror, do të bëhet buxhetimi për implementimin e "Dyzet veprimeve" si dhe do të ngitet numri i të punësuarve nga radhët e pakicave. Në përpjekje të ofrimit të mundësive për kthim të personave të zhvendosur, do të vazhdohet me ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive, si dhe do të monitorohet numri i të kthyerve dhe projekteve të përkrahura në funksion të kthimit. Më tutje do të bëhet hetimi, përndjekja dhe gjykimi i rasteve lidhur me sulmet fizike të motivuara në baza etnike dhe fetare.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1. Situata dhe stabiliteti ekonomik

2.1.1. Situata ekonomike

Politikat zhvillimore dhe ekonomike të viteve të fundit kanë pasur për bazë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, financiar dhe konsolidimin fiskal. Kjo është reflektuar edhe në prioritetet e Qeverisë të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2013-2015. Këto prioritete fokusohen në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, fuqizimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, zhvillimin e resurseve njerëzore e fizike, dhe rritjen e mirëqenies sociale në tërësi. Financimi i këtyre prioritetëve është i përfshirë edhe në kornizën buxhetore.

Në funksion të konsolidimit fiskal, ka vazhduar të implementohet plotësisht Marrëveshja SBA me FMN. Kosova është anëtarësuar në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe është pranuar në programet e Bankës Investive Evropiane (EIB). Anëtarësimi në këta mekanizma financiare ndërkombëtar do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit duke mundësuar qasje në kredi me kushte të favorshme për ekonominë e Kosovës.

Rritja ekonomike në tri vitet e fundit ka qenë mesatarisht rreth 5%. Rritja ekonomike për vitin 2012 pritet të ngadalësohet marrë parasysh edhe ndikimin e zhvillimeve ekonomike nga eurozona. Për periudhën 2013-2015 parashikohet një rritje rreth 5% në mesatare. Konsumi i përgjithshëm vazhdon të jetë komponenti kryesor i BPV, i cili në tri vitet e ardhshme pritet të rritet me normë reale vjetore rreth 4.0%. Një tjetër kontribuues i rëndësishëm në BPV janë investimet e përgjithshme, të ndikuara edhe nga rritja e pjesëmarrjes së investimeve publike në totalin e investimeve (rreth 14.2% më të larta në vitin 2012 krahasuar me 2011). Pjesëmarrja e investimeve totale në BPV pritet të arrijë në rreth 32.2% në fund të periudhës 2013-2015, nga 32.1% sa ishte në vitin 2011. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një normë reale mesatare prej 8.6%. Edhe importi pritet të vazhdojë të rritet në periudhën afatmesme. Importit parashihet të kontribuoj negativisht në rritjen reale të BPV me mesatarisht 2.2% në planin afatmesëm.

Inflacioni në vitin 2012 parashihet të jetë mesatarisht rreth 2.2%, i ndikuar kryesisht nga lëvizja e çmimeve ndërkombëtare të ushqimit dhe naftës. Bazuar në parashikimet e institucioneve ndërkombëtare për rënien e çmimeve të ushqimit dhe naftës si dhe në parashikimet për ecurinë e çmimeve për mallrat e jo të tregtueshme, niveli i çmimeve në Kosovë pritet të rritet me norme më të ngadalësuar në tri vitet e ardhshme krahasuar me periudhën e mëparshme.

Sektori financiar vazhdon të jetë stabil. Edhe pse i dominuar nga bankat në pronësi të huaj, sektori bankar ka qenë likuid pasi që operacionet e bankave janë të financuara kryesisht nga depozitat vendore. Banka Qendrore së bashku me Ministrinë e Financave kanë krijuar fondin për mbështetje emergjente për likuiditet, edhe pse që nga krijimi i këtij fondi nuk ka pasur nevojë të shfrytëzimit të këtij mekanizmi shtese të likuiditetit. Në shtator të 2012, asetet e sektorit bankar kishin një rritje vjetore prej 5.1% (14.7% në shtator të 2011). Raporti kredit-depozita në shtator të 2012 ishte 79.7%, një përmirësim krahasuar me vitin e kaluar (78.9% në shtator të 2011).

Bilanci tregtar është karakterizuar me një deficit tregtar në mesatare rreth 40% e BPV në tri vitet e fundit. Bilanci tregtar pritet të ketë tendencë për një rënie të vogël në periudhën 2012-2015 si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksportit të mallrave dhe tregtisë së shërbimeve. Importi i

mallrave pritet të vazhdoj me trend rritës edhe përgjatë kësaj periudhe përkundër supozimeve për zëvendësim të lehtë me produktet vendore. Deficiti i llogarisë rrjedhëse që në vitet e fundit ka pasur rritje, parashikohet që do të mbese në rreth 20% të BPV. Transferet rrjedhëse të dominuara nga dërgesat e emigrantëve, vazhdimisht janë karakterizuar me stabilitet përkundër zhvillimeve negative në vendet e eurozonës. Me përmirësimin e mëtejshëm të ambientit për biznes, priten të hyra nga investimet e huaja direkte dhe përmirësimi i llogarisë kapitale dhe financiare.

Institucionet bazë për formulimin dhe monitorimin e implementimit të politikave në nivel të vendit janë të krijuara. Zyra e Kryeministrit për Planifikim Strategjik merr pjesë në formulimin e prioriteteve zhvillimore afatmesme të qeverisë bazuar në dokumentet strategjike të qeverisë si Programi i Qeverisë 2011-2014 dhe Vizioni dhe Prioritetet për Zhvillim Ekonomik të miratuar më 2011. Kjo zyre po ashtu koordinon monitorimin e zbatimit të këtyre prioriteteve. Ministria e Financave në kuadër të përgjegjësisë të saj ka për detyrë inicijativë procesin e hartimit të KASH si dokument që ndërlidh formulimin e politikave me planifikimin dhe buxhetin vjetor bazuar në prioritetet e qeverisë dhe projeksionet makro-fiskale. Ministrinë përkatëse me pas bëjnë operacionalizimin e prioriteteve në projekte dhe aktivitete buxhetore përmes buxhetit vjetor të organizatave buxhetore. Po ashtu, Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik luan një rol aktiv si forum i diskutimit të iniciativave të politikë-bërjes dhe konsultimit me asociacionet e biznesit dhe palët tjera të interesit. Këshilli është përgjegjës edhe për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Zhvillim Ekonomik 2011-2014. Partneret social janë të përfshirë në politikë-bërje përmes Këshillit Ekonomiko-Social ku zhvillohet dialogu social midis punëdhënësve dhe punëkërkuësve për çështje ekonomike dhe sociale.

Pavarësisht arritjeve të bëra në ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe implementimit të reformave në baze të parimeve të ekonomisë së tregut, sfida të shumta mbesin për ekonominë e Kosovës. Norma e lartë e papunësisë, deficiti i lartë i jashtëm, forcimi i sundimit të ligjit, dhe targetimi më i mirë i politikave mbeten sfida primare për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në aspektin institucional mbetet sfida vazhdimi i avansimit të kapaciteteve për parashikime dhe kostim me të mirë të prioriteteve dhe shpenzimeve.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Dizajnimi dhe zbatimi i politikave ekonomike të bazuara në ekonomi të tregut, zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve për vlerësim dhe parashikime makroekonomike që forcojnë stabilitetin makroekonomik dhe institucional

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, institucionet Kosovës do të vazhdojnë të ruajnë stabilitetin ekonomik dhe makro-fiskal. Për këtë qëllim do të vazhdohet me përmbushjen e kritereve strukturale dhe kuantitative të përcaktuara me Marrëveshjen SBA me FMN, përfshirë këtu edhe deficitin primar dhe nivelin e bilancit bankar, si dhe adoptimin e rregullës fiskale në harmoni me rekomandimet e FMN-së. Qeveria do të ndërmarrë disa hapa për avancimin e KASH si mjet i politikave që planifikohet të bëjë edhe krahasim të projeksioneve me institucionet tjera dhe të përfshijë të dhëna për shpenzimet buxhetore, dhe të dhëna mbi borxhin publik. Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve, qeveria planifikon aktivitete për trajnimin dhe avancimin e stafit të organizatave buxhetore për vlerësim dhe kostim të iniciativave të reja dhe projektligjeve, dhe përmirësim të inputeve të organizatave buxhetore për KASH.

2.1.2. Politikat fiskale

Në tri vitet e fundit, politikat fiskale janë zhvilluar në harmoni me objektivin e ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale, ngritjes së të ardhurave të disponueshme dhe krijimit të një ambienti me të favorshëm për investime dhe biznes. Për këtë qëllim që nga viti 2009, janë bërë reforma në sistemin tatimor duke ulur normat e tatimit në të ardhura personale dhe korporata, ndryshuar normën e TVSH-së dhe rritur akcizën për disa produkte.

Deficiti buxhetor u rrit nga 1.1% në 2009 deri në 2.5 e BPV-se në 2010 kryesisht për shkak të investimeve të shtuara kapitale. Por në vitin 2011, ky deficit u reduktua në -1.7% të BPV-se. Te hyrat e përgjithshme janë rritur me një mesatare vjetore prej 14% në periudhën 2007-2011. Vetëm gjatë vitit 2011, te hyrat u rriten me 18% krahasuar me 2010. Ndërsa në nëntëmujorin e parë të 2012, të hyrat e përgjithshme, përfshirë edhe kredimarrjen, janë 21% më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të 2011. Te hyrat vendore u rriten me një mesatare vjetore prej rreth 10.3% në periudhën 2007-2011 apo 47.1% krahasuar me 2007. Në 2011 ato u rriten me rreth 18% me shume se në vitin paraprak. Ndërsa në nëntëmujorin e parë të 2012, te hyrat vendore tatimore u rriten për rreth 5%.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore u rriten nga 19.1% e BPV në vitin 2007 në 28.8% në vitin 2011. Në nëntëmujorin e parë të 2012, shpenzimet e përgjithshme u rriten me 10% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2011. Shpenzimet kapitale në periudhën 2007-2011 u rriten nga 4.6% në 11.5% e BPV, ndërsa në nëntëmujorin e 2012 ato u rriten për 14% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2011.

Legjislacioni për borxhin publik përbëhet nga Ligji për Borxhet Publike dhe Udhëzimi Administrativ për emetimin dhe menaxhimin e borxheve dhe garancive shtetërore. Ndërsa Kosova ka bërë hapa pozitiv në legjislacionit për tregun e letrave me vlerë me aprovimin e rregullores për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë. Borxhi publik në fund të gjashtëmujorit të parë të 2012 ishte rreth 6% e BPV-se. Në tregun e letrave me vlerë, qeveria ka emetuar bono të thesarit në disa ankande të mbajtura në 2012 nga të cilat janë pranuar rreth 70 milionë euro deri në shtator të 2012.

Institucioni kyç për hartimin e politikave fiskale është Ministria e Financave. Ndërsa institucionet kryesore ekzekutive të politikave fiskale janë Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës. Me qëllim të menaxhimit dhe monitorimit adekuat të borxheve publike, Ministria e Financave ka në kuadër të saj Divizionin për Menaxhimin e Borxheve. Për funksionimin efikas të tregut të letrave me vlerë është funksionalizuar platforma elektronike e tregtimit të letrave me vlerë, është përgatitur sistemi depozitar qendror në Bankën Qendrore dhe është krijuar ëb interfejsi midis BQK dhe departamentit të thesarit që i mundëson Thesarit të aprovoje rezultatet e ankandëve.

Edhe pse është bërë përparim i konsiderueshëm sa i përket menaxhimit të financave publike, në këtë fushë mbeten disa sfida që lidhen me rritjen e pjesëmarrjes së të hyrave vendore në totalin e të hyrave dhe reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal. Marrë parasysh nevojat për financim në të ardhmë në disa sektorë, mbetet sfida menaxhimi dhe monitorimi i kujdesshëm i borxhit publik.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Zbatimi i politikave fiskale që kontribuojnë në zhvillim ekonomik dhe sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë të financave publike

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, institucionet Kosovës do të vazhdojnë me reformat e sistemit fiskal në harmoni me parimet e BE-se. Në këtë drejtim është planifikuar të vazhdohet me harmonizimin e mëtejme të legjislacionit fiskal të Kosovës dhe me monitorimin e inspektimit në funksion të implementimit adekuat të ligjeve. Qeveria planifikon të implementojë rekomandimet e asistencës teknike të FMN-se për politikën tatimore, të zgjerojë bazën tatimore dhe të rrisë në mënyrë graduale të hyrat vendore në totalin e të hyrave. Po ashtu do të vazhdojë zgjerimi i sistemit elektronik të regjistrimit të pagesës së taksave. Për të rritur qëndrueshmërinë e financave publike dhe për të mbështetur politikën fiskale stabile, në harmoni me rekomandimet e FMN-së, Qeveria gjatë vitit 2013 do të dizajnojë një rregull fiskal që do të fillojë të implementohet në vitin 2014. Institucionet po ashtu kanë në plan të ndërmarrin disa masa që kontribuojnë në menaxhimin dhe monitorimin efikas të borxheve publike përfshirë këtu aprovimin e Strategjisë Afatmesme të Borxhit Publik 2014-2017 dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimit të stafit për tregjet e kapitalit dhe borxhin e brendshëm.

2.2. Liberalizimi i tregut dhe çmimeve

Kosova si anëtare e CEFTA ka regjim për tregti të lirë me vendet tjera anëtare të këtij mekanizmi. Kohëve të fundit Kosova ka nisur negociatat për marrëveshje për tregti të lirë me Turqinë. Po ashtu janë të themeluara dhe funksionale edhe Komiteti Ndërmintor për Politikën Tregtare dhe Grupet dhe nën grupet përkatëse punuese për politikën tregtare si mekanizëm që siguron përveç pjesëmarrjes së institucioneve relevante qeveritare edhe përfshirjen dhe konsultimin e asociacioneve të biznesit në diskutimin e çështjeve rreth politikave tregtare.

Sa i përket liberalizimit të çmimeve të industrive të rrjetit, caktimi i çmimeve të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik behet nga rregullatorët e pavarur. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) sipas mandatit të dhënë me ligj bën caktimin e tarifave të energjisë elektrike dhe termale. ZRRE bën edhe caktimin e tarifave të ngrohjes qendrore. Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave rregullon caktimin e tarifave të ujit, dhe kanalizimit. Çmimet për shërbimet e telekomunikacionit sipas ligjit caktohen nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART). Në sektorin e hekurudhave, kompania publike TRAINKOS sipas ligjit ka opsionin e caktimit të tarifave të veta.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Vendosja e çmimeve bazuar në mekanizmat e tregut dhe rregullatorët e pavarur dhe tregtia e lirë në harmoni me principet regjionale dhe ndërkombëtare për tregti

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, institucionet kanë planifikuar të vazhdojnë me mekanizmat për caktimin e lirë të çmimeve përmes rregullatorëve të pavarur në sektorët e energjisë dhe ngrohjes qendrore, telekomunikacionit, dhe ujit.

2.3. Privatizimi, zhvillimi i sektorit privat dhe reforma financiare

2.3.1. Privatizimi dhe zhvillimi i sektorit privat

Korniza ligjore që rregullon privatizimin është mjaft e përparuar dhe adekuate pas aprovimit të pakos ligjore për privatizimin. Legjislacioni baze për këtë fushe përbëhet nga Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me AKP-ne, Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre dhe Ligji për Investimet e Huaja. Përmes këtyre ligjeve rregullohet procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, likuidimi dhe përgjegjësitë e funksionet e Agjencisë së Privatizimit.

Institucioni kyç në procesin e privatizimit është Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila si institucion i pavarur publik ka kompetenca të plota juridike për të lidhur kontrata, për të mbajtur dhe shitur pronën. Kompetencat e AKP-se i janë dhënë Bordit të Drejtoreve i cili është i përberë nga 5 drejtorë vendor dhe 3 drejtorë ndërkombëtarë. Ndërsa Dhoma e Veçante e Gjykatës Supreme ka juridiksionin për të gjitha paditë kundër agjencisë përfshirë këtu edhe kërkesat e kreditorëve në procesin e likuidimit.

Agjencia deri më tani ka privatizuar mbi 330 ndërmarrje shoqërore, me shitjen e tërësishme ose pjesërisht të rreth 690 ndërmarrjeve të reja. Agjencia po ashtu ka përmbyllur procedurat e brendshme të likuidimit për rreth 70 ndërmarrje, likuidimi i të cilave tani varet nga shqyrtimi i kërkesave të kreditorëve në Dhomën e Veçante të Gjykatës Supreme. Gjithashtu agjencia ka shpërndarë mbi 50 milion euro tek punëtorët që janë kualifikuar sipas kriterëve për 20% nga të hyrat e privatizimit.

Gjithashtu janë privatizuar disa ndërmarrje të mëdha publike. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës është dhënë me koncesion si dhe është duke u finalizuar privatizimi i Rrjetit të Distribucionit dhe Furnizimit me energji elektrike (KEDS). Posta dhe Telekomit në kuadër të ristrukturimit është ndare në dy entitete dhe aktualisht telekomit është në proces të privatizimit. Ngjashëm, edhe hekurudhat si pjesë e ristrukturimit dhe derregullimit janë ndare në dy kompani: në Trainkos që përfshin operimet dhe Infrakos, që menaxhon infrastrukturën hekurudhore. Kohëve të fundit po ashtu është duke u shikuar mundësia e Partneritetit Publiko-Privat në kompani publike.

Sa i përket zhvillimit të sektorit privat, legjislacioni baze në këtë fushe përbëhet nga ligji për Shoqëritë Tregtare, Ligji për Tregtinë e Brendshme, dhe Ligji për Investime të Huaja. Me qëllim të identifikimit të sfidave dhe prioriteteve kryesore për zhvillim të sektorit privat, institucionet kanë aprovuar edhe Strategjinë për Zhvillim të NVM-ve 2012-2016 me vizion 2020 e cila strategji merr parasysh edhe principet e Aktit Evropian të Bizneseve të Vogla. Për implementimin e strategjisë dhe arritjen e objektivave të saj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka hartuar edhe Planin e Veprimtimit për Strategjinë Zhvillimore të NVM-ve.

Institucionet kryesore për zhvillimin e politikave dhe krijimin e parakushteve dhe ambientit të favorshëm rregullativ janë të themeluara. Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, përkatësisht Agjencia për NVM është institucioni kyç për këtë fushe. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik ku kontributin e tyre e japin edhe asociacionet e biznesit. Po ashtu janë hapur edhe 25 qendra për regjistrim të biznesit nëpër komuna.

Ne kuadër te reformës se te berit biznes, janë ndërmarrë disa masa te cilat lehtësojnë procedurat administrative për te bere biznes. Është shkurtuar ne mase te konsiderueshme koha dhe procedurat për regjistrim te biznesit dhe marrje te licencave dhe lejes se punës. Sistemi i regjistrimit te bizneseve është integruar me sistemet e ATK-se dhe Doganave ku bashke me regjistrimin bizneset mund te merren edhe numri fiskal, certifikata e TVSH-se dhe certifikata për export/import. Është eliminuar kapitali fillestar për disa lloje te kompanive dhe është reduktuar për disa lloje tjera si dhe janë eliminuar disa licenca. Te gjitha këto masa kane ndikuar edhe ne përmirësimin e ambientit te te berit biznes, gjë qe është reflektuar edhe ne Raportin e Bankës Botërore 'Te Berit Biznes' ku Kosova është ngritur për disa pozita ne rangliste.

Edhe përkundër arritjeve te konsiderueshme ne procesin e privatizimit dhe zhvillimit te sektorit privat, ne këtë fushe mbesin shume sfida te cilat pengojnë zhvillimin dhe rritjen e këtij sektori. Sa i përket privatizimit, sfide mbetet përsheptimi i likuidimit dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve 'te mëdha'. Ne sektorin privat, mbetet sfide implementimi i plotë i kornizës ligjore dhe rregullatore për përmirësimin e ambientit te biznesit. Por sfidat më të mëdha kane te bëjnë me eliminimin e pengesave për zhvillim te sektorit privat si: përmirësimi i sundimit te ligjit, eliminimi i konkurrencës se padrejtë dhe informalitetit, qasja dhe kosto e financimit, dhe fuqia punëtore e pakualifikuar. Nëplan afatgjatë, fokusi duhet te jetë në transformimin e strukturës ekonomike dhe modernizimin e ristrukturimin e sektorit te NVM-ve.

Masat për përmbushjen e obligimeve ne kuadër te MSA-së

Privatizimi, rritja dhe zhvillimi i sektorit privat përfshirë forcimin e sundimit të ligjit, kornizës ligjore dhe të politikave për promovim të ambientit të përshtatshëm për biznes dhe investime

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, ne lidhje me privatizimin, institucionet kane planifikuar përsheptimin e likuidimit dhe disa masa qe lidhen me rishikimin e kërkesave te kreditorëve, vlerësimin financiar dhe te asetëve te Trepçës ne kuadër te riorganizimit te ndërmarrjeve 'te mëdha'. Po ashtu do te vazhdohet me shthurjen e mëtutjeshme te sektorit te energjisë përmes ndarjes se prodhimit te thëngjillit nga komponenti i gjenerimit. Për me tepër, me qellim te përmirësimit te performances financiare te sektorit te energjisë, janë planifikuar masa për rritjen e faturimit dhe inkasimit te energjisë.

Me qellim të zhvillimit të potencialit për partneritet publiko-privat, institucionet planifikojnë te zhvillojnë dhe harmonizojnë legjislacionin për PPP me atë te BE-se, dhe te rrisin kapacitetet institucionale dhe njerëzore përmes dizajnit te manualeve për PPP, plotësimit me kapacitete njerëzore te Departamentit Qendror për PPP dhe trajnimeve te specializuara te stafit.

Ne funksion te përmirësimit te ambientit te te berit biznes dhe luftimin e informalitetit janë parapare aktivite me komunat për përmirësim te ambientit për biznes, aktivite për mbrojtje dhe promovim te investimeve, inspektive ne terren nga Doganat, masa ne kuadër te implementimit te Planit Strategjik te ATK-se, dhe aktivite te Task Forcës për zbatimin e programit për parandalimin e ekonomisë informale. Ndërsa për përmirësimin e qasjes dhe koston se financave ne planin afatmesëm, institucionet kane parapare se pari te realizojnë një studim për modalitetet e krijimit te nje skeme te garantimit te kredive. Paralelisht me këtë, është parapare edhe anëtarësimi ne institucionet zhvillimore te BE-se (si CIP dhe EU SME Eëek) dhe

te donatorëve tjerë me qëllim të krijimit të instrumenteve financiarë për lehtësimin e qasjes së NVM-ve në financa (siç është Korniza Investive e Zhvillimit Ekonomik- EDIF) dhe krijimin e një fondi për subvencionimin e NVM-ve.

2.3.2. Reforma e sektorit financiar

Korniza ligjore e sektorit financiar është e avancuar dhe ne mase të madhe është në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-se. Ligjet kryesore që rregullojnë funksionimin e sistemit financiar përbëhen nga Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës Kosovës, Ligji për Banka, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autoperjegjesia, Ligji për Fondet Pensionale, dhe Ligji për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Në funksion të implementimit të këtij legjislacioni, janë miratuar rregullore dhe rregulla nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucioni qendror që nxit dhe mban stabilitetin e sistemit financiar si dhe kontribuon në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit monetar. BQK-ja licencon, rregullon dhe mbikëqyr të gjitha institucionet financiare të vendit si dhe kryen operacione bankare dhe kërkime ekonomike. Asetet totale të sektorit financiar në fund të 2011 ishin 3.5 miliard euro që paraqet rritje vjetore prej 9.3% krahasuar me vitin paraprak. Sistemi financiar përbëhet nga bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Ky sektor është i dominuar nga sektori bankar i cili përbëhet nga 9 banka komerciale.. Struktura e aseteve të sistemit bankar dominohet nga kreditë, ku pjesëmarrja e kredive në gjithsej asetet ishte rreth 64.1% në fund të vitit 2011. Në shtator të 2012 pjesëmarrja e kredive në gjithsej asetet ishte rreth 63.6% që paraqet rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Niveli i kapitalizimit vazhdon të jetë i lartë, ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në shtator të 2012 ishte 17.7% (krahasuar me 17.1% në shtator të 2011). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit rekomandohet të jete se paku 12%.

Sistemi bankar vazhdon të karakterizohet me nivel të kënaqshëm likuiditetit dhe të jete profitabil. Sidoqoftë, profiti neto i sistemit bankar në shtator të 2012 shënoi rënie prej rreth 30% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2011 që është reflektuar edhe në indikatorët e kthimit mesatar në asete (1% krahasuar me 1.5% në 2011) dhe kthimit mesatar në kapital (në shtator 10.7% krahasuar me 15.8% në shtator të 2011). Raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive u rrit nga 6.0% në shtator të 2011, në 7.0% në shtator të 2012.

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sistemi bankar në shtator 2012 arritën në 1.76 miliard që paraqet rritje vjetore prej 6.2%. Ndërsa, depozitat e sistemit bankar deri në shtator 2012 arritën në 2.2 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 5.2%. Në shtator 2012, raporti kredi-depozita ishte 79.7% përderisa në shtator 2011 ky raport ishte 78.9 %.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Mbajtja dhe avancimi i sistemit financiar stabil dhe efektiv që promovon alokimin efikas të resurseve

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*, për harmonizimin të mëtejshëm të legjislacionit financiar me atë të BE-se, institucionet kanë planifikuar aprovimin e Ligjit të Përgjithshëm të Sigurimeve dhe Ligjit të Sistemit të Pagesave si dhe hartimin e legjislacionit sekondar të nevojshëm për ligjet përkatëse.

3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR OBLIGIMET QË DALIN NGA MSA-ja

3.1. Dialogu politik

Kosova në masë të madhe ka bashkërenduar politikën e saj të jashtme me atë të BE-së. Kosova ka në vend të gjitha institucionet relevante për të zhvilluar dialog politik, si dhe për të marrë përsipër obligimet, si dhe për të zbatuar marrëveshjet ndërkombëtare. Dialogu politik në kuadër të procesit të integrimit evropian do të sigurojë që Kosova gradualisht të zhvillojë politika në përputhje me parimet kryesore të politikës së jashtme të BE-së.

MSA do të ofrojë kornizën për një dialog politik që fokusohet në integrimin, përafrimit gradual, konvergjencën e mëtejshme të pozitive për çështjet ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore.

3.2. Bashkëpunimi regjional

Në kuadër të përmirësimit të marrëdhënieve ndër-fqinjësore si dhe në kuadër të bashkëpunimit rajonal Kosova ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar fqinjësi të mirë, stabilitet rajonal si dhe normalizim të marrëdhënieve ndër-shtetërore me të gjitha shtetet e rajonit e në veçanti me Serbinë. Kosova ka treguar vullnet dhe përkushtim politik për të hyrë në dialog me Serbinë me qëllimin e promovimit të bashkëpunimit, dhe përmirësimit të jetëve të qytetarëve të saj. Ky vullnet dhe përkushtim është vlerësuar lart nga mekanizmat ndërkombëtarë si dhe nga BE-ja. Në kuadër të dialogut janë arritur një numër i marrëveshjeve bilaterale me Serbinë që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të qytetarëve, vulave doganore, njohje reciproke të diplomave universitare, gjendjes kadastrale për MIK si dhe për bashkëpunim rajonal. Kosova ka vazhduar të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura si dhe është angazhuar në mënyrë konstruktive gjatë gjithë procesit.

Kosova merr pjesë në nismat për bashkëpunim rajonal si dhe është anëtare e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal që nga viti 2008. Kosova kryen detyrën e saj ndaj Këshillit duke kontribuar me 4% në shumën totale të buxhetit të vendeve të Evropës Juglindore. Kosova gjatë vitit 2011 me sukses ka udhëhequr takimet e CEFTA-së, përfshirë takimin ministror të mbajtur në Nëntor të vitit 2011. Kosova merr pjesë rregullisht në takimet vjetore; Takimet e Bordit Koordinues Kombëtar dhe në takime tjera sektoriale të Këshillit. Për më tepër, Kosova merr pjesë në iniciativat e KBR-së: Iniciativa elektronike Juglindore dhe Iniciativa Kabllore e Evropës juglindore. Kosova gjithashtu merr pjesë në projektin e Komisionit Evropian për Qendrën për Zhvillimi të Qeverisjes dhe projektin për Monitorimin e Sektorit të Komunikimit dhe Shërbimeve të Shoqërisë Informativë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe rregullisht merr pjesë në mbledhjet e organizuara nga sekretariati i Komunitetit, siç janë: Këshilli ndërministror, Forumi Permanent i Nivelit të Lartë, Task Forca e EE-së, Task Forca për Mjedisin, Task Forca për Strategjinë Rajonale për Energji dhe forume tjera të organizuara nga sekretariati. Gjithashtu, në kuadër të komponentës së dytë të IPA-së, Kosova merr pjesë në implementimin e përbashkët të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë.

Megjithatë, sfidë mbetet normalizimi i plotë i marrëdhënieve me Serbinë, si dhe tejkalimi i kundërshtimit të vazhdueshëm të Serbisë për anëtarësimin e Kosovës në të gjitha mekanizmat rajonal.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sipas MSA-së, Kosova do të angazhohet në promovimin aktiv të bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat e mbuluara nga marrëveshja.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga *Marrëveshja Stabilizim Asociimit*, Kosova do të vazhdoj të ofroj kontributin vjetor financiar për funksionimin e Këshillit për bashkëpunim Rajonal, si dhe do të punoj në përmbushjen e kriterëve për aplikim dhe anëtarësim në mekanizmat rajonal. Kosova do të punoj në zbatimin e marrëveshjeve të Protokollit për IBM me Serbinë, si dhe do të angazhohet për arritjen e marrëveshjeve për lëvizjen e lirë të mallrave dhe njerëzve

3.3. Lëvizja e lirë e mallrave

Politika tregtare

Në funksion të forcimit të ekonomisë së tregut, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vazhduar të kontribuojë në mënyrë aktive drejt zhvillimit të parakushteve të nevojshme për tregti. Regjimi ekzistues liberal tregtar i Kosovës bazuar në legjislacionin në fuqi për një ekonomi të hapur ofron një bazë të mirë për funksionimin e tregut në harmoni me standardet e BE-së. Ligjet kyçe siç janë: Ligji për Tregtinë e Brendshme, Ligji për Shoqëritë Tregtare si dhe Ligji për Tregti me Jashtë, përcaktojnë kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm, praktikatat kufizuese dhe masat mbrojtëse për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, procedurat, kriteret e importit, eksportit dhe transitit të mallrave, shërbimeve dhe pasurive kapitale, konkurrencën e pandershme, masat mbikëqyrëse, masat administrative, dispozitat ndëshkuese si dhe dispozitat përfundimtare. Legjislacioni kornizë përbënë qarkun kryesor të mundësisë së lëvizjes së lirë të mallrave brenda dhe jashtë Kosovës në përputhje me *acquis* të BE-së, si dhe eliminimit të rregulloreve të cilat nuk janë në përputhje me ato të BE-së.

Këshilli për Politikën Tregtare është themeluar si platformë ndërministrare për koordinimin e politikave tregtare. Në kuadër të këtij këshilli është formuar Grupi Punues i Politikave Tregtare në nivel operacional të ministrive dhe bizneseve për të mundësuar dialogun në mes tyre, e cila përbëhet nga pesë nën-grupet punuese: nëngrupi për bujqësi, nëngrupi për lehtësimin e tregtisë, nëngrupi për shërbime, nëngrupi për industri dhe nëngrupi për marrëveshjet e tregtisë. Politika Tregtare është gjithashtu në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) si institucion kyç është ristrukturuar në tërësi, përmes përforcimit të Departamentit të Tregtisë në MTI-së si dhe në vazhdimësi është duke u punuar në funksionalizimin e plotë të strukturës së re organizative të MTI-së.

Implementimi i kornizës ligjore të tregtisë në tërësi, konkurrencës dhe tregut të brendshëm janë faktorët kyç në arritjen e prioritetëve tregtare të Kosovës. Kosova ka modernizuar kuadrin rregullator lidhur me tregtinë me qëllim të përafrimit me *acquis* të BE-së duke miratuar legjislacion të ri në pajtim me standardet e BE-së, por në vijim mbetet që institucionet përgjegjëse kosovare të zbatojë këtë kornizë të re ligjore.

Në kuadër të sigurimit të tregut kosovar është e nevojshme themelimi i masave mbrojtëse sipas nevojave kundër praktikave të padrejta tregtare (dumping dhe subvencionimi i importit). Intensifikimi i reformave dhe përqëndrimi i shtuar në zbatimin e tyre do të shpie Kosovën në rezultate të frytshme në tregtinë e vendit.

Masat për përmbushjen e obligimeve afatshkurtera në kuadër të MSA-së

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar këto objektiva afat-shkurtra që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

Implementimi i vendimit të qeverisë për ristrukturimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, vënia e një mekanizmi për të udhëhequr dhe koordinuar negociatat përbrenda Kosovës, si dhe përgatitja e një analize mbi ndikimin e aspekteve tregtare të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndërmarrë hapat konkret të ristrukturimit të Ministrisë dhe departamenteve në terësi, ku një theks i veçantë është kushtuar Departamentit të Tregtisë duke pas parasysh rëndësinë që e ka gjatë negociatave të MSA-së (për marrëveshjen Tregtare).

Për më tepër, institucionet janë duke punuar në bashkëpunim me Ministrinë e Integritetit për adoptimin e një strukture negociatore në kuadër të cilës strukturat e politikave tregtare të MTI-së kanë një rol të veçantë për negociatat e pjesës tregtare të MSA-së. Është funksionalizuar Këshilli ndërministror për politika tregtare dhe tashmë po mbahen takimet të rregullta të Grupeve për politika tregtare të cilat përbehen nga Nën-grupet përkatëse për Shërbime, Industri, Bujqësi, të cilat kanë për qëllim vendosjen e politikave të reja në lidhje me Marrëveshjen Tregtare dhe Lehtësim të Tregtisë me vende të ndryshme dhe që kanë për qëllim bashkëpunimin me të gjitha institucionet gjegjëse për arritjen e objektivave të caktuara nga Qeveria e Kosovës. Në vazhdim të përmbushjes së kriterëve tregtare, është bërë përgatitja e analizës së ndikimit të aspekteve tregtare të cilat do të rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Masat për përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, sigurimi i lëvizjes së lirë të mallrave duhet të jetë një prej objektivave kryesore. Palët duhet të krijojnë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë, brenda një periudhe transitorie që do të përcaktohet gjatë negociatave. Kjo zonë e tregtisë së lirë do të duhet të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së.

Kosova do të angazhohet që të mos krijojë kufizime sasiore, ose masa me efekt të njëjtë, për të shpërbërë në mënyrë progresive detyrimet doganore përkatëse të saj dhe masat ekuivalente në pothuajse të gjithë tregtinë me BE-në. Do të angazhohet për të parandaluar praktikën diskriminuese që ndikojnë në mënyrë direkte ose indirekte ndaj prodhuesve të BE-së. Masat autonome tregtare të BE-së tashmë vetëm përmbajnë një klauzolë qëndrimi që i kushtëzon përfituesit të cilit nuk fusin detyrat e reja të importit dhe masat me efekt të njëjtë në tregtinë me BE-në. Kjo do të bëhet një detyrim kontraktual në bazë të një MSA-së. Autoritetet doganore në Kosovë do të duhet të jenë në gjendje që të zbatojnë dhe mbrojnë këto regjime të kërkuar të tregtisë.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi*, sigurimi i lëvizjes së lirë të mallrave është pjesë e vazhdueshme e objektivave prioritare të tregtisë së Kosovës. Njëherit, kjo orienton rrugët tregtare të Kosovës drejt krijimit gradual të një zone të lirë tregtare në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së përmes shpërbërjes në mënyrë progresive të detyrimeve doganore përkatëse në lidhje me tregtinë e BE-së, si dhe ndalimin e krijimit të masave kuantitative dhe atyre me efekt të njëjtë. Kjo do të arrihet përmes monitorimit të rregullt të zbatimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe aktivitetet në kuadër të CEFTA-s siç janë: të dhënat e mbledhura në teren nga bizneset me formularët për barriera tarifore dhe jo-tarifore, pjesëmarrja e nën-grupit në takimet e CEFTA-s, si dhe organizimi i takimeve të informimit të mbajtura për bizneset vendore. Faktorë i pandarë është poashtu ngritja e kapaciteteve administrative për realizimin e negociatave në fushat lidhur me tregtinë. Kjo parashihet të arrihet përmes themelimit të strukturës përkatëse negociatore e cila do të shërbejë njëherit si mekanizëm për konsultim me palët e interesuara. Të njëjtit do të jenë në gjendje për të ofruar dëshmi se reformat e kërkuara të cilat rrjedhin si rezultat i tërë procesit të negociatave mund të zbatohen në mënyrë progresive pas nënshkrimit të MSA-së. Kontribut të shtuar në ekonominë e vendit do të jap stimulimi i bizneseve për eksportimin e produkteve industriale në vendet e BE-së përmes përfitimeve nga komuniteti i masave preferenciale autonome (ATM) në vend deri në vitin 2015 pa kufizime sasiore apo detyrime, e gjithë kjo e realizuar nëpërmjet nën-grupeve për politika tregtare. Pjesë zhvillimore e mëtutjeshme është infrastruktura e cilësisë si dhe përafrimi i mëtejshëm i kornizës ligjore me *acquis* të BE-së. Ngritja e kapaciteteve të personelit poashtu do të bëhet përmes trajnimeve përkatëse dhe ngritjes së vetëdijes. MTI do të bëjë identifikimin e përfitimeve dhe kostot e ndryshimeve në regjime tregtare që rezultojnë nga negociatat me BE-në për të ndërmarrë angazhime të rëndësishme të cilat pastaj mund të zbatohen.

Tregtia me mallra industriale

Legjislacioni kornizë i tregtisë së mallrave është bazë e infrastrukturës së implementimit të tregtisë së mallrave industriale. Njëherit, legjislacioni sekondar përkatës është miratur dhe në kuadër të kësaj janë nxjerrë këto udhëzime administrative: UA Nr. 2005/29 “Për Shenjën e Konformitetit dhe Paraqitjen Grafike të Saj”. Ky Udhëzim Administrativ është hartuar në përputhje me Direktivën 93/68/EEC të Bashkimit Evropian dhe duhet të aplikohet nga prodhuesit. UA Nr. 2005/28 “Rregullat Teknike Për Pajisjet Elektrike të Dizajnuara për Përdorim në Kufij të Caktuar të Tensionit”, i cili është i harmonizuar me Direktivën e Bashkimit Evropian Nr.73/23/EEC(LVD). Në bazë të këtij UA inspektohen pajisjet elektrike me tension të ulët, kryesisht pajisjet elektrike shtëpiake në treg dhe në prodhim.

Institucioni kyç mbi menaxhimin dhe implementimin e politikave të tregtisë së mallrave industriale është Departamenti i Industrisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i përbërë nga **Divizioni** i Zhvillimit të Prodhimit Industrial i cili mbikqyrë tregtinë e mallrave industriale përmes hartimit të strategjive, politikave sektoriale dhe nën sektoriale të integruara dhe programeve kryesore mbështetëse, si dhe Zyra për Rregulla Teknike e cila mbikqyrë implementimin e rregullave teknike të mallrave industriale në përputhje me standardet e BE-së.

Megjithatë, përdorimi i pakët i regjimit preferencial tregtar të BE-së nga ana e bizneseve që merren me lëvizjen e mallërave industriale ka lënë rezultate të deficitit të konsiderueshëm tregtar të Kosovës. Rrjedhimisht, performanca e përgjithshme e eksporteve të vendit mbetet e ndjeshme ndaj zhvillimeve në kërkesën e jashtme. Përbërësit kryesor të eksporteve të Kosovës

(61%) janë produktet primare, të tilla si materialet e papërpunuara ose mallra me një nivel të ulët të përpunimit dhe vlere të shtuar relativisht të vogël, kryesisht metale bazë. Produktet minerale zënë vendin e dytë të eksporteve të Kosovës (mbi 12%) të totalit të eksporteve. Eksportet e prodhuara kryesisht përbëhen nga makineritë plastike dhe lëkura. Ndërsa, importet e Kosovës në anën tjetër, kanë tejkaluar 2.1 miliardë €, me një rritje vjetore prej pothuajse 15%. Në tërësi struktura e importeve të Kosovës është stabile. Kategoria më e madhe është ajo e produkteve minerale (kryesisht produktet e karburantit dhe qeramika). Mallrat industriale, makineritë dhe pajisjet përfaqësojnë rreth 11% të totalit të importeve, apo rreth 28% të totalit të importeve nga BE. Pjesë e nevojshme për zhvillim mbeten procedurat administrative si dhe ngritja e vlerës së shtuar të mallrave të eksportit të cilat direkt ndikojnë në të hyrat buxhetore të vendit.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

1. Përmirësimi i procedurave administrative me qëllim të lehtësimit të tregtisë së mallrave;
2. Kosova duhet të ndërmarrë ndryshime strukturore drejt vlerës së shtuar të mallrave të eksportit, veçanërisht në tregtinë ndërmjet sektorëve industrial me kompanitë e BE.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, Kosova deri më sot ka ndërmarrë hapat konkret për tregtinë e mallrave industriale përmes thjeshtimit të procedurës administrative, siç është përcaktimi i vetëm dy dokumenteve përkatëse për eksport dhe tre për import. Njëherit, Kosova do ndërmarrë ndryshimet strukturore drejt ngritjes së vlerës së shtuar të mallrave të eksportit, veçanërisht në tregtinë ndërmjet sektorëve industrial me kompanitë e BE-së.

Tregtia me mallra bujqësore dhe peshkimit

Bujqësia dhe peshkataria si një sektor kyç i Kosovës zënë një pjesë prej rreth 17% në vlerën totale të shtuar në ekonomi, si dhe e njëjta është burimi kryesor i të ardhurave për shumicën e popullsisë. Tregtia e mallrave bujqësore dhe peshkimit është e bazur në legjislacionin në fuqi, e cila ngërthen në vetë legjislacionin e tregtisë së mallrave në tërësi si dhe njëherit legjislacionin kyç të bujqësisë dhe peshkimit siç janë: Ligji për Peshkatari dhe Akukulturë 02/L-85, Ligji Nr. 04/L-08 për bujqësi organike, Ligji Nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Sa i përket lëvizjes së mallrave bujqësore (këmbimit tregtar) Kosova si pjesë e marrëveshjes së CEFTA-s që nga viti 2007, po i zbaton rregullat e tregtisë së lirë dhe realizon një politikë tregtare liberale, pa kufizime sasiore (kuota) dhe masa mbrojtëse. Shumica e inputeve bujqësore, përkatësisht Kapitujt 1-24 të Nomenklaturës së Kombinuar nga Sistemi i Harmonizuar (HS) janë të liruara nga tarifatat doganore dhe TVSH-ja (Rregullorja nr. 2004/13, nr. 2004/35, 2006/4, 2007/12 dhe nr. 2007/31).

Struktura kryesore përgjegjëse për ndërmarrjen e reformave përkatëse përfshinë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në veçanti Departamenti për Tregti e cila mbikëqyrë dhe koordinon politikat tregtare të mallrave bujqësore dhe peshkimit, ndërsa institucioni qendror për implementimin e kriterëve tregtare që rezultojnë nga politikat tregtare është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural. Në kuadër të MBPZHR është Departamenti për Prodhimtari Bujqësore dhe Blegtorale i cili harton politika mbështetëse të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, krijon dhe implementon ligje dhe akte nënligjore të cilat rregullojnë këtë sektor. Kjo njësi organizative i përgjigjet edhe strukturave të IPARD-it për implementimin e Politikave të Përbashkëta Bujqësore Evropiane. Bazuar në Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2009-

2013 me Masën e Katërt (përmirësimi i përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore) ka përkrahur fermerët dhe agro-përpunuesit për të qenë jo vetëm konkures në vend por edhe të tregtojnë jashtë Kosovës. Me këtë masë, është përmirësuar cilësia e marketingut të prodhimeve të ushqimit të përpunuar dhe prodhimeve të freskëta duke i përshtatur me standardet e BE-së.

Edhe përkundër rritjes së lehtë të eksportit të prodhimeve bujqësore, Kosova përballet me një deficit të madh tregtar bujqësor, ku vetëm me BE-në, ky deficit arriti në 138 milion € në vitin 2011. Eksportet kryesore bujqësore janë lëngjet, pijet alkoolike dhe uthulla (verë, perimet ngrënshme dhe perime dhe fruta për përgatitje). Në anën tjetër, importi i produkteve bujqësore (ushqim dhe pije, kafshë të gjalla dhe perime) shkon deri në pothuajse 22% të të gjitha importeve, por më pak se 8% të të gjitha eksporteve. Importet më të rëndësishme të produkteve bujqësore në aspektin e vlerës janë lëngjet, pijet alkoolike dhe uthulla, mish ushqimor, produkte qumështi, pasta dhe produktet e qumështit. Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës janë BE, Shqipëria, Serbia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia. Sfidë për të gjitha kategoritë bujqësore dhe ushqimore është se ende mbizotëron një bilanc tregtar negative. Në vazhden e përparimeve të nevojshme të tregtisës së vendit është bujqësia organike e cila është në fazë të hershme të zhvillimit. Njëherit është e nevojshme që prodhimet e vendit duhet të certifikohen në Shqipëri dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

1. Të përmirësohet mbledhja e të dhënave statistikore pasi ka dallime të mëdha në të dhënat për këmbimin tregtar të produkteve bujqësore.
2. Të behën reforma strukturore bujqësore, përsheptimi i harmonizimit të rregulloreve veterinarë, sanitare dhe fitosanitare me standardet e BE-se për të ndihmuar eksportet e saj për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare.
3. Të bëhet privatizimi i përpunimit të bimëve, e cila do të përmirësojë nivelin e tyre në përmbushjen e cilësisë së kërkuar dhe standardet e sigurisë do të përmirësojnë konkurrencën e tyre komerciale.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, Kosova do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore me qëllim të eliminimit të dallimeve të mëdha në të dhënat për këmbimin tregtar të produkteve bujqësore (Kapitujt 1-24 të nomenklaturës së kombinuar) mes të BE-së dhe Kosovës. Në kuadër të reformimit strukturor të bujqësisë, përbrenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, synohet që të arrihen objektivat e ri-strukturimit përmes implementimit të Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2009-2013. Njëherit, synohet që të arrihet përmbushja e një nga gjashtë objektivat e Planit të ri të Zhvillimit të Bujqësisë 2014-2020, ku parashihet rritje ekonomike duke i adaptuar teknologjitë e reja dhe duke krijuar një ambient edhe më të favorshëm fiskal, i cili synohet të krijohet përmes zvogëlimit të taksave për inputet dhe pajisjet bujqësore që tregtohen.

Një politikë e favorshme fiskale, parashihet edhe me ndryshimet në Pakon e re fiskale e cila do të hyjë në fuqi nga një Janari i vitit 2013. Kjo pako, gjithashtu do të ndihmojë në përmirësimin e bilancit tregtar mes BE-së dhe Kosovës, si dhe përmirësimin e performancës së eksportit për të gjitha produktet bujqësore sepse liron nga TVSH dhe Tarifa Doganore disa inpute bujqësore të cilat prodhuesit tanë i importojnë. Së fundi por jo më pak rëndësi, implementimi i politikave me të mira të privatizimit të ndërmarrjeve agro përpunuese dhe mbështetja e tyre përmes grandeve dhe subvencioneve të parapara me PZHRB 2009-2012 do të përmirësojë aftësitë e saj

konkurruese, produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë e prodhimeve, në mënyrë që sektori të jep kontribut të konsiderueshëm në rritjen ekonomike dhe punësimin, si dhe njëherit të garantojë të ardhura të përshtatshme dhe stabile.

3.4. Levizja e lire e punetoreve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit

3.4.1. Lëvizja e lire e punëtorëve

Lëvizja e lirë e punëtorëve me qëllim të punësimit dhe njëherit ofrimi i mundësisë së punësimit të shtetasve të huaj në Kosovë, është duke u ndërtuar vazhdimisht në përputhje me standardet e BE-së. Legjislacioni kyç i përbërë nga: Ligji i punës, Ligji për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, si dhe aktet dytësore, përbëjnë nomenklaturën ligjore të lëvizjes së punëtorëve. Politikat e punësimit dhe aftësimeve profesionale për punëkërkuesit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i realizon përmes Departamentit të Punës dhe Punësimit, i cili me qëllim të arritjes së objektivave në sferën e punës, punësimit dhe aftësimeve profesionale për punëkërkuesit, ka hartuar një numër dokumentesh strategjike: Strategjinë Sektoriale të MPMS 2009-2013; Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale 2011-2013; Strategjia për punësimin dhe aftësimin e personave me aftësi të kufizuara; Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian nga Fushat e Punës dhe Punësimit; Plani i Standardeve Minimale të Shërbimeve Publike të Punësimit; si dhe dokumente tjera të rëndësishme nga kjo sferë.

Institucionet kyçe përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e politikave ekonomiko-sociale të punonjëse të huaj janë të themeluara dhe funksionale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është institucioni kryesor, i cili përmes njërive të veta përgjegjëse siç është Departamenti i Punës dhe Punësimit, qe ben hartimin, menaxhimin dhe koordinimin e politikave të punësimit.

Edhe përkundër arritjeve në fushën e krijimit të një vendi me interes dhe mundësi ofrimi të punësimit për shtetasit e huaj, siç janë: numri i lejeve të punës për shtetasit e huaj për vitin e ardhshëm vendoset në fund të çdo viti kalendarik, Kosova njih licencat e huaja në sektorin e ndërtimit, e cila lehtëson mundësinë për kompanitë e huaja të sjellin punëtorët e tyre për të punuar në Kosovë. Gjithashtu, avokatët të cilët janë banorë të përhershëm, janë të lejuar edhe për të ofruar shërbime në Kosovë. Megjithatë, Kosova duhet të vazhdojë më tutje me përafrimin e legjislacionit kosovar me *acquis* të BE-së, siç është ndryshimi i Ligjit për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti si dhe aktet përcjellëse dytësore ngase legjislacioni ekzistues është i pazhvilluar në nivelin e duhur. I njëjti është në varësi të sektorit apo nuk ka sistem të sigurimit, sistemi ky, i cili është jo i përshtatshëm për koordinim. Po ashtu, është e nevojshme krijimi i një platforme të koordinimit të limituar të sistemeve të sigurimeve sociale me qëllim të rritjes së ndjeshme të kapaciteteve administrative për të futur një koordinim të kufizuar të sistemeve të sigurimeve shoqërore siç është paraparë nga MSA. Statistikat për nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të fuqisë punëtore të huaj në Kosovë duhet të përcaktohen. Për më tepër, është e nevojshme të përcaktohet numri i nevojshëm i punonjësve për rekrutim të punëtorëve të vendeve të treta në tregun kosovar të punës. Sfiduese mbetet çështja e negociimit të marrëveshjeve bilaterale për sigurimet shoqërore e cila dëshkohet të jetë e vështirë dhe krijiimi i disa degëve të sigurimeve shoqërore të cilat ende nuk ekzistojnë në Kosovë.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sipas MSA-së, Kosova do të ketë nevojë që të siguroj trajtim të barabartë për sa i përket kushteve të punës, shpërblimit dhe shkarkimit të punonjësve të cilët janë të themeluar ligjërisht në territorin e saj. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në Kosovë do të kenë qasje në tregun e punës gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar të punonjësit/ses. Kosova do të duhej të hedh poshtë rregullat për koordinimin e kufizuar të sistemeve të sigurimeve sociale për shtetasit e BE-së të punësuar ligjërisht në Kosovë dhe anëtarët të familjeve të tyre që banojnë me ta.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, institucionet e Kosovës do të miratojnë ndryshimet, plotësimet, si dhe do të zbatojnë Ligjin e Punës dhe Ligjin për dhënien e Lejes së Punës dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, Ligjin për "Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti", si dhe udhëzimet administrative përkatëse. Në vazhden e krijimi të platformës administrative për Koordinim të limituar të Sistemeve të Sigurimeve Sociale, do të përcaktohet numri i lejeve të punësimit për personat e huaj për vitin e ardhshëm, përcaktimi i statistikave për nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të fuqisë punëtore të huaj në Kosovë, si dhe do të bëhet përcaktimi i numrit të nevojshëm të punonjësve për rekrutim të punëtorëve të vendeve të treta në tregun kosovar të punës. Qeveria e Kosovës edhe më tutje do të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve institucionale për Koordinim të limituar të Sistemeve të Sigurimeve Sociale. Më saktësisht, do të funksionalizohet nga Qeveria, Komisioni Koordinues për Marrëveshjet Bilaterale në fushën e Sigurimeve Sociale. Njëherit, do të krijohet Divizioni për Marrëveshje bilaterale në fushën e Sigurimeve Sociale dhe Punësimin në kuadër të Ministrisë së Punës, respektivisht Departmentit për Integritet Europian dhe Koordinim të Politikave si organ ndërlidhës për këtë qëllim. Me qëllim të zgjerimit të tregut të punëtorëve, do të zhvillohen negociatat me shtetet partnere me qëllim të lidhjes së Marrëveshjeve Bilaterale në fushën e Sigurimeve Sociale. Së fundi, njëherit do të përcaktohet numri i trajnimeve të personelit përkatës për Koordinimin e Sigurimeve Sociale me qëllim të menaxhimit profesional të veprimtarisë së lëvizjes së punëtorëve në Kosovë.

3.4.2. E drejta e themelimit (establishment)

E drejta e themelimit të bizneseve të huaja në Kosovë është nën kushtet e trajtimit të njëjtë dhe të barabartë me bizneset vendore, e përcaktuar përmes kornizës përkatëse ligjore si dhe regjistrimi i tyre në Agjencinë e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Legjislacioni kyç i përbërë nga Ligji për shoqëritë tregtare, Ligji për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, Ligji për Zonat Ekonomike, Ligji për Investimet e Huaja, si dhe Ligji për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim përbëjnë infrastrukturën ligjore të themelimit të bizneseve të huaja në Republikën e Kosovës. Në mbështetje të *nje ambienti te mire per biznes*, 25 zyra për regjistrimin e bizneseve janë themeluar në komuna të ndryshme, ku edhe do të lëshohen certifikatat e regjistrimit të biznesit, numri fiskal dhe certifikatat e TVSH-së.

Korniza institucionale e sektorit publik që ka të bëjë me regjistrimin dhe funksionimin e bizneseve në Kosovë përbëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në veçanti Departamenti për Tregti, Inspektoriat Qendror i Tregut, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), si dhe një numër i asociacioneve të biznesit përfshirë Oden Ekonomike të Kosovës.

Edhe përkundër arritjeve deri më tani nga ana e institucioneve përfaqësuese të sektorit të biznesit dhe ambientit të bërit biznes, sektori i biznesit kosovar është e nevojshme të vazhdojë më tej në përafrimin e legjislacionit dhe standardeve biznesore me ato të BE-së lidhur me

njohjen e kualifikimeve profesionale, të ligjit për shoqëritë tregtare, duke përfshirë kontabilitetin, auditimin dhe qeverisjen korporative, të cilat janë të kufizuara.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova duhet të vazhdojë me përafrimin progresiv të dispozitave BE-së. Përafrimi me standardet e BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe të ligjit të ndërmarrjeve, duke përfshirë kontabilitetin, auditimin dhe qeverisjen e korporatave është i kufizuar. Progres i mëtejshëm në këto dy fusha do të kontribuojë për ta bërë Kosovën një vend më tërheqës për biznes.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, Qeveria e Kosovës do të miratojë tri ligjet kyçe të cilat përfshijnë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kosovar me atë të BE-së, respektivisht Ligji për Ndërmarrjet e Vogla dhe te Mesme, Ligji për Zonat Ekonomike dhe Ligji për Investimet e Huaja.

Sipas MSA-së, Kosova do të ketë nevojë për të siguruar që kompanitë e BE-së kanë të drejtën e themelimit në Kosovë. Kompanitë e BE-së të themeluara në Kosovë duhet t'iu jepet trajtim lokal ose trajtimi i kombit të favorizuar (MFN), cili do që është më i favorshëm. Gjatë periudhës së tranzicionit, çështja e zgjerimit të këtyre të drejtave të shtetasve të BE-së ose kosovarëve dëshirojnë të themelojnë veten si vetë-punësuar të pavarur do të shqyrtohen. Pavarësisht nga dispozitat që rregullojnë lëvizjen e lirë të punëtorëve sipas marrëveshjes, dispozita të veçanta krijimi mund të futet për "personelin kyç".

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, institucionet e Kosovës kanë thjeshtësuar procedurën e regjistrimit të bizneseve të huaja, e aplikuar përmes heqjes së dispozitës që kërkon depozitim minimal të kapitalit fillestar (5.000 €) për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar dhe duke ulur kapitalin fillestar për kompanitë aksionare prej 25,000€ në 10,000€. Këta faktorë do të lehtësojnë fillimin e biznesit fillestar në Kosovë si dhe njëherit do të zvogëlojnë kohën për të filluar veprimtarinë një biznes. Përmes këtyre indikatorëve institucionet e Kosovës në mënyrë të vazhdueshme do të përfillin kushtet teknike dhe kriteret ekonomike sa më të avancuara dhe në përputhje me standardet e BE-së, me qëllim për ta bërë Kosovën një vend më tërheqës për biznes.

3.4.3. Tregtia e shërbimeve

Në Kosovë, ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon sektoret perkates të shërbimeve. Sherbimet tregtare rregullohen me ligjin për Shoqëritë Tregtare ndërsa ato financiare rregullohen me ligjin për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jo bankare si dhe legjislacionin tjetër të Bankës Qendrore të Kosovës. Sherbimet edukative janë të rregulluara me ligjet perkatese për arsimin publik dhe privat. Po ashtu shërbimet e telekomunikacionit dhe postare rregullohen përmes ligjit për Sherbimet Elektronike dhe për shërbime postare. Ndërsa ligji për Turizmin dhe Sherbimet turistike rregullon sektorin e turizmit.

Kompanitë e huaja të shërbimeve kanë trajtim të barabartë ligjor me ato vendore dhe në përgjithësi tregtia e shërbimeve është e liberalizuar. Aktualisht, është duke u negociuar liberalizimi gradual i tregtisë së shërbimeve me Turqinë në kuadër të negociatave me këto vend për marrëveshje të tregtisë së lire. Kosova ka bilanc pozitiv tregtar në tregtinë e shërbimeve. Sherbimet konsiderohen se janë një nga sektoret me potencial për rritje përfshirë edhe rritjen e eksportit të tyre sidomos në fushën e teknologjisë informative.

Nga aspekti institucional, ekzistojne disa ministri dhe rregullatorë që kanë kompetenca për fusha të caktuara për shërbime nën fushëveprimin e tyre. MTI është institucioni bartës për shërbimet tregtare. BQK është institucioni kryesor që kontribuon në rregullatën dhe mbikëqyrjen e shërbimeve financiare. ART është institucioni kryesor për shërbimet e telekomunikacionit ndërsa MZHE ka në kompetencë të saj shërbimet e teknologjive informative dhe të telekomunikimit. Po ashtu është themeluar Organi i koordinimit horizontal të çështjeve lidhur me këto fusha. Ky organ është funksional dhe ka mbajtur disa takime.

Edhe kundrejt arritjeve të Kosovës ende përballen me sfida që duhen të adresohen. Në këtë rast Kosova duhet të vazhdojë në përafrimin progresiv të legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së në fushën e Furinimit të Shërbimeve si dhe të bëjë më shumë në përmirësimin e statistikave në shërbime.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sipas MSA-së, një regjim liberal për furnizimin e shërbimeve do të ofrohet, në përputhje me rregullat përkatëse të OBT-së, në veçanti me Nenin V të GATS. Kompanitë që nuk janë të krijuara në territorin e palës tjetër kontraktuese përkatëse gradualisht do të fitojnë të drejtën për të ofruar shërbime, në përputhje me dispozitat GATS duke marrë parasysh, në veçanti, përparimin në përafrimin e ligjeve në fusha të ndryshme. Marrëveshja do të përmbajë një klauzolë stand-still (ngjirje). Implementimi i këtij liberalizimi do të monitorohet nga afër në bazë të marrëveshjes.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asocim, për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit Kosova do të aprovohet Ligjin e përgjithshëm mbi shërbimet, si dhe të aprovohet Udhëzimet Administrative me qëllim të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së. Ndërsa për përmirësimin e të dhënave statistikore do të krijohet databaza lidhur me shërbimet në Kosovë si dhe TIS databaza 1 (Statistikat), TIS databaza 2 (Rregullativa Ligjore), TIS databaza 3 (Akte të Kryesor).

3.4.4. PAGESAT RRJEDHËSE DHE LËVIZJA E LIRE E KAPITALIT

Në sektorin financiar të Kosovës nuk ka restriksione në investime të jashtme (huaja) ose në hyrjen e kapitalit të huaj në këtë sektor sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu nuk ka kufizime në investimet e huaja direkte dhe llogarinë kapitale dhe financiare në përgjithësi. Sistemi i pagesave në Kosovë përfshirë këtu kliringun dhe shlyerjen e letrave me vlerë operohet dhe mbikëqyret nga Banka Qendrore. Ky institucion sipas ligjit duhet të promovojë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Për këtë qëllim, BQK ka filluar përgaditjet për implementimin e sistemit të shlyerjes individuale të pagesave në kohë reale, ka krijuar platformën elektronike të tregtimit të letrave me vlerë, ka aprovuar dokumentin mbi politikën e mbikëqyrjes së pagesave, ka aprovuar rregullat dhe procedurat operuese të sistemit elektronik të kliringut dhe shërbimit të shlyerjes, si dhe ka zhvilluar sistemin e debitimit direkt dhe dokumentin standard Kos-GIRO.

BQK po ashtu bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemit financiar në bazë të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së. Mbikëqyrja bëhet në bazë të qasjes së bazuar në rrezik dhe përfshin ekzaminimin on-site dhe off-site. Për të fuqizuar mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, është dizajnuar dhe implementuar softueri për mbikëqyrjen

financiare (për banka, pensione dhe sigurime) si dhe janë përgatitur dhe aprovuar rregullore, rregulla dhe manuale përkatëse për mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe sistemit të pagesave.

Edhe pse janë bere përparime te mëdha ne këtë sektor, sfide mbetet reforma e mëtutjeshme për avancimin e mbikëqyrjes financiare, me konkretisht përafrimi me standardet e Bazelit (banka), IAIS (sigurime) dhe IOPS-it (pensione) si dhe përafrimi i kornizës ligjore ne harmoni me direktivat e BE-së.

Masat për përmbushjen e obligimeve ne kuadër te MSA-së

Ne kuadër te Marrëveshjes se Stabilizim-Asocimit, Kosova do te zotohet te siguroje Regjimi liberal dhe jo-diskriminues për lëvizjen së kapitalit, ne veçanti për investimet direkte. Mbrojtja e investitorëve ne lidhje me likuidimin dhe riatdhesimin e investimeve dhe profitit duhet te jete e përfshirë ne këtë zotim.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, institucionet kane planifikuar te ndërmarrin masa për avancimin e mbikëqyrjes financiare në pajtim me standardet e Basel-it (Banka), IAIS (Sigurime) dhe IOPS-it (Pensione) dhe direktivat e BE-së. Me konkretisht, do te rishikohet legjislacioni primar dhe sekondar mbi sigurimet konform direktivave të BE-së dhe parimeve të IAIS (International Association of Insurance Supervisors) dhe do te hartohet legjislacioni sekondar për ligjin mbi bankat ne harmoni me standardet e Bazelit. Ne funksion te avancimit te mbikëqyrjes, do te behet rishikimi i manualeve ekzistuese mbikëqyrjes bankare për t'i përafruar me standardet dhe direktivat e BE-se, do te behet përafrimi i rregullatives se Mbikëqyrjes pensionale dhe manualeve te mbikëqyrjes se pensioneve ne harmoni me EIOPA (European Insurance and Occupational Pensions Authority), direktivat e BE-se dhe IOPS (International Organization of Pension Supervisors), dhe do te hartohet rregullativa mbi mbikëqyrjen e tregut të letrave më vlerë.

3.5. Përafrimi, implementimi dhe përforcimi i legjislacionit

3.5.1. Konkurenca

Sektori i konkurrencës është thelbësor në funksionimin efikas të tregjeve dhe si i tillë luan rol qenësor në ekonominë e Kosovës. Mbrojtja e konkurrencës dhe krijimi i tregut të mirëfilltë janë obligime të cilat Qeveria e Kosovës i ka ndaj Bashkësisë Evropiane. Këto obligime janë në proces të përmbushjes duke pasur parasysh zhvillimet e fundit legjislative në këtë sektor. Kornizën ligjore bazë e përbëjnë Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligji për Ndihmën Shtetërore. Synim kryesor i ligjeve aktuale është përforcimi dhe stimulimi i zhvillimit ekonomik dhe social në Kosovë. Më konkretisht, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës bënë ndalimin e veprimeve që kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë konkurrencën. Ligji në fjalë mbështetet në tre shtylla kyçe përfshirë, abuzimin me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve. Përderisa, Ligji për Ndihmën Shtetërore përcakton parimet dhe procedurat në përputhje me të cilat lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore. Vlen të ceket që ky i fundit është fuqizuar në fillim të vitit 2012.

Kur bëhet fjalë për zhvillimet institucionale, organi kompetent që merret me zbatimin e kornizës legjislative në fushën e konkurrencës është Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Krahas zbatimit të legjislacionit ky institucion është gjithashtu përgjegjës për promovimin e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë. Institucionet

tjera mbështetëse dhe bashkëpunuese të sektorit të Konkurrencës janë Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Edhe pse është bërë njëfarë përparimi në aspektin ligjor dhe institucional, në sektorin e konkurrencës nevojitet më shumë përkushtim dhe përpjekje për të përmbushur standardet e BE-së. Brenda sektorit fushat të cilat pengojnë edhe me tej zhvillimin vital të këtij sektori përfshinë kompletimin dhe zbatimin e kornizës legislative si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale. Përkundër faktit që legjislacioni primar si tërësi është mjaftë i avancuar, pikat konkrete që kanë të bëjnë me pozitën dominuese dhe përqendrimet në treg kërkojnë edhe me tej të përafrohen me *acquis*. Sfidë tjetër shumë e rëndësishme që ndërlihet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës është edhe aprovimi i legjislacionit sekondar pa të cilin limitohet ushtrimi efikas i veprimtarisë së AKK-së. Në aspektin legjislativ, përkushtim aktiv kërkohet në monitorimin e zbatimit të Ligjit për Ndihmë Shtetërore. Në aspektin institucional sfiduese paraqitet themelimi i organit kyç që do të ketë përgjegjësi në aktivitetet e ndihmës shtetërore. Përveç kësaj, funksionalizimi i zyrës së organit paraprak dhe kompletimi i stafit të trajnuar janë sfida që nevojitet të përmbushen. Më tutje, sfiduese është edhe themelimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Adresimi i sfidave të lartcekura do të shtynte sektorin e konkurrencës një hap para në përmbushjen e dispozitave të kërkuara të BE-së.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të angazhohet për:

1. Ndalimin dhe vënien e politikave për:

- a. Të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara të cilat pengojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën*
- b. Abuzimin me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje*
- c. Çdo ndihmë shtetërore (publike) e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara*

- 2. Të aplikuar këto rregulla për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet me të drejta të veçanta*
- 3. Të rregulluar monopolet shtetërore me karakter tregtar, në mënyrë që të mos ekzistoj asnjë diskriminim lidhur me kushtet në të cilat mallrat janë siguruar dhe tregtuar*
- 4. Të siguruar transparencë në fushën e ndihmës shtetërore (publike), duke krijuar inventarëve të plotë të skemave të ndihmës dhe duke raportuar çdo vit në Komisionin Evropian*

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në bashkëpunim me Ministrinë bashkëpunuese do të bëjnë kompletimin e kornizës ligjore duke amandamentuar Ligjin për Mbrojtje të Konkurrencës. Në kuadër të këtij ligji, kujdes i veçantë do të kushtohet përkufizimit të pozitës dominuese, abuzimit me këtë pozitë, përqendrimeve të ndërmarrjeve në treg dhe përjashtimeve grupore. Paralelisht, planifikohet të bëhet aprovimi i legjislacionit sekondar për implementimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Më tutje, AKK do të ndërmarr hapa konkret për të aprovuar legjislacionin sekondar për implementimin e Ligjit për Ndihmë Shtetërore. Aktivitete periodike të cilat dëshmojnë zbatimin e ligjit në fjalë do të realizohen përfshirë, mbajtjen e një regjistrimi mbi zbatimin e ligjit, kontrollimin e mjeteve të ndara të ndihmës, marrjen e vendimit për kthimin e mjeteve dhe përgatitjen e raportit vlerësues për ndihma. Kur bëhet fjalë për ngritjen e kapaciteteve institucionale, planifikohet themelimi dhe funksionalizimi i zyrës së pavarur për Ndihmën Shtetërore. Gjithashtu, do të plotësohet numri i zyrtareve të paraparë me ligj. Në këtë kontekst, do të bëhet edhe trajnimi adekuat i zyrtareve përgjegjës për ndihma shtetërore, gjë që

do të mundësoj kryerjen efektive të detyrave të parapara. Ndër tjerash, planifikohet edhe themelimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

3.5.2. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

Spektori i së Drejtës për Pronësi Intelektuale funksionon në bazë të ligjeve, politikave dhe institucioneve përkatëse. Me qëllim të përafrimit të legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa konkret drejt reformimit të legjislacionit të Pronësisë Intelektuale. Si rezultat, progres është shënuar në Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të Lidhura, Patentave dhe Markave Tregtare të cilët janë miratuar dhe gjerësisht harmonizuar me dispozitat e BE-së. Ligje tjera të cilat janë kyçe për këtë sektor përfshinë Ligjin për Dizajn Industrial, Mbrojtjen e Varieteteve Bimore dhe Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale. Ligjet e lartcekura posedojnë funksione të veçanta por në përgjithësi synim i përbashkët i tyre është rregullimi i fushës së pronësisë intelektuale në Kosovë. Përveç legjislacionit në fuqi ky sektor ka të hartuar Strategjinë për Pronësi Intelektuale për një periudhë katër vjeçare (2010-2014). Strategjia në fjalë synon të krijoj një sistem efektiv dhe stabil për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Implementimi adekuat i kësaj strategjie do të përmbush një nga kriteret e dispozitave të BE-së.

Infrastruktura institucionale për këtë sektor përbehet nga një numër organesh kompetente: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në kuadër të së cilës është e themeluar Zyra për Pronësi Industriale (ZPI) e cila ka përsipër zbatimin e ligjeve në fushën e patentave, markave tregtare dhe dizajnit industrial. Njëkohësisht, ky organ ka për detyrë të bëjë vetëdijesimin e publik për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale. Zyra për të Drejtat e Autorit e themeluar në kuadër të Ministrisë për Kulturë Rini dhe Sport është organ kyç për sektorin e PI-së. Qëllimi i saj është të bëjë akreditimin dhe mbikëqyrjen e organizatave që përfaqësojnë mbajtësit e të drejtave dhe palët tjera aktive në çështjet e PI-ë. Mekanizma të tjerë të rëndësishme që janë përgjegjëse për zbatimin e DPI-së përfshinë, Sistemin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Doganat e Kosovës. Së fundi, Qeveria e Kosovës themeloi Këshillin Shtetërorë për Pronësi Intelektuale i cili synon të rris nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional. Si tërësi, secili nga institucionet e lartpërmendura ngërthen në vete përgjegjësi të caktuara të cilat kontribuojnë në zhvillimin vital të sektorit të DPI-së.

Me gjithë progresin e arritur në sektorin e DPI-së, akoma ekziston nevoja për përmirësim të mëtutjeshëm të bazës ligjore, kapaciteteve institucionale dhe veprimeve tjera teknike. Një ndër sfidat kryesore të këtij sektori është kompletimi i kornizës ligjore që ngërthen në vete miratimin e ligjit për Treguesit Gjeografik dhe një numër Udhëzimesh Administrative të cilat janë relevante për ligjet në fuqi. Në aspektin institucional, arritjet e deritanishme karakterizohen pozitive dhe përparimtare, megjithatë ngecjet në këtë segment janë ende të dukshme dhe si të tilla kërkojnë përkushtim të mëtutjeshëm. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet e pronësisë intelektuale është një sfidë tjetër përmbushja e së cilës do ta rriste bashkëpunimin dhe koordinimin ndër-institucional gjë që do të rezultonte në punë më efektive brenda sektorit. Krahas kësaj, sfiduese konsiderohet edhe vazhdimi i luftimit të mallrave të falsifikuara e cila praktikë vazhdon të pengoj zhvillimin e një tregu të mirëfilltë në vend.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të angazhohet për dhënien e të kompanive të BE-së një nivel të mbrojtjes të krahasueshëm me atë të kompanive vendase. Në mënyrë progresive, Kosova do të duhet të punojnë drejt një niveli të krahasueshëm të mbrojtjes siç jepet në BE.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do ndërmarr hapa konkrete në kompletimin e bazës ligjore duke miratuar Ligjin për Treguesit Gjeografik, UA për procedurat e Regjistrimit të treguesve Gjeografik dhe Emërtimeve të Orgjinë si dhe UA mbi Përfaqësuesit pran ZPI-së. Kur bëhet fjalë për kapacitetet institucionale, MTI do të plotësoj stafin punues të paraparë me ligj. Krahas kësaj, do të funksionalizohet databaza e të dhënave për përdorimin efikas në kuadër të së cilës do të organizohen trajnime të përshtatshme për zyrtarët përgjegjës. Përveç të fundit, trajnimet do të orientohen në avancimin e njohurive të stafit mbi zbatimin e legjislacionit të sektorit të PI-së. Për trajtimin e sfidës së radhës, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport do të nënshkruaj memorandum mirëkuptimi me zyrën e pronësisë intelektuale, inspektoratin e tregut dhe policinë e Kosovës. Më tutje, aktivitetet të cilat do të ndërmerren për të luftuar mallrat e falsifikuara përfshinë, raportimin e kontroleve të ngarkesave komerciale gjë që do të bënte të mundur identifikimin e mallrave të falsifikuara. Krahas kësaj, do të krijohen profile të riskut për mallra të falsifikuara, do të raportohet numri i rasteve të zbuluara Ex officio dhe me përpikëri do të raportohet rritja e numrit të rasteve Ex Officio. Me përmbushje të sfidave të lartcekura, Qeveria e Kosovës synon të krijoj një sektor të mirëfilltë ku të drejtat e pronësisë intelektuale janë të njohura dhe respektohen nga akterët institucional dhe publiku i gjerë.

3.5.3. Prokurimi Publik

Sektori i Prokurimit Publik, një ndër sektorët më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm në Kosovë i cili ka shënuar progres të dukshëm në kompletimin e kornizës legjislative dhe asaj institucionale. Bazë e kornizës legjislative është Ligji për Prokurim Publik i cili pas një numër modifikimesh me qëllim të përafrimit me acquis ka hyrë në fuqi në fund të viti 2011. Ligji në fjalë sjell dispozita të reja legjislative të cilat avancojnë dhe mundësojnë një sistem efikas të prokurimit publik. Qëllimi i tij është të siguroj shfrytëzimin e fondeve publike në mënyrë transparente, proporcionale dhe efikase. Krahas tjerash, ligji aktual mundëson financimin e projekteve në mënyrë më efektive dhe koncize dhe si rezultat synon të përmirësoj cilësinë e jetës së qytetarëve në tërësi. Avancim i dukshëm ka përshkuar edhe legjislacionin sekondar, i cili është përmirësuar plotësisht dhe thjeshtësuar me qëllim të operimit të plotë të kornizës ligjore dhe asaj rregullative.

Sa i përket kornizës institucionale, strukturat organizative janë të themeluara dhe funksionale. Agjencioni i pavarur rregullator, përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik është Komisioni Regullativ i Prokurimit Publik (KRPP). Organi i dytë kyç i këtij sektori është Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) e vendosur tani në kuadër të Ministrisë së Financave e që është përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për autoritetet kontraktuese. Poashtu si organ tjetër i rëndësishëm është Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) i cili merret me shqyrtimin administrativ që ka të bëjë me ankesat. Ndër të tjera, i një rëndësie të veçantë është edhe instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) i cili mundëson trajnimin e zyrtareve të prokurimit publik. Vlen të ceket që institucionet e lartpërmendura aktualisht iu përmbahen rregullave të reja të procedurave dhe udhëzimeve për ushtrimin e veprimtarive të tyre.

Me gjithë arritjet e deritanishme në kornizën legislative dhe atë institucionale, një numër sfida që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori mbeten të adresohen dhe shqyrtohen nga organet kompetente shtetërore. Sfiduese konsiderohet rritja e transparencës së proceseve të prokurimit përfshirë trajtimin, ndjekjen dhe sanksionimin e rasteve në prokurim publik. Në aspektin institucional, ngritja e kapaciteteve të punonjëseve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik është një sfidë shumë e rëndësishme përfshirë qarkullimin e shpeshtë të zyrtareve të prokurimit. Gjithashtu, sfiduese vlerësohet edhe emërimi i Drejtorit të AQP-së. Krahas kësaj, sfidë që kërkon angazhim teknik nga ana e Qeverisë, është edhe miratimi i listës së shërbimeve për blerje të detyrueshme qendrore. Adresimi i kësaj të fundit, përveç tjerash, do të forconte aftësinë e Agjencisë Qendrore të Prokurimit për të kryer në mënyrë më efikase veprimtarinë e saj. Adresimi adekuat i sfidave të lartcekura do të mundësonte lehtësisht implementimin e standardeve evropiane.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet të:

- *Siguroj që kompanive të BE-së iu garantohet qasja në procedurat e dhënies së kontratës në bazë të trajtimit jo më pak të favorshëm se për kompanitë vendase, në përputhje me një periudhë kalimtare të negociuar për kompanitë e BE-së që nuk janë të themeluara në Kosovë;*
- *Siguroj që legjislacioni i prokurimit publik është në përputhje me atë të BE-së;*
- *Forcoj institucionet përkatëse dhe gjyqësorin në mënyrë që procedurat e prokurimit publik të zbatohen siç duhet.*

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, KRPP-ja do të bëjë monitorimin e zbatimit të ligjit për prokurim publik me përpikëri të plotë. Me qëllim që i tërë procesi i këtij sektori të jetë transparent dhe konform ligjit në fuqi shifra të sakta do të raportohen në mënyrë të rregullt në lidhje me procedurat e negociuara pa bërë publike njoftimin për kontratë. I po të njëjtës përpikëri do prezantohet edhe numri i interpretimeve të kërkuara nga organet përgjegjëse për ndjekje të rasteve të dyshuara. Ndër tjerash, KRPP me përgjegjësi të plotë do të bëjë monitorimin e menaxhimit të kontratës publike. Transparencës së proceseve do të kontribuojnë edhe aktivitetet e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik i cili në mënyrë të vazhdueshme do të bëjë prezantimin e numrit të ankesave, numrit të gjobave të shqiptuara për Autoritetet Kontraktuese si dhe numrit të marrjes së certifikatave të profesionalizmit për prokurim publik. Në aspektin institucional, KRPP do të marr masa konkrete për të adresuar ngritjen e kapaciteteve njerëzore fillimisht duke kompletuar stafin punues si dhe në bashkëpunim me IKAP planifikon të organizoj trajnime për stafin e prokurimit publik. Në përmbushje të personelit do të angazhohet edhe Ministria e Financave e cila do të bëjë emërimin e drejtorit të AQP-së. Më tutje, Qeveria e Kosovës do të bëjë miratimin e listës së përdorimit të artikujve për blerjen e detyrueshme qendrore e cila më tej do të fuqizoj kapacitetin e AQP-së për të kryer në mënyrë me efikase detyrimet e veta.

3.5.4. Standardizimi, Akreditimi, vlerësimi i konformitetit, Metrologjia dhe Mbikqyrja e tregut

Infrastruktura e cilësisë në Kosovë është ndërtuar në bazë të legjislacionit për standardizimin, sigurinë e përgjithshme të produktit, kërkesat teknike për produkte e vlerësim të konformitetit, si dhe për akreditim të miratuara në mënyrë progresive. Korniza ligjore përbëhet nga ligjet kyçe, siç janë: Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji për

Metrologji, Ligji për Akreditim, Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligji për Inspektoratin e Tregut.

Si institucionet kyçe për menaxhimin dhe koordinimin e politikave të akterëve përkatës të infrastrukturës së cilësisë në kuader të Ministrisë Tregtsisë dhe Industrisë janë: Këshilli Profesional për Standardizim, Këshilli Profesional për Akreditim, Departamenti i Metrologjisë, ai i Mbikëqyrjes së Tregut. Edhe përkundër arritjeve të ndjeshme në sektorin e infrastrukturës së cilësisë, e gjithë kjo është ndërtuar nga legjislacioni bazë për standardizimin, sigurinë e përgjithshme të produktit, kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, si dhe për akreditimin i cili është duke u përvetsuar në mënyrë progresive.

Ndërsa, legjislacioni i mbikëqyrjes së tregut është pjesërisht i përafuar me *acquis* të BE-së. Njëherit, Këshilli profesional për Standardizim, me koordinimin dhe hartimin e politikave për trupin e standardizimit, është operacional dhe është i përbërë nga anëtarë të sektorit publik dhe privat. Megjithatë, Qeveria e Kosovës është ende në fazën e funksionalizimit të institucioneve si dhe zbatimin e legjislacionit të ri në fuqi. Pjesë e sfidave të institucioneve përgjegjëse mbeten arritjet e objektivave për funksionalizimin e plotë si në aspektin administrativ, procedural, institucional dhe atë teknik në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që Kosova që jetë vend biznesi me interes për palët e interesuara.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sipas MSA-së, Kosova do të angazhohet që në mënyrë progresive të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis*, të miratojë standardet evropiane (EN) dhe të rrit kapacitetet institucionale për të siguruar zbatimin e legjislacionit. Në veçanti, Kosova do të jetë e nevojshme për do të duhet që të:

- i) promovoj përdorimin e rregulloreve teknike të BE-së, standardet evropiane dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;
- ii) përfundojnë, kur është e përshatshme, një marrëveshje për vlerësimin e konformitetit dhe pranimin e produkteve industriale;
- iii) nxis zhvillimin e cilësisë së infrastrukturës: standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Qeveria e Kosovës në vazhdimësi është duhet përafuar legjislacionin vendos me *acquis* të BE-së, siç është miratimi dhe implementimi i Ligjit për mbikëqyrjen e tregut, si dhe implementimi i rregulloreve teknike të konformitetit të BE-së. Pjesë e avancimeve është edhe përgaditja e studimit të kryer mbi zbatimin e rregulloreve. Pjesë e elaborimit të avancimeve do të jenë raportet periodike të përgaditura nga inspektorati, si dhe mbikëqyrja e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit (TVK-të) në mënyrë të vazhdueshme. Në vazhden e implementimit funksional të legjislacionit dhe politikave përkatëse është ngritja e vetëdijes për implementimin e standardeve e cila synohet që të realizohet përmes organizimit të ditës botërore të standardeve në vend, si dhe organizimi i gjashtë tryezave me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bizneseve për implementimin e standardeve, e gjithë kjo është pjesë përbërëse e Strategjisë Sektorale të MTI-së.

Në fushën e metrologjisë, në vazhden e punëve të Agjencisë së Metrologjisë, pjesë zhvillimore janë laboratorët ekzistues të metrologjisë në përputhje me standardet ndërkombëtare, pjesë e së cilës janë etalonet e kalibruara, njëherit krijimi i laboratorëve të rinjë (gjatësisë, presionit, kohës

dhe frekuencës). Poashtu, çertifikimi i stafit për fushat e caktuara të metrologjisë është pjesë e planit zhvillimit për implementim të mëtutjeshëm.

Së fundi por jo me më pak rëndësi është ngritja e kapaciteteve në agjencitë relevante, si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional. Këtu përfshihet trajnimi i inspektorëve të tregut dhe oficerët doganor për zbatimin e direktivave/rregulloreve teknike të produkteve industriale jo ushqimore, krijimi i databazës për shkëmbim të informacioneve konform RAPEX-it, plotësimi i sektorëve përkatës të institucioneve përmes rekrutimit të zyrtarëve shtesë, dhe sigurimi i trajnimit për funksionalizimin e bazës së të dhënave të standardeve.

3.5.5. Mbrojtja e Konsumatorit

Mbrojtja e konsumatorit është një sferë dhe problematikë me rëndësi dhe peshë të veçantë, dhe si e tillë posedon ndikim të madh në ecuritë dhe kahet e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Duke ditur rëndësinë e kësaj fushe Qeveria e Kosovës është angazhuar fuqishëm në përmirësimin e gjendjes së sektorit për Mbrojtje të Konsumatorit. Në aspektin ligjor, vlen të ceket që Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit pas ndryshimeve të ndërmarra ka hyrë në fuqi në fund të muajit Tetor, 2012. Ky ligj rregullon dhe mbron të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në tregun e lirë si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit. Ligj tjetër që synon mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të konsumatorit është Ligji për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësime të Konformitetit. Krahas kësaj, operacional është edhe Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve i cili ka për qëllim të siguroj cilësi më të lartë të produkteve në vend. Më tutje, programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014 është një projekt dinamik, me peshë dhe rëndësi të veçantë për Qeverinë e Kosovës i cili përcakton politikat adekuate për mbrojtjen e konsumatorit përgjatë periudhës së cekur. Më konkretisht, projekti synon të avancoj mbrojtjen e konsumatorit, duke e shndërruar atë në një mbrojtje cilësore, të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në relacion me shëndetin publik, ambientin, tregun e qëndrueshëm dhe krijimin e kushteve të favorshme për biznesin.

Institucionet përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë hartimin, miratimin dhe zbatimin e programit kombëtar për mbrojtjen e konsumatorit janë të themeluara dhe në ushtrim të veprimtarive përkatëse. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) përmes zyrës për Mbrojtje të Konsumatorit është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të këtij sektori. Organi këshillëdhënës i përbërë nga përfaqësues të MTI-së, shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve, përfaqësues të bizneseve dhe ekspertë të pavarur nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit është Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Përkundër progresit të shënuar, sektori për Mbrojtjen të Konsumatorit vazhdon të ballafaqohet me sfida të cilat limitojnë zhvillimin dhe funksionimin adekuat të sektorit në tërësi. Kompletimi i legjislacionit sekondar me udhëzimet administrative përkatëse është një nder sfidat kyçe, e cila kërkon përkushtim të plotë nga institucionet përgjegjëse. Sfiduese konsiderohet edhe hartimi i planit të veprimit për implementimin e programit për mbrojtjen e konsumatorit. Po aq sfiduese vlerësohet edhe ngritja e kapaciteteve institucionale, mungesa e se cilës shkakton ngecje të dukshme në sektor ngase detyrat e parapara nuk mund të realizohen në mënyrë efikase. Më tutje, në aspektin teknik nevojitet të përmirësohet sistemi i adresimit të ankesave në divizionin e Mbrojtjes së Konsumatorit. Ndër të tjera, një sistem i mirëfilltë i këtij sektori do të nxirrte në pah problemet dhe shqetësimet me të cilat ballafaqohen konsumatorët në Kosovë.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, Kosova duhet:

1. Zhvillimi i politikave aktive për mbrojtjen e konsumatorit, në përputhje me *acquis*, për të garantuar përfaqësimin e konsumatorit, informimit dhe edukimit;
2. Ngritja e kapaciteteve të strukturave administrative përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit për të siguruar shëndetin thelbësorë dhe kërkesat e sigurisë si dhe ruajtjen e interesave të konsumatorëve ekonomik.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në kuadër të plotësimit të legjislacionit sekondar do të aprovoj parimisht tre udhëzime administrative, përfshirë atë për Mallra me Defekt, Shitjet me Aksion dhe atë të Mallrave me Lirim. Me tutje, MTI në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) do të hartojnë planin për implementimin e programit për mbrojtjen e konsumatorit. Krahas kësaj, do të aprovohet rregullorja për sigurinë e ushqimit dhe do të organizohen kampanja me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve mbi fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Kur bëhet fjalë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e sistemit të adresimit të ankesave, MTI fillimisht do të plotësoj numrin e stafit të nevojshëm dhe gjithashtu do të organizoj trajnime për zyrtarët përgjegjës. Fushat e parapara për trajnim përfshinë, aftësinë e hulumtimit të dukurive negative në treg dhe aftësinë e identifikimit të çështjeve problematike me të cilat ballafaqohen konsumatorët apo mund të ballafaqohen, për të proceduar dhe adresuar ankesat me kohë. Në këtë kontekst, planifikohet të definohet roli në mes të inspektoratit dhe divizionit të konsumatorit. Gjithashtu, do të organizohen tryeza diskutimi me palët e interesit. Realizimi i sfidave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit do të ishin të mangëta po që se konsumatorët nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre dhe kështu përmes mjeteve relevante publikuese do të bëhet edhe sensibilizimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre.

3.6. Drejtësia dhe çështjet e brendshme

3.6.1. Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Sipas Kushtetutës së vendit, *sundimi i ligjit* paraqet njërin ndër parimet dhe vlerat themelore mbi bazën e së cilës funksionon shteti i Kosovës. Në këtë kontekst, Kosova ka miratuar një numër të konsiderueshëm ligjesh, duke filluar nga Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi për të Mitur dhe ligjet tjera që rregullojnë punën e policisë, prokurorisë, gjykatave, mbrojtjes së dëshmitarëve, mbrojtjes së të dhënave personale dhe sferave tjera, pjesë e sundimit të rendit dhe ligjit. Përpos kornizës legjislative, ekzistojnë edhe një sërë strategjish përmes së cilave kanalizohen detyrat dhe veprimtaria e agjencive për zbatim të ligjit si dhe gjyqësorit.

Periudha e fundit 3 vjeçare, është shoqëruar po ashtu me krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve në kuadër të institucioneve për sundim të ligjit. Me këtë rast, është aprovuar struktura e re organizative e Policisë së Kosovës si dhe janë themeluar mekanizma të rinj në kuadër të kësaj organizate. Operacionet e fundit të Policë kanë dëshmuar se efektiviteti i tyre po rritet në vazhdimësi.

Edhe përkundër arritjeve në fushën e sundimit të ligjit, sfidat vazhdojnë ta përcjellin këtë sektor. Policia e Kosovës mbetet e mangët në kapacitete për të hetuar aktivitetet e ndërlikuara kriminale, ndërsa sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, zbatimi i legjislacionit në fuqi

vazhdon të jetë i ngathët. Për të arritur progres në konsolidimin e rendit dhe ligjit, bashkëpunimi me EULEX-in duke përfshirë Task Forcën Speciale për Hetime të EULEX-it, është i domosdoshëm dhe kërkon veprim të menjëhershëm.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit, Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar që Kosova duhet të:

1. *Mbështes punën e Task Forcës Speciale për Hetime të EULEX-it*

Me qëllim të përmbushjes së kriteve për hapjen e negociatave për MSA, institucionet përgjegjëse të Kosovës i janë drejtuar me një letër shefit të misionit të EULEX-it me ç'rast konfirmohet përkushtimi i autoriteteve të vendit për të bashkëpunuar ngushtë me Task Forcën Speciale për Hetime duke zgjeruar kompetencat prokuroriale sipas nevojës. Megjithatë veprimtaria e kësaj Task Force është në fazën fillestare të hetimeve dhe ende nuk janë pranuar kërkesa për bashkëpunim.

Në kuadër të MSA-së, rendësi e veçantë i kushtohet sundimit të ligjit si dhe forcimit të institucioneve përkatëse të administratës, zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në veçanti. Një MSA efektive do të varet nga një hapësirë e sigurt, efikase dhe e parashikueshme ligjore. Autoritetet dhe një gjyqësor i pavarur që punojnë në përputhje me standardet demokratike dhe profesionale janë jo vetëm të domosdoshme për vendosjen e sundimit të ligjit por edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe si rrjedhojë edhe zhvillimin ekonomik duke përfshirë tërheqjen e investitorëve të huaj. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale duke siguruar burime të mjaftueshme për organin e pavarur mbikëqyrës dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit.

Me qëllim të krijimit të një sistemi ku sundimi i ligjit është plotësisht funksional, institucionet e vendit do të jenë të përkushtuara për ngritjen e pavarësisë dhe të kapaciteteve në kuadër të agjencive për zbatim të ligjit, gjyqësorit dhe administratës në përgjithësi. Një sërë trajnimesh të specializuara janë paraparë në këtë drejtim. Në anën tjetër, në mënyrë që të sigurohet një harmoni ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, institucionet e vendit kanë paraparë vlerësimin e konflikteve të mundshme të ligjeve në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për më tepër, Agjencia Shtetërore për Mbrojtje të Dhënave Personale do të përcjell në vazhdimësi zbatimin e legjislacionit për këtë fushë duke bërë inspektime dhe kontrolle në institucione të ndryshme vendore.

3.6.2. Azili, migrimi, politika e vizave, kontrolli i kufijve

Ligji për azilin, për shtetësinë, ai për të huajt dhe ligji mbi ripranimin janë ligjet bazë të cilat mbulojnë fushën e azilit, migrimit dhe të vizave në Kosovë, përderisa çështja e kontrollit të kufirit është e rregulluar sipas Ligjit për Mbikëqyrje dhe Kontroll të Kufirit. Këto ligje ngërthejnë në vete rregullat dhe parimet kryesore për fushat e lartpërmendura. Korniza strategjike afatmesme për çështje të migracionit, ajo për fushën e ripranimit dhe për menaxhimin e integruar të kufirit është e miratuar dhe rishikohet në bazë të rregullt. Në anën tjetër politika e vizave ngërthen në vete Vendimin për zbatim të kësaj politike dhe udhëzimet dhe dokumentet tjera relevante për mënyrën e zbatimit të saj.

Në nivel institucional, është kryesisht Ministria e Punëve të Brendshme ajo që harton politikat në fushën e azilit, migrimit, të huajve si dhe koordinon zbatimin e tyre në praktikë. Ndërsa,

menaxhimi i integruar i kufirit koordinohet në bazë të strukturës koordinuese si dhe në përputhje me Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, që udhëhiqet nga Koordinatori Nacional dhe përfshinë një bashkëpunim të ngushtë në mes të Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Menaxhimi i kufijve të jashtëm të vendit mbështetet në parimin “*kufij të hapur, por të sigurt*”. Sa i përket sigurisë së dokumenteve, Kosova ka kornizën ligjore në fushën e gjendjes civile, si dhe ka miratuar masa për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme nga zyrtarët përgjegjës në këtë fushë.

Me gjithë progresin e arritur në fushën e riintegritimit, azilit, migrimit dhe kontrollit të kufijve, Kosova ka ende përpara saj një numër sfidash që duhen adresuar, ndër të cilat hyn plotësimi ndryshimi i Ligjit mbi Azilin si dhe harmonizimi me *Acquis* i politikës së Kosovës për viza. Në këtë drejtim, ekziston nevoja të bëhet ngritja e kapaciteteve që punojnë në këto fusha. Sfidat që e përshkojnë fushën e ripranimit kanë të bëjnë kryesisht me bashkëpunimin me shtetet që parashtrajnë kërkesa si dhe arritjen e marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës apo transitit, ndërsa një ndër sfidat në fushën e riintegritimit është vendosja e sistemit për menaxhimin e rasteve. Sa i përket sigurisë së dokumenteve, ekzistojnë ende dyshime nëse janë arritur të gjitha kushtet në mënyrë që dokumentet e lëshuara të jenë plotësisht të besueshme.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova do të ketë nevojë që të sigurojë një kornizë për bashkëpunim, duke përfshirë nivelin rajonal, në fushën e vizave, kontrollit të kufirit/vijës kufitare, azilit dhe migrimit (të rregullt dhe jo të rregullt). Një element qendror i bashkëpunimit në fushën e parandalimit dhe kontrollit të migrimit të parregullt do të jetë zbatimi i dispozitave për ri-pranim dhe përqendrimi në shkëmbimin e statistikave dhe shtimit të efikasitetit dhe kapaciteteve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim, institucionet e Kosovës do të bëjnë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Azil me ç’rast do të sigurohet përputhje e plotë me legjislacionin relevant të BE-së dhe do të përfshihen rekomandimet e UNHCR-së lidhur me kushtet për pranimin e azil-kërkuesve. Sa i përket ngritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve të vendit, hapa konkret janë paraparë në këtë drejtim duke filluar me vendosjen e sistemit për menaxhimin e rasteve dhe integrimin e bazave të të dhënave. Ripranimi do të vazhdojë të mbes në fokus të institucioneve të Kosovës, ku në këtë drejtim Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me atë të Punëve të Jashtme është duke iniciuar/zhvilluar negociata për arritjen e marrëveshjeve me shtete të tjera. Sa i përket kontrollit të kufirit, demarkacioni i kufirit me Malin e Zi është paraparë të ndodhë deri në fund të vitit 2012, ndërsa në fushën e vizave Kosova do të bëjë rishikimin e Vendimit për politikën e vizave dhe do të sigurojë që ky vendim si dhe Udhëzimet Administrative të kësaj fushe janë në përputhje me *Schengen Aquis*. Sa i përket çështjes së dokumenteve personale, Kosova ka paraparë një sërë masash të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e sigurisë së dokumenteve. Këto masa përfshijnë, ndër të tjera, bashkëpunim më të ngushtë në mes të institucioneve që punojnë në fushën e sigurisë së dokumenteve dukë përfshirë ARC-së, policinë dhe gjykatat.

3.6.3. Shpërlarja e parave

Kosova është në proces të miratimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Këto plotësim-ndryshime janë bërë duke u bazuar në Raportin e Fizibilitetit dhe Udhërrëfyesin për

Liberalizimin e Vizave me synimin që legjislacioni i Kosovës për këtë fushë të jetë në përputhje me *acquis*. Kosova ka miratuar strategjinë pesë (5) vjeçare për parandalimin e shpërlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit.

Institucionet kyçe për luftimin e shpërlarjes së parasë janë në vend dhe funksionale. Në kuadër të Ministrisë së Financave funksionon Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) e cila ka përgjegjësi luftimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parasë. Kjo njësi ka marrë përgjegjësitë nga qendra e inteligjencës së EULEX-it. Po ashtu në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon Departamenti për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit i cili zhvillon hetimet për rastet e dyshimta të pastrimit të parasë. Në kuadër të Doganave funksionon Departamenti i Hetimeve që ka mandat zbulimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parave. Këto institucione në baza të rregullta koordinojnë aktivitete në luftë kundër shpërlarjes së parasë.

Megjithatë në fushën e parandalimit dhe luftimit të shpërlarjes së parave sfidë mbetet miratimi i Ligji të plotësuar-ndryshuar për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i cili duhet të jetë në përputhje me *acquis* dhe i cili si i tillë duhet miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Me gjithë themelimin e NJIF-it dhe ndihmën e ofruar nga institucionet tjera, Kosova duhet të sigurojë ndarjen e qartë të përgjegjësisive të institucioneve të cilat merren me parandalimin e shpërlarjes së parave si dhe duhet të sigurohet që kapacitetet e këtyre institucioneve i nënshtrohen trajnimeve adekuate.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshjen Stabilizim Asociimit, Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar këtë kriter afatshkurtër që duhet përmbushur për të filluar negociatat e MSA-së:

1. *Plotësim-ndryshimi i ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.*

Me qëllim të përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Qeveria e Kosovës do ta dërgojë Ligjin e plotësuar-ndryshuar për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, për miratim në Kuvend.

Sipas MSA-së Kosova do të ketë nevojë që të krijojë një kornizë për bashkëpunim me qëllim të parandalimit të përdorimit të sistemeve financiare për shpërlarjen e parave dhe përdorimin e tyre në aktivitete kriminale. Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë asistencën teknike dhe administrative me qëllim të vendosjes së standardeve të duhura për t'iu kundërvënë pastrimit të parave dhe që janë në përputhje me standardet e miratuara nga BE-ja dhe organet tjera ndërkombëtare në këtë fushë e në veçanti të TFVF-ve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, do të bëhet caktimi i Koordinatorit Nacional për zbatimin e Strategjisë për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, i cili do të mundësojë koordinim më të mirë në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në luftimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parasë. Për më tepër, është paraparë hartimi i PSO-së që do të përfshijë Doganat, Policinë, ATK-në dhe NJIF-in si dhe do të hartohet një doracak lidhur me tipologjitë e shpërlarjes së parasë. Në vazhden e raportimit të statistikave në luftimin e shpërlarjes së parasë, institucionet relevante do të harmonizojnë statistikave të tyre në mënyrë që të sigurohen të dhëna të sakta dhe të besueshme.

3.6.4. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin

Progres i dukshëm është shënuar në luftimin e krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale. Korniza ligjore bazë është konsoliduar duke përfshirë Kodin e ri Penal, atë të Procedurës Penale si dhe ligjet tjera që mbulojnë këtë fushë. Korniza strategjike ngërthen në vete një sërë strategjish, një numër i të cilave është rishikuar dhe miratuar në shtator të këtij viti (Strategjia kundër krimit të organizuar, kundër trafikimit me narkotikë, kundër trafikimit me qenie njerëzore, kundër terrorizmit).

Institucionet përkatëse për luftim të krimit të organizuar janë të themeluara dhe përgjatë tri viteve të fundit kanë përmirësuar kapacitetet dhe efikasitetin e tyre. Struktura kryesore për luftimin e krimit të organizuar përfshinë zinxhirin Polici – Prokurori - Gjykata. Në këtë kontekst, Policia e Kosovës ka vazhduar me zgjerimin e kapaciteteve të saj duke bërë themelimin e strukturave të reja të nevojshme për bashkëpunim ndërkombëtar dhe për mbrojtje të dëshmitarëve. Në përpjekjet e vazhdueshme për luftimin e krimit të organizuar, statistikët dëshmojnë se Policia e Kosovës, gjatë këtij viti ka arritur rezultatet më të mira në luftimin e krimit të organizuar e posaçërisht në luftimin e trafikimit me narkotikë, ku statistikët dëshmojnë për një ngritje 100% të rezultateve. Plani i veprimit të POLICISË për vitin 2013 është i gatshëm dhe parasheh ngritje të dukshme të të arriturave në luftimin e krimit të organizuar.

Megjithatë, sfidë mbetet çështja e miratimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë të fituar me veprë penale.. Ky ligj, duhet të jetë në përputhje me standardet dhe praktikën evropiane në këtë fushë.

Me gjithë rezultatet e arritura në zbulimin dhe dënimin e krimit të organizuar, ekzistojnë sfida lidhur me harmonizimin e statistikave në këtë fushë. Statistikat shpesh-herë raportohen në mënyra të ndryshme nga institucione të ndryshme gjë që krijon paqartësi. Luftimi i trafikimit me njerëz, kontrabandës me imigrantë, trafikimit të narkotikëve, të armëve, vazhdojnë të mbeten sfidë për institucionet e Kosovës.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit, Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar këto kritere afatshkurta:

1. *Miratimi i legjislacionit lidhur me konfiskimin e pasurisë të fituar me veprë penale*
2. *Demonstrimi i një vullneti të qartë për të sjellë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë nisjen e hetimeve*
3. *Bashkëpunimi i mirë me EULEX-in*

Me qëllim të përmbushjes së kritereve të mësipërme, Kosova gjatë këtij viti do të bëjë miratimin e Ligjit mbi konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë është në proces të rishikimit të pesë (5) ligjeve themelore që rregullojnë sistemin gjyqësor, ndërsa institucionet e zbatimit të ligjit si dhe gjyqësori janë të përkushtuara që përmes rezultateve të arritura të dëshmojnë suksesin në luftimin e krimit të organizuar. Në drejtim të bashkëpunimit me EULEX-in, pas ftesës që i është bërë nga ana e Presidentes së Kosovës për zgjatje të mandatit të këtij misioni, Kuvendi i Kosovës ka bërë ratifikimin e marrëveshjes së arritur midis BE-së dhe Republikës së Kosovës për misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë. Në anën tjetër Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

si dhe Ministria e Drejtësisë, i janë drejtuar më një ftesë EULEX-it në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proceset e rekrutimit të prokurorëve, gjyqtarëve dhe stafit të lartë në Shërbimin Korrektues.

Sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova duhet të zhvillojë një kornizë për bashkëpunim me qëllim të synimit të parandalimit dhe luftimit të aktiviteteve kriminale, sidomos krimet të organizuar. Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçante çështjeve të tilla si: trafikimi i qenieve njerëzore, aktiviteteve të paligjshme ekonomike (siç janë korrupsioni dhe transaksionet e paligjshme që përfshijnë mallrat si: prodhimet e falsifikuara, mbeturinat industriale dhe materiali radioaktiv) trafikimi i ndaluar i armëve dhe terrorizmi. Kosova gjithashtu duhet të jetë e gatshme të përballet me shëndetin dhe pasojat sociale të abuzimit me drogë , parandalimin e diversioneve në stabilimentet kimike dhe të përforcoje strukturat e veta në luftën kundër trafikimit të drogës.

Me qëllim të përmbushjes së përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe krimeve të tjera, Kosova do të miratojë Ligjin mbi përgjimet që do të ofrojë një kornizë ligjore për të rregulluar këtë fushë. Në nivel zbatimi, do të bëhet integrimi i bazës së të dhënave të institucioneve të zbatimit të ligjit, gjë që do të përmirësoj kualitetin e statistikave të luftimit të krimit të organizuar. Më tutje do të vazhdojë ngritja e kapaciteteve në agjencitë dhe institucionet që luftojnë krimin e organizuar përmes ofrimit të trajnimeve të specializuara.

Kosova do të iniciojë marrëveshje ndërkombëtare si dhe anëtarësim në organizata relevante ndërkombëtare për luftim të krimit. Këto përpjekje për bashkëpunim ndërkombëtar do të bëhen në koordinim me mekanizmat ndërkombëtar që veprojnë në Kosovë.

3.7. Politika e bashkëpunimit

3.7.1. Bashkëpunimi ekonomik, monetar, statistikor dhe mbrojtja e interesit financiar të BE-së

Statistikat

Kosova ka përmirësuar dukshëm legjislacionin për statistikën i cili kryesisht është në harmoni me acquis. Legjislacioni bazë për statistika është Ligji për Statistikat Zyrtare ku ky ligj përcakton standardet për zhvillimin, prodhimin dhe publikimin e të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në përputhje me standardet e BE-së, janë bërë edhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Procedurat Tatimore që tani e lejojnë Administratën Tatimore që t'i ofrojë ASK-së të dhënat e nevojshme administrative për regjistrin statistikor të bizneseve. Gjithashtu, Kosova ka përgatitur planin vjetor të punës 2013 dhe Planin Strategjik 2013-2017 për statistika zyrtare me qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të kualitetit të të dhënave statistikore në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pjesë përbërëse e dokumenteve të lartcekura është edhe projekti mbi regjistrimin e bujqësisë, ku tani më është realizuar regjistrimi testues si dhe ASK-ja gjendet në vazhden e përgatitjeve për regjistrimin e përgjithshëm të bujqësisë në Nëntor të vitit 2013.

Me qëllim të avancimit dhe ngritjes së autoritetit të ASK-së dhe zvogëlimin e niveleve hierarkike të komunikimit Agjencia e Statistikave të Kosovës është zhvendosur nga Ministria e Administratës Publike në Zyrën e Kryeministrit. Gjithashtu, si rezultat nga Ligji për Statistika Zyrtare është themeluar Këshilli Statistikor si organ këshillëdhënës, lidhur me prodhimin e statistikave të ndryshme zyrtare, këshill i cili ofron rekomandime, këshilla, monitorim,

vlerësim, mbështetje dhe sigurim të cilësisë së statistikave. Ndërsa Institucionet kyçe përgjegjëse për prodhimin dhe menaxhimin e Statistikave janë: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Ministria e Financave (MF) dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Ndërsa ASK-ja, është përgjegjëse kryesorë për mbikëqyrjen dhe koordinimin e të dhënave statistikore zyrtare.

Kosova ka miratuar ligjin për statistika zyrtare, themeloi këshillin statistikor, si dhe zhvendosi ASK-në në zyrën e kryeministrit por për përmirësimin të mëtejshëm të gjendjes së statistikave në Kosovë duhet të kalohen disa sfida. Një prej sfidave është edhe përmirësimi i cilësisë së statistikave në të gjitha fushat statistikore, por sidomos në fushat e biznesit dhe statistikave makroekonomike si dhe të ketë përputhje mes të dhënave statistikore të BE-së dhe të dhënave statistikore në Kosovë. Në këtë kontekst, Kosova duhet të prodhojë statistika afatshkurta në baza tremujore (indikator afatshkurtër) sidomos për çështjet makroekonomike, të tilla si tregtia dhe punësimi. Ndër të tjera, si sfida është i nevojshëm forcimi i menaxhimit të agjencisë për zhvillimin e institucionit dhe sistemit statistikor të Kosovës dhe rritjen e kapaciteteve të saj në fushën e statistikave prodhuese dhe administrative. Ndërsa, disa sfida të Bashkëpunimit ekonomik janë përgatitja për pjesëmarrje në programin ekonomik dhe fiskal të para-anëtarësimit si dhe rritja e kapaciteteve analitike për vlerësime dhe parashikime makroekonomike.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova duhet të zhvillojë sisteme statistikore të afta për të siguruar të dhëna, të besueshme, objektive, të sakta dhe në kohë të duhur që janë të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar tranzicionin dhe reformimin.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit për zhvillim institucional të ASK-së do të bëhet harmonizimi i Legjislacionit sekondar, zbatimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për riorganizimin e ASK-së që parasheh krijimin e departamentit për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, për më tepër do të bëhet forcimi i departamentit të Teknologjisë Informativ (TI) si dhe do të ketë pjesëmarrje aktive nëpër seminare, vizita studimore, punëtori të cilat kanë në funksion aftësimin profesional të stafit të ASK-së. Për të përmirësuar statistikën të bizneseve dhe statistikën makroekonomike do të zbatohen rekomandimet e Eurostat-it, si kalimi nga platforma NACE Rev.1 në NACE Rev.2, do të bëhet përfshirja e njësive lokale në Regjistrin Statistikor të Bizneseve si dhe do të themelohet regjistrit për grupet e ndërmarrjeve; ndërsa në fushën e statistikave sociale do të prodhohen indikatorët statistikor të tregut të punës (punësimi dhe papunësia) si dhe shtimi i disa variablove për matjen e të ardhurave në ekonomitë familjare (përmes variables SILC) në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF). Ndërsa sa i përket bashkëpunimit ekonomik do të bëhet përgatitja për pjesëmarrje në programin ekonomik dhe fiskal të para-anëtarësimit si dhe do të rriten kapacitetet analitike për vlerësime dhe parashikime makroekonomike përmes trajnimeve të mbajtura për vlerësime dhe parashikime makroekonomike.

3.7.2. Promovimi dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, NVM-të dhe turizmi

Korniza ligjore e institucioneve të Qeverisë së Kosovës plason rrugën e promovimit dhe mbrojtjes së investimeve e cila është e bazuar në Ligjin për të Huajt, ligj ky i cili siguron trajtimin jo diskriminues të investitorëve të huaj në Kosovë. Në vazhden e krijimit të kushteve sa më të favorshme për investimet e huaja, institucionet përgjegjëse të Kosovës gjatë tri viteve të

fundit kanë miratuar disa amandamente siç është eliminimi i kapitalit fillestar dhe ulja e numrit të lejeve të nevojshme. Për më tepër, është pergatitur një Draft Strategji Përkrhëse për Investimet Sektoriale që përfshinë rekomandime dhe veprime operative për përmirësimin e biznesit dhe klimës së investimeve. Kjo strategji identifikon sektorët kryesor që synohen nga aktivitetet promovuese, siç janë: procesi i biznesit me burim të jashtëm, komponentëve automobilistike, kontratat e shërbimeve prodhuese të komunikimeve elektronike dhe agrobiznesit.

Veprimtaria dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) është e bazuar në ligjin për shoqëritë tregtare si dhe ligji për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-ve). Ligji për mbështetjen e NVM-ve është plotësuar në vitin 2007 duke u harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për NVM-të. Me ligjet e saja si parime, Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM) si institucion kyç ka edhe një numër të veglave dhe aktivitetëve që përdor për të mbështetur e nxitur konkurrentshmërinë në sektorin privat, duke u nisur nga bizneset mikro familjare e deri tek ndërmarrjet e mesme. Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion 2020 është miratur nga Qeveria e Kosovës me qëllim të mbështetjes së fuqishme të NVM-ve, ngase më shumë se 99% e ndërmarrjeve në Kosovë janë NVM-të dhe këto kanë efekt të dukshëm në Zhvillimin Ekonomik të Kosovës. Në tërësi, sektori i ndërmarrjeve të vogla dominon në Kosovë me rreth 90% të ndërmarrjeve që kanë të punësuar më pak se katër persona. Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve është e bazuar në dy shtylla kryesore "Aktin Evropian për Biznese të Vogla (ABV) që Kosova është përkushtuar të zbatojë dhe Programet e BE-së për Konkurrueshmërinë dhe Inovacione (CIP) që Kosova aspiron të marr pjesë në një të ardhme të afërt. Për më tepër, Grupi Punues për Strategjinë e NVM-ve ka analizuar dhe ka marr parasysh Vizionin dhe Prioritetet Qeveritare për Zhvillim Ekonomik. Komponentet kryesor të kësaj strategjie kanë në fokus përmirësimin e mjedisit të biznesit, vendosja e dialogut publiko-privat dhe Koordinimi i Donatorëve, përmirësimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë, si dhe fushata e Informimit Publik. Gjithashtu, Agjencia e NVM-ve është institucioni kryesor përgjegjës që miratimin e strategjive të fondeve prej 1.3 milion € dhe 30 milion € nga komuniteti i donatorëve.

Agjencia Kosovare për Promovimin e Investimeve (APIK) në kuadër të MTI-së është institucioni qendror që përqëndrohet në përpjekjet për të tëhequr investimet e huaja direkte (IDH). Objektivat kryesore të këtij agjencioni janë përpjekjet për të tërhequr Investimet Direkte të Huaja me anë të liberalizimit të mëtejshëm të regjimit të hyrjeve si dhe promovimin e NVM-ve në konkurrim. Hyrjet neto të FDI-ve janë vlerësuar të kenë arritur 394.6 milion € (8.6% e PBB-së) në vitin 2011 pak më lart se 365.8 milion €.

Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM) është agjenci në kuadër të MTI-së, e cila si fokus primar ka zhvillimin e sektorit privat në Kosovë duke krijuar kushte më të mira për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. AMNVM është themeluar në dhjetor të vitit 2006 pasi është nxjerrë urdhëresa administrative Nr.2006/28. Ligji për mbështetjen e NVM-ve është plotësuar në vitin 2007 duke u harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për NVM-të. Me ligjet e saja si parime, AMNVM ka edhe një numër të veglave dhe aktivitetëve që përdor për të mbështetur e nxitur konkurrentshmërinë në sektorin privat, duke u nisur nga bizneset mikro familjare e deri tek ndërmarrjet e mesme. Njëherit Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare është institucioni përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të reja dhe ri-regjistrimin e tyre. Vlen të theksohet se përkushtimi i institucioneve kosovare në zbatimin e

parimeve kyçe të dokumentit të BE-së për biznesin e vogël ka qenë pjesë e prioriteteve të implementuara.

Edhe përkundër arritjeve të deri tanishme në spektrin e ligjshmërisë dhe ngritjes së institucioneve, pjesë e mëtutjeshme e zhvillimeve është përfundimi i implementimit të politikave dhe strategjive në sektorët përkatës me të cilat Qeveria e Kosovës duhet të meret në vijim. Pjesë e nevojshme për të ndryshuar është thjeshtëzimi dhe rishikimi i legjislacionit të politikave për ndërmarrjet. Është e nevojshme poashtu vlerësimi i ndikimit rregullator përmes një analize përkatëse. Kostot e pajtueshmërisë mbeten ende të larta. Pjesa e shkëmbimit të të dhënave, mungesa e informacionit të plotë, qasja jo e lehtë dhe e përditësuar në mënyrë të rregullt e informacionit për çështjet e rëndësishme është pjesë e një pengese të rëndësishme për NVM-të që operojnë në Kosovë. Për më tepër, të katër inkubatorët ekzistues janë ende në një pilot-fazë dhe skema "voucher" është ndërprerë në vitin 2011. Kosovës i duhet që të vë në linjë mbështetjen e saj për NVM-të me Deklaratën Evropiane për Biznes të Vogël dhe të përmirësojë klasifikimin e ndërmarrjeve. Është e nevojshme sigurimi i qasjes më të lehtë të NVM-ve në financa. Në tërësi, industria dhe zhvillimi i NVM-ve vazhdon të ketë vështirësi në zbatimin ligjor të kontratave, furnizimin jo të sigurt me energji dhe qasje të kufizuar e të shtrenjtë në financa. Edhe pasi është përmirësuar komunikimi midis institucioneve arsimore dhe NVM-ve, në vazhdimësi duhet të rritet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre, sidomos në fushën e ndërmarrjes dhe politikës industriale (autoritetet publike, dhoma e tregtisë, shoqatat bankare, gjykatat, agjencitë rajonale të zhvillimit, etj). Mbetet të miratohen në përgjithësi plani i zbatimit për NVM-të dhe strategjitë industriale. Krijimi i një buxheti adekuat për autoritetet përgjegjëse do të forconte mëtutje veprimtarinë e institucioneve përkatëse. Pjesë sfiduese njëherit mbetet sektori jozyrtar i Kosovës me të meta në politikat e taksave dhe shpenzimeve si dhe në zbatimin e ligjit, që përfshihet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këto ndikojnë direkt në ekonominë joformale, përmes zvogëlimit të bazave tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike. Poashtu, turizmi i cili ngërthen në vete një potencial të konsiderueshëm për kontribim në rritjen ekonomike të vendit është e nevojshme të investohet në infrastrukturën e saj. Së fundi, vlenë për tu theksuar se sfidë madhore e institucioneve ekonomike të vendit mbetet tërheqja e IDH-ve në Kosovë.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Bashkëpunimi sipas MSA-së do të synojë të mbështesë Kosovën në krijimin e një klime të favorshme për investimet private si vendase ashtu edhe të huaja për të promovuar ri-vitalizmin ekonomik dhe industrial. Në veçanti Kosovës do ti duhet të vazhdojë edhe në krijimin e një kornize ligjore me mundësi të favorshme për investime dhe nxitjen e tyre.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, institucionet e Kosovës do të ndërmarrin veprimet e nevojshme në përmirësimin e kushteve të bërit biznes. Kjo synohet të arrihet përmes organizimit të konferencave me komunat për shkëmbimin, elaborimin si dhe ngritjen e vetëdijës në nivel të përgjithshëm për përmirësimin e kushteve administrative dhe atyre teknike të bërit biznes. Këtu përfshihet krijimi i sistemit të përcaktimit të një numri unik të regjistrimit të biznesve. Do të avancohet mënyra e regjistrimit të bizneseve përmes ofrimit të këtij shërbimi në mënyrë elektronike online. Kosova në vazhdimësi synon dhe do të punojë në rritjen e numrit të marrëveshjeve për mbrojtjen e investimeve. Do të organizohen konferenca në vazhdimësi për promovim të investimeve dhe eksporteve. Njëherit, indeksi i politikave të BE-së për biznesin e vogël do të bazohet në raportimin e rregullt. Pjesë

zhvillimore është edhe krijimi i kategorizimit të ndërmarrjeve e cila përfshinë krijimin e databazës dhe studimin mbi ndërmarrjet ekzistuese, duke i klasifikuar dhe kategorizuar atë në baza sektoriale. Me qëllim të lehtësimit të qasjes në financa të NVM-ve, do të bëhet studimi mbi mundësitë dhe modalitetet e krijimit dhe funksionimit të skemës së garantimit të kredive, aplikimi për anëtarësim në institucionet zhvillimore të BE-së (CIP, EU SME Ëeek) dhe donatorëve tjerë me qëllim të krijimit të instrumentëve financiarë për lehtësimin e qasjes së NVM-ve në financa. Poashtu, Qeveria e Kosovës synon të anëtarësohet në CIP dhe EU SME Ëeek. Krijimi i një fondi për funksionalizimin e skemës për garantimin e kredive do të mbështesë edhe më tej sektorin e NVM-ve. Njëherit pjesë e objektivave është krijimi i një fondi për subvencionimin e NVM-ve. Së fundi, po jo me më pak rëndësi mbetet ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore dhe NVM-ve për ndërmarrje dhe politika industriale, e cila synohet të arrihet nga institucionet e vendit përmes implementimit të Programit "Internship Biznesi" për 200 studentë, funksionalizimit të Këshillit Konsultativ të NVM-ve, si dhe shtimin e lëndës për ndërmarrësi në kurrikulën e arsimit të ulët (MASHT).

3.7.3. Bujqësia

Bujqësia është sektor i rëndësishëm ekonomik i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovë. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimtari të ulët dhe mungesën e shërbimeve këshillimore të avancuara, por edhe përkundër kësaj ajo kontribuon me përafërsisht 12 % në BPV (bruto prodhimi vendor) të Kosovës, punëson në mes të 25% deri 30% të punësimit të përgjithshëm, kryesisht në sektorin joformal dhe përbën rreth 16% të vlerës së eksportit total. Rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale. Sektori i bujqësisë dhe Zhvillimit rural karakterizohet me legjislacion të avancuar, ku deri më tani janë miratuar një sërë projektligjesh të cilat kanë krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e sektorit në fushën e verëtarisë, prodhimit dhe përpunimit të duhanit, bujqësisë organike, rregullimit të tokës, shërbimeve këshillimore, mbrojtjes së bimëve dhe zhvillimit rural. Në anën tjetër, siguria ushqimore, karakterizohet me legjislacion të avancuar primar dhe sekondar. Tri ligjet bazike, Ligji i Veterinarisë, Ligji Mirëqenies së kafshëve dhe Ligji i Ushqimit, përbëjnë bazën ligjore për krijimin e kushteve për përmirësimin dhe plotësimin e standardëve të BE-së. AUVK ka adaptuar një sërë aktesh nën ligjore të cilat janë në harmoni me kapitullin 12 të acquis për siguri ushqimore dhe çështjeve veterinare.

MBPZHR është në proces të hartimit të Strategjisë dhe Planin e ri për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural 2014-2020, janë paraparë gjashtë prioritetet, të cilat do të arrihen me tetë masa, ku përveç masave të zhvillimit rural janë shtuar edhe masat e përkrahjes së drejtpërdrejt duke dhënë një pasqyrë më të qartë të aktiviteteve të zbatuara dhe planifikuara në sektorin e bujqësisë. Strategjia bazohet në dispozitat e Rregullores së Këshillit për Përkrahjen e Zhvillimit Rural 2007-13 (Rregulloren e Këshillit 1698/2005) dhe Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EFARD). Me qëllim të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, Kosova ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, synimi i së cilës është zhvillimi dhe mbrojtja e qëndrueshme e pyjeve. Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2012-2016 e cila është duke u implementuar, synon trajnimet për staf dhe shërbimet e ofruara për fermerë, me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore. Krahas kësaj, Kosova është duke implementuar Strategjinë për konsolidim të tokës 2010-2012 dhe planin veprimit për implementimin e kësaj strategjie. *Qëllimi i Strategjisë* është të krijoj një vizion afatgjatë për implementim të rregullimit të tokës në Kosovë. Është ngritur dhe funksionon sistemi i thjeshtë i Identifikimit të parcelave të tokës (sLIPS) dhe është hartuar mastër plani për

implemtimin e sistemit te (LPIS-it). Gjithashtu, Kosova ka miratuar strategjinë për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore e cila ka për qëllim ngritjen e cilësisë së përgjithshme të operatorëve me ushqim, higjienës së hapësirave prodhuese, ushtrimit të praktikave të mira prodhuese dhe higjienike, testimeve laboratorike të produkteve dhe ushtrimit të kontrollit nga vetë operatorët e bizneseve. AUVK gjatë vitit të fundit, ka ngritur kapacitet njerëzore për 20 pozita të reja, ka përfutuar buxhet shtesë për ndërtimin e fabrikës së riciklimit dhe ka arritur progres në sigurimin e hapësirave për funksionalizimin e zyrave regjionale.

Gjatë viteve të fundit, Qeveria e Kosovës i ka dhënë prioritet sektorit të bujqësisë, duke ndarë mjete të konsiderueshme, ku përmes dhjetë skemave mbështetëse i ka përfshirë rreth 15 mijë fermer në strukturën e mbështetjes përmes investimeve dhe pagesave direkte për mbështetjen e projekteve të ndryshme si dhe Grupet Lokale të Veprimeve (GLV-ve). Për realizimin e projekteve dhe planeve të veprimit, me Programin Nacional për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013 janë bërë pagesa direkte dhe grante për fermerë, të cilat korrespondojnë edhe me masat e Shtyllës I dhe II të Politikave të Përbashkëta Bujqësore të BE-së. Prandaj kjo mbështetje ka pasur ndikim shumë pozitiv në orientimin e fermerëve në drejtim të rritjes së kualitetit të prodhimit, zbatimin e praktikave të prodhimit sipas standardeve të BE dhe rritjen e shkathtësive për menaxhim të qëndrueshëm të fermës. Në anën tjetër, pylltaria në Kosovë ofron kushte edhe për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve përpunuese, duke u fokusuar në përdorimin e teknologjive të reja dhe të avancuara të përdorimit të drurit me diametër të vogël në përpunim. Në Kosovë, për ç' do vit pyllëzohen rreth 500 ha.

Institucioni kryesor për implementimin e politikave bujqësore është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila po ashtu është përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e politikave nacionale, legjislacionit dhe akteve nënligjore. Me qëllim të implementimit të politikave dhe legjislacionit në fuqi janë themeluar disa institucione të reja.

Strukturat kryesore të cilat janë përgjegjëse për realizimin e PZHRB 2007-2013 të cilat korrespondojnë me Politikën e Përbashkëta Bujqësore janë : Autoriteti Menagjues (AM) i cili menaxhon Programin për Zhvillim Rural; Komiteti Monitorues (KM) i cili monitoron PZHRB 2009-2013; Bordi për Menaxhimin e Pyjeve, i cili menaxhon dhe mbikëqyrë politikën pyjore dhe implementimin e strategjisë së pyjeve. Departamenti i analizave ekonomike i cili është përgjegjës për analiza sektoriale dhe analiza tjera të kostove të prodhimit dhe kostove të investimit Po ashtu është themeluar Departamenti për Shërbimet Këshillimore, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave për shërbimet këshillimore dhe Departamenti i Pagesave i cili ekzekuton pagesat direkte dhe grante investuese. Ndërkaq, autoriteti kompetent për hartimin e legjislacionit dhe implementimin në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarë është AUVK.

Edhe përkundër rritjes së buxhetit dhe arritjeve tjera, sektori i bujqësisë dhe zonat rurale të Kosovës po ballafaqohen me sfida të mëdha të cilat kanë krijuar pasiguri për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës, dhe krijimit të mirëqenies për banorët e tyre zonave edhe përkundër asaj se këto zona, posedojnë kushte të favorshme agro mjedisore, të cilat janë kusht për zhvillimin rural dhe të bujqësor. Për të ristrukturuar sektorin e bujqësisë që të jetë në linjë me atë në BE-së dhe për të përmirësuar standardin e jetesës së popullatës rurale në Kosovë, duhet përmirësuar aftësitë e saj konkurruese, produktivitetin dhe kualitetin e prodhimeve bujqësore. Po ashtu, sfida mbetet

themelimi i strukturave të reja dhe avancimi më i madh i kapaciteteve në hartimin, implementimin dhe monitorimin e politikave bujqësore.

Sfiduese gjithashtu është prerja e pyjeve dhe shfrytëzimi i tyre si resurse ekonomike. Edhe përkundër pyllëzimit të pyjeve për ç' do vit dhe masave silvikulturore, Kosova ballafaqohet me prerje të pa ligjshme nga personat fizik. Kësaj dukurie po i shkon përshtati edhe neglizhenca e gjykatave (zvarritja e lëndëve), gjobat tejet të ulëta dhe mos ekzistimi i alternativave për ngrohje. Gjithashtu zjarret dhe sëmundjet e pyjeve janë sfera ku duhet mobilizim edhe më i madh. Përderisa, në sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, sfidë mbetet transferimi i plotë i inspektorëve komunal në AUVK e po ashtu edhe implementimi i strategjisë për ndërmarrjet agro-ushqimore. Në aspektin e politikave, mbetet sfidë edhe hartimi i strategjive për ndalimin e therjeve ilegale, kontrollin e tregjeve të kafshëve. Për më tepër, akreditimi i laboratorit të Ushqimit sipas ISO 17025, ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe futjen sistematike të dhënave në databazë për identifikimin, lëvizjen, therjen e kafshëve, mbeten një nga sfidat kryesore në sektorin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve.

Bashkëpunimi në kontekstin e MSA-së do të synojë të ndihmojë Kosovën në modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial. Në veçanti kjo do të përfshijë bashkëpunimin me prodhuesit dhe autoritetet rregullative për të ndihmuar ato në përmbushjen e kritereve të sigurisë së ushqimit dhe standardeve të kualitetit të BE-së si dhe standardet e BE-së për shëndetin e kafshëve dhe bimëve në forme të ndihmës, trajnimit dhe organizimit të kontrollit më qëllim të harmonizimit gradual me standardet e BE-së; zhvillimi i shtuar i fermave private dhe kanaleve të shpërndarjes, metodave të ruajtjes dhe tregtimit; modernizimi i infrastrukturës rurale (transporti, telekomunikacioni, furnizimi me ujë, menaxhimi i mirë i pyjeve në balancimin e ruajtjes së pyjeve me shfrytëzimin e burimeve ekonomike, përmirësimin e produktivitetit dhe kualitetit duke përdorur metodat dhe prodhimet e duhura; trajnimit dhe mbikëqyrjen në përdorimin e metodave kundër ndotjes lidhur me të dhënat mbi; zhvillimin e metodave të qëndrueshme bujqësore (përfshirë prodhimet organike; zhvillimin dhe modernizimin e firmave për përpunim dhe metodave të tyre të marketingut, nxitjen e bashkëpunimit industrial në bujqësi dhe shkëmbimet e përvojave.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, nga aspekti ligjor, do të miratohen: Projektligji për pyjet, blegtorinë, farërat, materialin fidanorë, OMGJ-të, Ushqimit dhe projektligji i Regjistrimit të bujqësisë.

Institucionet e Kosovës me masat e parapara me Planin e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2007-2013 do të vazhdojnë implementimin e masave (1, 2, 3, 4, 5 dhe 8). Me Masën 1 do të ngritën kapacitetet administrative dhe profesionale në të gjitha fushat, me masën 2 do të vazhdohet me ristrukturimin e potencialit fizik të fermave me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese. Do të investohet në rehabilitimin e sistemit të ujitjes; sistemet primare, sekondare dhe terciare të ujitjes (masa 3); Ndërsa sa i përket përmirësimit të përpunimit dhe marketingut bujqësor, me Masën 4 synohet përmbushja e standardeve të BE-së sa i përket cilësisë së ushqimit, ku prodhuesit dhe përpunuesit do të ndihmohen në të gjitha skemat e cilësisë së ushqimit duke promovuar cilësinë dhe sigurinë e prodhimeve ushqimore. Janë paraparë veprime konkrete, ku do të ndërtohen depo për grumbullim, ruajtje dhe klasifikim të prodhimeve bujqësore. Sa i përket Masës 8 synohet vazhdimi i përkrahjes së projekteve rurale të Grupet Lokale të Veprimt (GLV). Ndërkaq përmes masës 5, në sektorin e pylltarisë do të vazhdohet me implementimin e

Strategjisë për Pylltari, duke pyllëzuar sipërfaqet e zhveshura, aplikimin e masave silvikulturore ne pyje, inventarizimin e pyjeve dhe planeve menaxhuese për pyje (10 vjeçare).

Në sektorin e sigurisë ushqimore, AUVK do të përafroj legjislacionin sekondar në fushën e sigurisë së ushqimit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve duke miratuar rregulloret që dalin nga Pako Higjienike. Qeveria e Kosovës do të bëj transferimin e inspektorëve nga komunat për në AUV për të adresuar përforcimin e kontrollit të tregjeve të kafshëve, parandalimin e tregtisë ilegale dhe therjet e paligjshme të kafshëve si dhe përmirësimin e kontrolleve fito-sanitare. Kjo të përmisoj kontrollat fito-sanitare jo vetëm në kufi, por edhe brenda gjithë territorit të Kosovës. AUVK do vazhdoj me ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative, me qëllim të adresimit të sfidave me të cilat përballet siguria e ushqimit.

3.7.4. Doganat, Tatimet dhe kontrolli financiar

3.7.4.1. Doganat

Dogana e Kosovës karakterizohen me një legjislacion të avancuar dhe gjerësisht është në përputhje me kodin doganor të BE-së. Ndër ligjet bazë që aplikohen nga Doganat e Kosovës janë: Ligji për Kodin Doganor dhe të Akcizave, Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, Ligji për akciza në Produktet e Duhanit, dhe Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Së fundi Dogana e Kosovës ka miratuar ndryshimet në udhëzimin administrativ për procedurat disiplinore për t'u përballur me pohimet për sjelljen joprofesionale të personelit doganor. Dogana karakterizohet si dhe me Kornizën e Strategjisë Operative 2012-2014 (KSO). Korniza e Strategjisë Operative 2012-2014 (KSO) tregon se çka ofron Dogana e Kosovës kundrejt investimeve të parave publike nga buxheti i Kosovës, KSO gjithashtu përcakton qëllimet dhe objektivat që realizohen nëpërmjet njësive operative, respektivisht Drejtorive të cilat e përbëjnë Doganën e Kosovës.

Dogana e Kosovës është përgjegjëse për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra. Gjithashtu, Dogana e Kosovës është përgjegjëse që të grumbullohen detyrimet doganore; përveq kësaj Dogana është institucion kyç për vjeljen e TVSH-së dhe Taksave mbi Akcizën të cilat vjeljen nëpër kufij. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosovës është përgjegjëse edhe për mbrojtjen e shoqërisë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të kimit ekonomik, si dhe evazionit në të hyra.

Kosova ka ndërmarre një numër të operacioneve kundër kontrabandës dhe kimit të organizuar në kuadër të Doganave. Në mënyrë që të rritë bashkëpunimin ndërkombëtar doganor Kosova ka nënshkruar nëntë marrëveshje dypalëshe dhe marrëveshjet tjera janë në negociim e sipër. Shërbimi Doganor ka bere përpjekje te rëndësishme për modernizim, një përparim i vazhdueshëm është i dukshëm ne fushën e kapaciteteve administrative dhe operative. Është e rëndësishme se që në fillim të majit Shtator 2012 sistemi për përpunimin e deklaratave doganore (ASYCUDA) e cila lehtëson zhdoganimin pa letra, është bërë operativ. Gjithashtu çertifikatat e prejardhjes për mallrat që eksportohen janë të vërtetuara nga dogana për mallrat që kanë prejardhje si nga veriu ashtu edhe nga pjesa tjetër e Kosovës.

Edhe përkundër arritjeve të mëdha në Doganë, ende mbetin disa sfida që ndërlidhen me përmirësimin për situatën në veri në aspektin e qasjes në territorin e veriut për respektimin e rregullave të origjinës për mallrat në këtë territor. Ndër të tjera, sfiduese mbetet reformimi i

mëtejshëm dhe modernizimi i Doganës së Kosovës duke përfshirë përmirsimin e objekteve të disa pikave të kalimit kufitar (PKK). Ekziston gjithashtu një nevojë për të ndërmarrë trajnime të mëtejshme të stafit në ngritjen e kapaciteteve në lehtësimin e tregtisë, doganave, bashkëpunimit doganor vlerësimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova duhet të sigurohet që autoriteti i saj doganore të rrisë edhe më tej efektivitetin për të përmbushur kërkesat që rrjedhin nga tregtia e liberalizuar, tregtia e privilegjuar nën MSA-në, në veçanti në lidhje me certifikimin e duhur të origjinës dhe metodave të hetimit dhe zbatimit. Formalitetet doganore nuk do të duhej të ishin pengesë për tregtinë.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, për të luftuar ekonomin joformale Doganat do të ngritin bashkëpunimin me agjencionet tjera të zbatimit të ligjit si dhe do të shtojn angazhimet anti-kontrabande veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, të rritin kontrollat për vërtetimin e mallrave dhe vërtetimin e çertifikatave të origjinës nga territori i veriut. Gjithashtu, do të bëhet përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja në PKK (Kullë, Vermice, Hani i Elezit, Kuqishtë). Dogana do të mbaj trajnime brenda dhe jashtë vendit bazuar në bashkëpunim me Agjencionet tjera relevante për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimit profesional të stafit.

3.7.4.2. Tatimet

Kosova karakterizohet me legjislacion të avancuar dhe kryesisht të kompletuar sa i përket tatimeve. Ligjet kryesore për tatime janë: *Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat ku mund të krijohen procedura të reja ankimore kundër vendimeve të organeve tatimore*, *Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale*, *Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave*, *Ligji për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar*, dhe *Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës*. Është miratuar një udhëzim administrativ, duke qartësuar kompetencat e njësive si njësia për hetime tatimore, si dhe njësia që merret me ankesa. Administrata Tatimore ka filluar të zbatojë strategjinë e vitit 2010 për përmbushje të obligimeve tatimore, si dhe planin e menaxhimit strategjik 2010-15. Strategjia ka krijuar procedura më të shkurtra për t'u marrë me tatimpaguesit që nuk raportojnë, kërkesat për rimbursim dhe ankesat.

Administrata Tatimore e Kosovës është autoriteti ekzekutiv për taksat, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit lidhur me taksat. ATK përbeht nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Auditorit të Brendshëm dhe Menaxherit të lartë (zyra ekzekutive). Njësia e Hetimeve Tatimore brenda Administratës Tatimore është krijuar që të merret me evazionin fiskal. Numri i deklarimeve tatimore elektronike është rritur ndjeshëm, gjithashtu, përparim i lavdërueshëm është bere duke themeluar zyrat e përbashkëta për regjistrimin e bizneseve dhe automjeteve.

Edhe përkundër arritjeve të mëdha në Administratën Tatimore ende mbetin sfida që ndërlidhen me zhvillimin e ATK-së, prandaj Kosova duhet të përgatisë legjislacionin për integrimin e vendimeve të apelit në sistemin e gjykatave të rregullta duke krijuar një ndarje fiskale në gjykatën administrative për Bordin e Pavarur për Ankesa dhe Rishqyrtime të Bizneseve dhe Tatimpaguesve, të rritet efektiviteti i këtij Bordi dhe kapaciteti i Bordit të forcohet. Njëkohësisht ATK duhet të jetë në gjendje për të përshtatur politikat dhe për të identifikuar mjete për të përmirësuar efektivitetin e mbledhjes së taksave dhe të rritë bashkëpunimin mes Administratës Tatimore, Policisë dhe Gjykatave. Me qëllim të rritjes së efikasitetit IT sistemi (SIGTAS) duhet të

zëvendësohet nga një infrastrukturë moderne si dhe struktura tatimore duhet të jetë më shumë në përputhje me BE-në.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Bashkëpunimi me BE-në në kuadër të MSA-së do të lehtësojë reformimin e sistemeve fiskale në Kosovë dhe do të nxiste zhvillimin e mëtejshëm të administratës tatimore që të sigurojë mbledhje efektive të taksave dhe të luftojë evazionin fiskal. Bashkëpunimi do të kishte si qëllim shmangien e konkurrencës së dëmshme tatimore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociativ, për të forcuar Bordin e Pavarur për Rishqyrtime dhe Ankesa nga Bizneset dhe Tatimpaguesit do të aprovohet udhëzimi administrativ për pagesën e anëtareve të bordit si dhe do të kompletohet Bordi i Pavarur me anetarë nga Kuvendi i Kosovës duke iu ofruar përkrahje administrative për bordin edhe nga ATK gjë që do të rezultojë në zvogëlimin e numrit të rasteve që presin zgjidhje. Për të rritur bashkëpunimin me institucionet tjera do të mbahen takime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe Gjykatën si dhe do të nënshkruhen marrëveshje të bashkëpunimit me Policinë dhe Gjykatën. Për të luftuar evazionin fiskal do të organizojnë fushatat mediale për informim dhe tatimpaguesve lidhur me obligimet tatimore, vizita dhe kontrolle me qëllim parandalimit dhe dështimit të përmbushjes së obligimeve tatimore si dhe vizita vëzhguese të rastit. Ngritja e pjesëmarrjes së të hyrave nga tatimet direkte në raport me të hyrat indirekte pritet të jenë prej 11% në vitin 2012 në rreth 14% në vitin 2013. ATK ka për qëllim që sistemi i shërbimeve online të jetë funksional si dhe sistemi të jetë i ndërlidhur me sistemet informative të institucioneve tjera qeveritare përmes arkave fiskale. ATK gjithashtu ka nevojë për Asistencë teknike të donatorëve për të siguruar furnizimin me një sistem informativ bazë dhe asistencë teknike dhe financiare në ndërtimin/zhvillimin e mëtutjeshëm dhe integrimin me nën-sistemet ekzistuese informative në ATK.

3.7.4.3. Kontrolli Financiar

Në Kosovë, ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legislative që rregullon Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, ku ligjet baze në këtë fushë janë: Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji Vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Ligjet tjera që rregullojnë dhe përcaktojnë shpenzimin dhe inkasimin e parasë publike, Rregulla Financiare e Thesarit 01- për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Rregulla Financiare e Thesarit 02- Shpenzimi i parasë publike dhe Rregulla Financiare e Thesarit 03- Të hyrat. Po ashtu është i miratuar edhe Dokumenti i Politikave të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike i cili është rishikuar në prill 2011. Krahas këtij dokumenti janë përgatitur Doracakut i Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dhe janë aprovuar disa procedura të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit që kanë të bëjnë me delegimin e shpenzimeve, menaxhimin e rrezikut, pasurive, buxhetit, shpenzimet, dhe pagesat.

Sa i përket auditimit të brendshëm (AB), është krijuar një bazë solide ligjore për funksionimin e sistemit të AB ku përfshihen Ligji për Auditim të Brendshëm dhe legjislacioni sekondar për funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm dhe komitetëve të auditimit dhe për licencimin e auditorëve të brendshëm. Gjithashtu janë rifreskuar dhe harmonizuar standardet dhe doracakut i auditimit të brendshëm në harmoni me praktikën më të mira profesionale të BE-së. Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm është duke e përfunduar një Udhëzim Administrativ për licencimin e auditorëve të certifikuar.

Gjithashtu ekziston Strategjia për Funkionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Kosovë 2008-2012 që është hartuar në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë. Legjislacioni për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është i avancuar. Ligjet kryesore për punën e ZAP-it janë: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Ligji për Prokurimin Publik. ZAP-i e ka përditësuar Strategjinë e saj për Zhvillim të Përbashkët ku objektivi i kësaj Strategjie është që të caktohet rruga dhe udhëzuesi në krijimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë deri në fund të vitit 2013.

Nga aspekti institucional, koncepti i Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP-PIFC) është zhvilluar nga Komisioni Evropian për të ndihmuar në përmirësimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Sipas ligjeve në fuqi, KBFP në Kosovë përbëhet prej dy shtyllave kryesore: Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK) dhe Auditimi i Brendshëm (AB). Këto mbështeten, zhvillohen dhe mirëmbahen nga dy organe:

- a) Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhim Financiar dhe Kontroll (NjQHMFK) - e vendosur në kuadër të Thesarit dhe i përgjigjët Ministrit të Financave përmes Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- b) Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQHAB) - për fushëveprimin e saj i përgjigjët drejtpërdrejtë Ministrit të Financave.

NjQHMFK koordinon zbatimin e zhvillimit të mëtutjeshëm të parimeve të MFK-së në të gjitha Organizatat Buxhetore (OB); harton politika (Udhëzues Referues dhe Doracak të Procedurave); promovon MFK-në përmes ueb faqes dhe rrjetit të shkëmbimeve për përdoruesit e MFK-së; përmirëson cilësinë e praktikuesve të MFK-së përmes programit të trajnimit për Zyrtarëve Kryesor Administrativ (Zyrtarëve llogaridhënës) dhe Menaxherët (Mbajtësit e buxhetit); monitoron zbatimin e MFK-së përmes listave kontrolluese të vet-vlerësimit të praktikave të mira të MFK-së për udhëheqësit e organizatave buxhetore; dhe raporton në baza të rregullta te Ministri për zbatimin e MFK-së. Jane te themeluara 67 njësi te auditimit te brendshëm dhe janë certifikuar 32 auditorë te brendshëm dhe 12 trajnerë vendor per vazhdimin e trajnimit ne programin për Trajnim dhe Çertifikim.

Ndërsa Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është institucion i pavarur kushtetues që i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës detyra e se cilës është të kontribuojë për menaxhim të mirë financiar në institucionet publike.

Pavarësisht shume zhvillimeve pozitive në fushën e kontrollit financiar, ende ekzistojnë sfida në këtë sektor përfshirë nevojën për përmirësim te praktikave te kontrollit të brendshëm të vazhdueshëm ditore, dhe krijimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme për menaxhim të rrezikut. Sfide tjetër tejet me rëndësi është që institucionet duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë pavarësisht se funksionimit të auditimit të brendshëm në nivel qendror e veçanërisht në atë lokal. Ne nivelin lokal, mbetet sfide krijimi i njësive te auditimit ne disa komuna. Ekziston gjithashtu një nevojë për një mirëkuptim më të madh dhe marrje e përgjegjesisë brenda organizatave buxhetore për të krijuar një kulturë të delegimit të përgjegjësive dhe autoriteteve. Në anën tjetër ZAP-i ka nevojë për të forcuar kapacitetin e tij për të ofruar auditime të performancës. Për më tepër, ZAP-i është pjesë e shërbimit civil, zbatimi i legjislacionit të ligjit të shërbimit civil është shumë urdhërues dhe kufizon në praktikë pavarësisht funksionale të ZAP.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Bashkëpunimi me BE-në në kuadër të MSA-së duhet të përqendrohet në kontrollin e brendshëm financiar dhe publik dhe auditimin e jashtëm. Caku i bashkëpunimit do të jetë ngritja dhe zbatimi i kontrollit dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe forcimi i rolit të auditimit të jashtëm në përputhje me kornizat dhe standardet ndërkombëtare.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, do të adaptohet dhe implementohet një ligj i ri që do të sigurojë pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) si dhe do të miratohet legjislacioni dytësor. Që të sigurohet qëndrueshmëria institucionale e ZAP-it, planifikohet të miratohet Strategjia e Zhvillimit të Përbashkët për periudhën Shtator 2013 - Shtator 2015. Kualiteti dhe kapaciteti njerëzor i ZAP-it do të rritet përmes skemës së re të certifikimit kompatibil me ISSAI për Auditorët e Rregullsisë të sektorit publik në funksion si dhe skema e certifikimit për Auditorët e Performancës. Pasi që qeverisja e mire ka një rol tejet të rëndësishëm, ZAP do të obligoj Auditorët të Rregullsisë për të gjithë shpenzuesit buxhetor (përfshirë të gjitha komunat), dhe do të rrisë numrin e Auditimeve të Performancës, të fondeve të donatorëve dhe projekteve të ndryshme. Në anën tjetër që të zhvillohet praktika e kontrollit të brendshëm të bazuar në rrezik do të mbahen trajnime profesionale në harmoni me praktikat ndërkombëtare. Në zhvillimin e Auditimit të brendshëm dhe Menaxhmentit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në sektorin publik në harmoni me standardet dhe praktikat ndërkombëtare do të kontribuojë edhe certifikimi i auditorëve në Programin për Trajnim dhe Certifikim Ndërkombëtar, trajnimet dhe seminarët e mbajtura me pjesëmarrësit sipas moduleve të projektit të IPA 2011, si dhe do të avancohet skema profesionale e trajnimit në nivel të diplomës.

3.7.5. Punësimi, politika sociale, politika e shëndetit publik, arsimit dhe trajnimit dhe hulumtimi i teknologjisë dhe zhvillimi

3.7.5.1. Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik

Në fushën e punësimit dhe Politikave Sociale, Kosova ka krijuar kornizë ligjore bazë nëpërmjet së cilës rregullohen çështjet e punës dhe punësimit, mbrojtje e shëndetit dhe sigurisë në punë, inspektoratin e punës, organizatat sindikale, dialogun social, përfshirjen dhe mbrojtjen sociale. Gjithashtu, legjislacioni kryesor në fuqi rregullon çështjet e pensioneve, shërbimeve sociale dhe familjare të kujdesit, si dhe skemave për personat me nevoja të veçanta dhe të moshuarit.

Ligji i Punës është bazë për rregullimin e marrëdhënies së punës dhe punësimit. Miratimi i Ligjit të Punës ka rregulluar çështjet e punësimit deri në një masë, mirëpo, kostoja e lartë e tij paraqitet si sfide e mëtutjeshme. Ligji i rishikuar për Skemën e Ndihmës Sociale dhe Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare janë miratuar. Ligji i ri për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është draftuar, pritet të miratohet nga Qeveria. Kosova ka një strategji kombëtare të punësimit dhe strategjinë sektoriale. MPMS është duke zbatuar Strategjinë e Punësimit 2010-2012, poashtu zbaton planin e veprimit 2011-13, i cili fuqizon dhe mbështet Strategjinë sektoriale 2009-2013. Ligji për Këshillin ekonomik-social është miratuar dhe ka përmirësuar procesin e dialogut social që është konsideruar si sfidë. Decentralizimi i shërbimeve sociale është duke u përmirësuar, por ky proces kërkon mbështetje të mëtutjeshme financiare sidomos në ngritjen profesionale të burimeve njerëzore bartëse të këtij procesi.

Institucionet bartëse të procesit në nivel qendror dhe lokal janë në vend të funksionale. Për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punësimin, përgjegjësitë kryesore i ka MPMS-ja, e cila

zhvillon aktivitetin e sajë përmes shtatë Zyrave Rajonale të Punësimit dhe njëzetetë zyra Komonale. Ndërsa për çështjet e aftësimit profesional MPMS vepron përmes tetë Qendrave të Aftësimit Profesional. Për politikat sociale përgjegjësia drejtëpërdrejt bie nën MPMS-në, respektivisht Departamentin për Mirëqenie Sociale dhe Administratën Pensionale. Për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të punës, për rregullimin e marrëdhënies së punës dhe punësimit përgjegjësit kryesor janë, Inspektorati i Punës që është përgjegjës i drejtëpërdrejt ndaj MPMS-së. Pas miratimit të Ligjit për Këshillin Ekonomik dhe Social (KES), Këshilli Ekonomik Social është funksionalizuar. Ky këshill është krijuar me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishme të veçantë, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale, të cilat realizohen përmes zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe apo trepalëshe. Ky këshill ka përbërje ndër-institucionale duke përfshirë edhe sindikatat, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve, OEK-ut dhe AKB-se.

Për implementimin e decentralizimit të shërbimeve sociale, përgjegjëse janë MPMS, MAPL dhe institucionet e nivelit komunal.

Në përgjithësi, si sfida kryesore në sektorin e punësimit mbetet reformimi i politikave aktive të punësimit, papunësisë, sidomos të papunësisë afat-gjatë që akoma mbetet një nga problemet kryesore, gjithashtu, sfidë mbetet sigurimi i cilësisë së aftësimit që iu përgjigjet nevojave të tregut të punës.

Për më tepër sektori i punësimit ballafaqohet akoma me sfida, si në aspektin e krijimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore dhe institucionale, ashtu edhe kapaciteteve humane. Përkundër progresit të bërë deri më tani në rregullimin e punësimit dhe mbrojtjes së punëtorëve në vendin e punës, mbetet ende mjaft për tu bërë në këtë drejtim. Ligji i ri për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë pritet të miratohet nga qeveria Mungesa e kapaciteteve të inspektoratit të punës dhe institucioneve të tjera që lidhen me zbatimin e ligjit duhet të adresohet Mekanizmat e raportimit dhe kontrollit të zbatimit të ligjeve për mbrojtje në punë duhet të forcohen dhe duhet të tregohet përkrahje politike për to.

Kapacitetet njerëzore duhet të rriten, sidomos në kuadër të Inspektoratit të Punës, i cili është përgjegjës kryesor për të zbatuar Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit në Punë, por edhe ligjet e tjera në kompetencë të tij. Për sa i përket Ligjit të Punës, si ligji bazë që rregullon marrëdhënien e punës dhe punësimit, janë paraqitur pengesa të theksuara në implementimin e tij dhe këto do të duhet të adresohen përmes rishikimit të tij. Aspektet që duhet të adresohen gjatë rishikimit të ligjit janë: kostoja ,pushimin i lehonisë si dhe përkrahja e Inspektoratit të Punës. Çështje tjetër që duhet adresuar është edhe luftimi i informalitetit të tregut të punës, i cili vazhdon të jetë akoma në një përqindje mjaft të lartë.

Ende mungon një strategji e veçantë për sigurinë dhe shëndetin në punë, por një strategji e tillë vlerësohet të jetë mjaft e nevojshme dhe duhet të ndërmerren masa për rregullimin e kësaj çështje. Sido që të jetë, MPMS-ja duhet që të krijoj një bazë të të dhënave mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.

Në kuadër të decentralizimit të shërbimeve sociale, si pengesë kryesore paraqitene kapacitetet e ulta njerëzore profesionale, të cilët do të bartnin përgjegjësitë që u janë garantuar nga niveli qendror dhe definimi i një formule të financimit për shërbime sociale.

Për të adresuar sfidat e këtij procesi, MPMS ka hartuar Strategjinë e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale 2013-2017, e cila pritet të aprovohet nga Qeveria.

Për të adresuar përmirësimin dhe reformimin e Politikave të Punësimit si dhe të Politikave Sociale, MPMS do të bëjë rishikimin e Strategjisë së Punësimit dhe Strategjisë Sektoriale dhe t'i unifikoj ato në një dokument të vetëm. Do të vazhdohet me reformimin dhe modernizimin e Shërbimeve Publike të Punësimit, avancimit të bazës së të dhënave, zgjerimit të programeve aktive të tregut të punës, rrumbullakimit të infrastrukturës ligjore nga fusha e punësimit, si dhe nxitjen e zhvillimit të bashkëpunimit brenda dhe jashtë Kosovës, me qëllim të rritjes së shkallës së punësimit.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Kosova duhet të bëjë më shumë në nxitjen e dialogut social... Bashkëpunimi në këtë fushë sipas MSA-së do të synojë mbështetjen e Kosovës në reformimin e politikave të punësimit. Ajo gjithashtu do të nxisë dialogun social si një forcë kyçe në shtytjen e reformës ekonomike dhe sociale si dhe përafrimin ligjor mbi ligjin e Punës dhe shëndetit e sigurisë në punë. Sipas MSA-së, synim do të jetë bashkëpunimi për përshtatjen e sistemit të Kosovës për sigurim social ndaj situatës së zhvillimit ekonomik dhe kërkesave të reja sociale. Kosova gjithashtu do të inkurajohet që të miratojë politikat për përfshirjen e plotë sociale si dhe ato kundër diskriminimit bashkë me masat për përmirësimin e gjendjes së grupeve më të rrezikuara sociale.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi, institucionet Kosovës do të miratojnë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Punë, Ligjin e ri për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe aprovimin e Ligji i ri për Dhënien e Lejes së Punës dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.

Do të adresohen sfidat kryesore për sa i përket fushës së rregullimit të marrëdhënieve të punës përmes një legjislacioni të harmonizuar me atë të Bashkimit Evropian që ka të bëjë me ndryshimet e nevojshme ligjore dhe rritjes së efikasitetit të zbatimit. Kjo të bëhet përmes fuqizimit të inspektoratit të punës për zbatimin e ligjit si për nga shtimi i numrit të personelit ashtu edhe nga zhvillimi profesional i tyre. Në këtë aspekt masat do të ndërmerren për luftimi i informalitetit në tregun e punës, përmirësimi i statistikave të punësimit dhe sistemit elektronik të menaxhimit të tyre. Monitorimi i zbatimit të ligjeve në praktikë dhe përsheptimi i procedurave në Gjykatë ekonomike e cila është përgjegjëse për rastet e shkeljeve të ligjit të punës.

Në kuadër të dialogut social, qeveria do të përkujdeset për ngritjen e nivelit të funksionimit të Këshillit Ekonomik Social (KES) në ngritjen e dialogut në mes të sindikatave, qeverisë dhe partnerëve social.

Spektori i shëndetit publik është një ndër sektorët me rëndësi të madhe sepse është i lidhur direkt me mirëqenien e njeriut dhe shëndetin. Ky sektor aktualisht paraqet prioritet të aktiviteteve reformuese të Qeverisë së Kosovës veçanërisht duke pasur parasysh faktin se sistemi i tanishëm

shëndetësor reflekton realitetin e rrethanave emergjente në shëndetësinë Kosovare të viteve të para të pasluftës. Nevojat shëndetësore të popullatës dhe mundësitë e kufizuara buxhetore për financim adekuat të shërbimeve shëndetësore e bëjnë këtë reformë edhe më të rëndësishme. Aktivitetet aktuale reformuese janë të mbështetura në kornizën e qartë ligjore që është në pajtim të plotë me Strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2010 – 2014 dhe Acquis Communautaire dhe e cila është e dakorduar në tërësi me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Kjo kornizë ligjore e projekton reformën e sistemit shëndetësor të vendit në dy faza: Ligji i ri i shëndetësisë që është miratuar në Kuvendin e Kosovës e projekton fazën e parë të reformës strukturore dhe organizative të sistemit shëndetësor që synon autonominë, efikasitetin dhe efektivitetin më të lartë të institucioneve publike shëndetësore dhe barazinë e plotë të sektorit publik dhe privat në shëndetësi; ndërkaq Projektligji i Sigurimeve shëndetësore, i cili është në procedurat e miratimit, i cili gjithashtu projekton reformën e sistemit të financimit të sektorit të shëndetësisë dhe synon rritjen e fondeve të nevojshme financiare si dhe qëndrueshmërinë fiskale. Ligjet e tjera të cilat do të mbështesin këtë reformë janë: Ligji për Odat e profesionistëve shëndetësor, Ligji për kontrollin e duhanit; Ligji për transplantimin e organeve; Ligji për transplantimin e indeve dhe qelizave; dhe Ligji për produkte medicinale dhe pajisje mjekësore të cilët janë të përfunduar dhe para miratimit.

Autoriteti më i lartë shëndetësor në vend është Ministria e Shëndetësisë që është bartëse e politikave dhe strategjive sektoriale, ndërkaq sistemi i shërbimeve shëndetësore, që ofrohen në kuadër të sektorit publik dhe atij privat, është i organizuar në tri nivele: parësor të mbështetur në konceptin e avancimit të shëndetësisë publike dhe në konceptin e mjekësisë familjare; si dhe dytësor dhe tretësor të mbështetur në konceptin e kujdesit të integruar shëndetësor.

Ka edhe shumë punë për tu bërë në sektorin e shëndetit publik sa i përket obligimeve të dala nga Studimi i Fizibilitetit me qëllim të përmbushjes së këtyre obligimeve drejt MSA-s. Megjithëse vërehet përparim në lidhje me implementimin e kornizës ligjore, edhe më tutje, ky segment kërkon përkushtim dhe si i tillë vazhdon të mbetet ende sfidë. Në këtë drejtim nevojitet zhvillim i mëtejshëm i politikave shëndetësore si dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe atyre infrastrukturore. Sfidë tjetër mbetet miratimi apo amandamentimi i kornizës ligjore si: Ligjit për Duhanin, Ligjit për gjakun dhe indet dhe qelizat, Ligjit për dhurimin dhe transplantimin e organeve si dhe Ligjit për sëmundjet ngjitëse, Projekt-ligjit për Odat e profesionistëve pasi këto ligje e përmbushin dhe e plotësojnë kornizën ligjore në sektorin e shëndetit publik.

Si sfidë tjetër konsiderohet edhe Sistemi i informimit Shëndetësor (SHISH) duke pasur parasysh që funksionalizimi i tij duhet të bëhet në të gjitha institucionet shëndetësore në Kosovë. Ndërkaq, statistikave të informacioneve shëndetësore duhet të përmirësohen.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Për t'i përmbushur obligimet e veta sipas një MSA-je, Kosova duhet të bëjë më shumë për ta nxitur dialogun social, t'i zhvilloj më tej politikave të mbrojtjes shëndetësore, në pajtim me ligjet e BE-së për ta përmirësuar shëndetin dhe për ta parandaluar sëmundjet e popullsisë së saj, t'i zhvilloj strukturat administrative të pavarura dhe efektive me kompetenca të zbatimit për të siguruar kërkesat thelbësore shëndetësore dhe të sigurisë dhe për të mbrojtur të drejtat e pacientëve, dhe për t'i mbrojtur qytetarët nga

kërcënimet e shëndetit dhe sëmundjet, të promovojë jetesën e shëndetshme dhe të bashkëpunojë me BE-në në lidhje me çështjet shëndetësore.

Për përmirësimin e gjendjes së shëndetit publik në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë duhet të kompletoj legjislacionin primar dhe atë sekondar me të gjitha aktet nënligjore përkatëse me qëllim të adresimit të sfidave të dalura nga Studimi i Fizibilitetit.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të dalura nga *Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*, korniza legislative duhet të amendamentohet dhe miratohet duke përmirësuar ligjet e lartpërmendura, si: Ligjin për Sigurime shëndetësore, Ligjin për Duhanin, Ligjin për transplantimin e Organeve dhe Indeve, Ligjin për sëmundjet ngjitëse si dhe Ligjin për Odat e profesionistëve. Krahas kësaj, do të bëhet edhe funksionalizimi i Sistemit të Informimit shëndetësor i cili ka një rëndësi shumë të madhe në aspektin e grumbullimit e të dhënave të sëmundjeve malinje si dhe sëmundjeve të rralla. Gjithashtu rol të madh në implementimin e këtij sistemi ka edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).

Nevojitet gjithashtu të forcohet monitorimi, implementimi, raportimi si dhe inspektimi i dokumenteve relevante duke pasur parasysh që vërehet një mungesë koordinimi ndërmjet institucioneve shëndetësore përgjegjëse për funksionimin e këtij sektori sa i përket këtyre çështjeve.

3.7.5.2. Arsimi, trajnimi, hulumtimi dhe inovacioni

Sektori i arsimit karakterizohet me një strukturë mjaft të kompletuar ligjore për të gjitha nivelet e arsimit, si atë parauniversitar, profesional e të lartë. Ligji për Arsimin Para-Universitar është rishikuar dhe miratuar në vitin 2011 i cili është harmonizuar me Ligjin për Arsimin në Komuna. Korniza ligjore në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional përfshinë Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional i miratuar në vitin 2006, ndërsa i rishikuar në vitin 2012 me qëllim të eliminimit të zbrazëtirave në arsimin dhe aftësimin profesional. Po ashtu janë rishikuar Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Ligji për Arsimimin e të Rriturve. Arsimi i Lartë në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë, i miratuar në vitin 2002 dhe i rishikuar dhe miratuar në vitin 2011 me qëllim të harmonizimit me reformat aktuale në sektorin e arsimit.

Arsimi është një nga sektorët e paktë të cilët kanë hartuar kornizën strategjike gjithëpërfshirëse të sektorit të arsimit e cila mbulon të gjithë nën sektorët e arsimit (PSAK 2011-2016). PSAK vendos kornizën e politikave drejt përmbushjes së standardeve të BE-së.

Korniza institucionale në sektorin e arsimit është mjaft e avancuar, ku përpos MASHT si bartëse kryesore për implementimin e politikave arsimore, janë edhe Universitetet Publike (Prishtinë, Prirë dhe Pejë), Instituti Albanologjik dhe ai i Historisë, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia për Akreditim, Biblioteka Kombëtare Universitare etj. MASHT po ashtu ka krijuar Task Forcën për analizimin financiar, definimin, propozimin dhe balancimin e burimeve të mundshme financiare për implementimin e strategjisë. Po ashtu, se shpejti pritet të themelohet Komiteti Drejtues i PSAK-ut, që do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të tij.

Edhe përkundër arritjeve të mëdha në sektorin e arsimit, ende mbetin sfida të cilat vështirësojnë implementimin më efektiv të PSAK-ut dhe reformave të tjera të iniciuara nga MASHT.

Përkundër miratimit të legjislacionit primat, ende duhet të draftohen aktet nënligjore të ligjeve që janë rishikuar dhe presin miratimin në fund të këtij viti dhe të cilat do ta kompletin infrastrukturën ligjore në këtë sektor. Përmirësimi i kushteve adekuate për arsimin e minoriteteve, përfshirë qasjen në arsim në gjuhën e tyre mbetet ende për t'u avancuar. Sa i përket kapaciteteve njerëzore sfidë mbetet themelimi i një fondi për përkrahjen e hulumtueseve dhe kapaciteteve hulumtuese të institucioneve dhe mungesa e personelit me kualifikime të larta shkencore dhe numri i ultë i studentëve në doktoratë.

Në Kosovë ende nuk ka pajisje të mjaftueshme laboratorike të përcjellura me njohuri praktike teknike joadekuate. Integrimi i Kosovës në Zonën Evropiane të Hulumtimit mbetet synim afatgjatë i Qeverisë së Kosovës. Investimet në sektorin e arsimit dhe hulumtimit mbeten ende në nivel të ultë. Në Kosovë komuniteti shkencor mbetet mjaft i izoluar përballë komunitetit shkencor ndërkombëtar.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së

Sektori i arsimit luan rol kyç për një zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Kjo pasqyrohet edhe në obligimet që ka Kosova për të përmbushur kriteret në kuadër të MSA. Kosova duhet të rris dhe forcoj investimet në fushën e arsimit dhe hulumtimit. Një ndër sfidat kryesore për këtë sektorë vazhdon të jetë mungesa e stafit të kualifikuar, numri i ultë i studenteve në studime doktorate me një komunitet shkencor relativisht të izoluar në raport me komunitetin shkencor ndërkombëtar.

Qeveria e Kosovës do të adresoj këto sfida përmes veprimeve të caktuara që kanë për qëllim avancimin akademik të shoqërisë Kosovare. Aprovimi i Ligjit për Veprimtari Kërkimore-shkencore, Inovacion dhe Teknologji mundëson rritjen e përkrahjes financiare për hulumtimet shkencore, shtimin e studimeve të doktoratës dhe post-doktoratës, si dhe ngritjen e kapaciteteve të universiteteve për hartim dhe akreditim të programeve aktuale dhe të reja të doktoratës. Do të hartohet Strategjia Kombëtare për Inovacion, për të cilin qëllim tashmë janë formuar grupet punuese.

Përmes themelimit të sistemit të pikës kombëtare të kontaktit Kosova do të ndërmarrë hapa konkret për t'u integruar në Zonën Evropiane të Hulumtimit.

Fusha tjera me prioritet mbasin edhe trajnimi dhe aftësimi profesional i mësimdhënësve, arsimit dhe aftësimi profesional si dhe përmirësimi i kushteve për arsimin e minoriteteve.

Qeveria synon që në vazhdimësi të rrisë kapacitetet në fushat e efciences së energjisë, ambientit, sigurimit të ushqimit, shëndetësi dhe shkenca sociale, të cilat janë identifikuar si sektorë me prioritet.

3.7.6. Shërbimet kulturore, audio vizuale, të telekomunikacionit, postare dhe shoqëria informative

Sa i përket zhvillimeve nga fusha e legjislacionit, sektori i telekomunikacionit dhe politikave audiovizuale ka shënuar një progres substancial me miratimin e një numri të konsiderueshme të ligjeve si: *ligji për komunikimet elektronike, ligji për shërbimet e shoqërisë informative, ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, ligji mbi shërbimet postare, ligji për RTK dhe ligji për Komisionin e Pavarur për Media (KPM)*. Për më tepër, këto zhvillime janë përcjell edhe me një

ritëm pozitiv sa i përket miratimit të akteve nënligjore.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e shoqërisë informative dhe medieve, një varg dokumentesh strategjike janë në implementim e sipër. Në këtë aspekt, në sferën e telekomunikacionit janë duke u implementuar Politikat e Sektorit të Telekomunikacionit, dokument që përcakton vizionin, prioritetet dhe objektivat për rregullimin e fushave të ndryshme të jetës sociale dhe zgjerimit të mundësive për paraqitjen e alternativave inovative. Ndërkaq, në kontekst të zhvillimeve pozitive të shoqërisë së informacionit është miratuar Strategjia Nacionale për Shoqëri të Informacionit e cila është produkt i një partneriteti multisektorial dhe ka si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor duke u mbështetur në drejtësi sociale, barazi të mundësive, liri, respektimin e dallimeve kulturore, pjesëmarrje civile dhe përparim shkencor përmes shfrytëzimit të teknologjisë informative dhe komunikuese. Për më tepër, në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar dokumentin e "SEE Agenda+ për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në EJL 2007-2012" ku shpreh vendosmërinë e plotë në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave nga ky dokument, si një hap pozitiv drejt përpjekjeve të përbashkëta për ndërtimin dhe avancimin e Shoqërisë së Informacionit në vendet e EJL. Sa i përket avancimit të ofrimit të shërbimeve elektronike për qytetarët është duke u zbatuar Strategjia e Qeverisjes Elektronike e cila ka si objektiv strategjik ofrimin e shërbimeve të institucioneve qeveritare përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (si WAN, Internet, rrjetit mobil) ndaj qytetarëve, bizneseve dhe kategorive të tjera.

Në kontekst të organizmit të përgjegjësive institucionale në nivel sektorial janë themeluar dhe funksionalizuar institucionet kyçe për hartimin e ligjeve, dokumenteve strategjike dhe implementimin e politikave. Institucione kyçe për politikat audio vizuale dhe të telekomunikacionit janë MZHE dhe MAP, si struktura përgjegjëse për përgatitjen e legjislacionit dhe strategjive sektoriale për fushat e komunikimit elektronik, shoqërisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike. Ndërkaq, për zbatimin dhe monitorimin e dokumenteve të lartpërmendura kujdesen Autoriteti Rregullativ Komunikimeve Elektronike (ARKEP) - ish: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike e Postare (ARKEP) dhe KPM. Për më tepër, ARKEP është institucion përgjegjës për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe atyre postare dhe zbaton politikat dhe strategjitë e sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare të përcaktuara nga Qeveria. Gjithashtu, ARKEP është përgjegjës për menaxhimin me spektrin frekuencor. Në anën tjetër, KPM është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin, mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave për transmetimet radio-difuzive, duke rregulluar të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Megjithatë, përkundër progresit substancial në sektorin e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audiovizuale, një varg sfidash komplekse me të cilat ballafaqohen institucionet përgjegjëse e vështirësojnë implementimin efektiv të standardeve të BE-së, përfshirë kompletimin e kornizës legjislative si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për monitorim dhe implementim të reformave. Në këtë drejtim, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të përafuar dhe harmonizuar kornizën ligjore dhe strategjike me BE-në. Në këtë kuadër angazhimesh, sfidë afatmesme është kompletimi i kornizës ligjore me miratimin e Ligjit për organet qeveritare të shoqërisë informative dhe Ligji për Dixhitalizim të transmetimeve radio difuzive tokësore. Ndërkaq, në aspektin operacional të politikave audiovizuale, sfidë mbetet miratimi i strategjisë për kalim nga sistemi analog në sistemin digjital të transmetimit.

Po ashtu, pavarësisht miratimit të Ligjit për RTK, sfidë kryesore vazhdon të mbetet qëndrueshmëria afatgjate për këtë transmetues të vetëm publik. Për më tepër, sa i përket sfidave që ndërlidhen me zhvillimet institucionale sektoriale janë ruajtja e pavarësisë dhe ngritja e kapaciteteve profesionale në ARKEP dhe KPM. Në anën tjetër, pamundësia e anëtarësimit të institucioneve të Kosovës në organizma ndërkombëtare për shkaqe politike vazhdon ta sfidojë sektorin e telekomunikacionit dhe politikave audiovizuele duke shkaktuar probleme në çështjet si marrja e kodit shtetëror për telefon, për internet si dhe shpërndarje të pamjaftueshme të spektrit frekuencor, përfshirë edhe transmetimet digjitale.

Në kontekst të nënshkrimit të MSA, Kosova përmes përafrimit të kornizës legislative në sektorin e telekomunikacionit dhe shërbimeve postare me acuzat komunitare do të përfshijë në veçanti: i) zhvillimin e mëtejshëm të aspekteve ligjore dhe rregullative për telekomunikacionin dhe shërbimet postare; ii) liberalizimin e shpejtë të sektorit; iii) nxitjen e një mjedisi miqësor për investuesit në modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit të Kosovës dhe integrimin në rrjetet Evropiane dhe botërore, iv) reformat institucionale të përshtatshme për një mjedis të liberalizuar. Sa i përket politikave audiovizuele, MSA-ja do të nxisë bashkëpunimin kulturor me synim që të forcojë kapacitetet e politikave kulturore të Kosovës, duke përforcuar kapacitetin e veprimeve kulturore si dhe rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë në mes të individëve, pakicave dhe njerëzve. Për më tepër, Kosova do të vë në linjë politikën dhe legjislacionin me ato të BE-së, duke përfshirë edhe transmetimet ndër kufitare dhe të drejtën e pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimet satelitore apo kablore. Ndërkaq, reformat e saj institucionale do të duhej të promovojnë diversitetin kulturor, lirinë e shprehjes, lirinë e fjalës, transmetuesi publik progresiv të përshtatshëm për një mjedis të liberalizuar, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe kapaciteteve të organeve rregullative. MSA-ja do të përfshijë gjithashtu edhe dispozitat e themelimit të parimeve të përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në Programet e BE-së siç është Programi Evropian i Kreativitetit.

Ndërkaq, për të përmbushur obligimet dhe përgjegjësit që rrjedhin nga MSA, Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet në agjendën e përafrimit të legjislacionit, implementimit efektiv të politikave dhe thellimit të reformave. Në kontekst të avancimit dhe përafrimit të kornizës legislative, Kosova do të miratojë Ligjin për Organet Qeveritare të Shoqërisë Informative dhe Ligjin për Dixhitalizim të Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore. Ndërkaq, me qëllim të implementimit të politikave në mënyrë efektive, Qeveria e do të zhvillojë dhe miratojë strategji sektoriale. Ndër të tjera, Qeveria do të miratojë dokumentin e Politikave për Sektorin e Komunikimeve Elektronike me qëllim të përcaktimit të prioritetëve, objektivëve dhe detyrave të zhvillimit të shoqërisë së informacionit duke maksimizuar përparësitë sociale dhe ekonomike që ofrojnë teknologjitë informative dhe komunikuese. Po ashtu, Qeveria do të miratojë edhe Strategjinë për Dixhitalizim si dokument themelor për kalimin nga sistemi analog në sistemin dixhital të transmetimit.

Megjithatë, përveç miratimit të legjislacionit dhe strategjive sektoriale si kushte primare, Qeveria do të angazhohet në ruajtjen e pavarësisë, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të rregullatorëve si ARKEP dhe KPM. Për më tepër, në këtë vijimësi angazhimesh, MZHE do të forcojë kapacitetet profesionale sa i përket koordinimit të politikave për shoqërinë informative dhe çështjet që rrjedhin nga Agjenda Digjitale e Evropës. Rrjedhimisht, përmes reformave institucionale, forcimit të kapaciteteve profesionale, dhe intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për të siguruar kodin shtetëror për telefon, domenin shtetëror për internet, dhe anëtarësimin në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), Kosova synon modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit,

integrimin në rrjetet Evropiane dhe pjesëmarrje aktive në programet e BE-së për sektorët përkatës.

3.7.7. Transporti

Në sektorin e transportit është miratuar një pjesë e konsiderueshme e legjislacionit sektorial duke shënuar një progres thelbësor sa i përket përafrimit të kornizës legjislative me *acquis communautaire*. Në këtë kontekst, disa nga ligjet esenciale të miratuara në fushën e transportit janë: *Ligji mbi Rrugët, Ligji për Sigurinë në Komunikacion Rrugor, Ligji për Aviacion Civil dhe Ligji mbi Hekurudha*. Më tej, me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative, janë miratuar një numër i konsiderueshëm aktesh nënligjore. Po ashtu, në funksion të hartimit të politikave efektive në fushën e transportit, Ministria e Infrastrukturës (MI) është duke rifreskuar dhe implementuar paralelisht Strategjinë e Transportit Multimodal. Me këtë strategji synohet të krijohet një ambient i përshtatshëm për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të transportit dhe kapaciteteve njerëzore.

Po ashtu, në ndjekje të modeleve evropiane të zhvillimit të hekurudhave, janë shënuar zhvillime pozitive me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani publike, përkatësisht ne InfraKos dhe TrainKos. Për më tepër, MI në konsultim të ngushtë me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), TrainKos-in dhe InfraKos-in ka miratuar Ekspozeun e Rrjetit për hekurudha për vitin 2013. Në këtë kontekst si rezultat i zhvillimeve pozitive institucionale është duke zbatuar korniza ligjore për hapjen graduale të tregut të transportit hekurudhorë.

Në anën tjetër, përmes përfshirjes aktive në Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), Kosova ka avancuar dukshëm në miratimin e standardeve të BE-së sa i përket aviacionit civil. Në këtë kontekst, MI dhe Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) kanë bërë hapa progresiv në miratimin e rregulloreve ekonomike dhe atyre të sigurisë, si kërkesa të drejtpërdrejta nga faza e parë e marrëveshjes së HPEA-së. Ndërkaq, me qëllim të përmirësimit të sigurimit të aviacionit civil Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka miratuar tri Programe Kombëtare për Sigurimin e Aviacionit Civil, dhe ka hartuar Manualin për Inspektorët e Sigurimit të Aviacionit Civil si dokument praktik i cili mundëson inspektorëve njohjen me teknikat bashkëkohore të hetimit. Si rezultat i angazhimeve koherente, Kosova ka kompletuar hartimin e legjislacionit nga faza e parë e marrëveshjes për HPEA, dhe është e gatshme për kalim në fazën e dytë të kësaj marrëveshje.

Sa i përket organizmit dhe përgjegjësive institucionale sektoriale, institucion kyç në sektorin e transportit është MI, ku përmes krijimit të politikave dhe zbatimit të ligjeve synon të kontribuojë në rritjen ekonomike duke mundësuar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme, mjedis ekologjik dhe integrim ndërkombëtar. Me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor, Qeveria ka themeluar Këshillin për Siguri në Komunikacionin Rrugor, si trup ndërinsticionale që udhëhiqet nga MI, dhe ka për synim që përmes aktiviteteve të përbashkëta dhe gjithëpërfshirëse të përmirësoj sigurinë dhe zvogëloj shkallën e aksidenteve në komunikacionin rrugor.

Ndërsa, në sektorin e hekurudhave MI përcakton politikat dhe harton legjislacionin duke ofruar orientimet strategjike për sfidat afatgjata me të cilat ballafaqohen hekurudhat, kurse ARH është organ përgjegjës për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor, përkatësisht

ARH vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit, organ për rregullimin e tregut dhe organ për sigurinë e hekurudhave.

Në fushën e aviacionit civil janë përgjegjës MI, MPB dhe AAC dhe Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHIAA). MI është përgjegjës për zhvillimin e politikave kombëtare për transportin ajror, dhe nxjerrjen e rregulloreve lidhur me ekonominë e transportit ajror. Ndërkaq, MPB është përgjegjëse për vendosjen dhe ruajtjen e sigurimit ajror. Në këtë kontekst është themeluar edhe Komisioni Kombëtar për Sigurimin e Aviacionit Civil si strukturë ndërinstitucionale që udhëhiqet nga MPB dhe ka për obligim të monitorojë zbatimin e legjislacionit dhe kuadrit ligjor të BE-së në fushën e sigurimit të aviacionit civil. Ndërsa, AAC është agjenci e pavarur rregullatore e cila është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil, rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Kosovë, përkatësisht të zbatojë legjislacionin e aviacionit civil duke i dhënë efekt politikave të miratuara nga Qeveria në fushën e aviacionit civil. Po ashtu, KHIAA është organ përgjegjës për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në transportin ajror dhe hekurudhor.

Megjithatë, edhe përkundër arritjeve substanciale, sektori i transportit ende ballafaqohet me sfida shumëdimensionale në procesin e integritetit evropian. Në këtë kontekst, sfidë afatmesme sa i përket avancimit të legjislacionit është amandamentimi i tri ligjeve (Amandamentimi i Ligjit Nr. 02/L-70 mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor; Amandamentimi i Ligjit Nr. 02/L-127 mbi Transportin Rrugor; Amendamentimi i Ligjit Nr. 2004/06 mbi Transportin e Mallrave të rrezikshme) dhe harmonizimi i mëtejme me *acquis communautaire*. Në kontekst më të gjerë, problemi i sigurisë në komunikacionin rrugor, përkatësisht shkalla e lartë e aksidenteve rrugore vazhdon të sfidojë MI dhe institucionet tjera përgjegjëse në këtë segment sektorial. Për më tepër, kapacitetet e kufizuara të inspektimit, automjetet e vjetra si dhe cilësia e ulët e infrastrukturës rrugore janë disa prej sfidave të cilat janë duke pamundësuar zbatimin e plotë të legjislacionit nga MI.

Në sektorin e hekurudhave, disa prej sfidave kryesore janë mungesa e investimeve, harmonizimi i mëtejme i çështjeve financiare në mes të InfraKos-it dhe TrainKos-it, si dhe fuqizimi i ARH-s me buxhet dhe trajnimi i stafit. Përkundër një varg të arriturash në sektorin e aviacionit, përmirësimi i kapaciteteve për sigurimin e aviacionit civil që menaxhohet nga MPB vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore. Ndërkaq, pengesat politike për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Kosovës në institucione të ndryshme ndërkombëtare janë sfidat kryesore sa i përket avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin e transportit që njëkohësisht po ndikojnë negativisht edhe në zbatimin e legjislacionit dhe përmbushjen e standardeve të BE.

Në kontekst të avancimit të marrëdhënieve me BE, përkatësisht nënshkrimit të MSA, Kosova do të kontribuojë në ristrukturimin dhe modernizimin e sistemeve të transportit dhe përmirësimin e infrastrukturës përkatëse, duke përmirësuar lëvizjen e lirë të udhëtarëve dhe të mallrave, dhe duke arritur standarde të krahasueshme me ato që mbizotërojnë në BE, duke e përshtatur legjislacionin e transportit me BE-në, dhe duke mundësuar qasje të avancuara dhe reciproke në tregjet e transportit në mes BE-së dhe Kosovës.

Në anën tjetër, për të përmbushur obligimet dhe përgjegjësit që rrjedhin nga MSA, Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet për kompletimin e kornizës ligjore në harmoni me *acquis communautaire*, balancimin e investimeve me prioritetet strategjike dhe forcimin e kapaciteteve profesionale. Në

këtë drejtim, Kosova do të miratoj ligjin mbi Agjencinë e Navigacionit Ajror (ANA), me të cilin ligj do të garantojë menaxhim profesional dhe pavarësi të plotë të ANA. Ndërkaq, në funksion të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sektorit të transportit, institucionet përgjegjëse do të marrin masa konkrete në drejtim të zbatimit të plotë të legjislacionit të miratuar.

Në rrafshin operacional, me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve dhe përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor, Qeveria do të miratoj strategjinë për siguri në komunikacionin rrugor. Ndërkaq, sa i përket orientimit të politikave strategjike, përmes realizimit të projektit të R7 si dhe fillimit të zbatimit të projektit të R6, Qeveria do të vazhdoi të përmirësoj infrastrukturën rrugore si faktor përcaktues i nxitjes së mëtejme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Në anën tjetër, me qëllim të balancimit të investimeve në sektorin e transportit, Qeveria do të intensifikoj përpjekjet që strategjinë aktuale të investimeve në ndërtimin e rrugëve të reja ta plotësoi me investime adekuate edhe në sektorët tjerë, veçanërisht përfshirje më të lartë do të këtë sektori i hekurudhave. Rrjedhimisht, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet prioriteteve afatgjata nga fusha e transportit siç janë ristrukturimi dhe modernizmi i sistemeve të transportit si dhe integrimi i plotë i Kosovës në rrjetin rajonal dhe evropian të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Sa i përket zhvillimeve institucionale në sektorin e transportit, përkatësisht në fushën e aviacionit civil, pritet që brenda një afati sa më të shkurt kohor AAC të çertifikoji Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (OShNA). Për më tepër, Qeveria në vijimësi do t'i forcoj dhe zhvilloj kapacitetet administrative dhe profesionale përmes thellimit të reformave institucionale duke bërë që institucionet përgjegjëse të jenë të përgatitura për të menaxhuar dhe koordinuar në mënyrë sa më të suksesshme sfidat e procesin të integritimit në BE.

3.7.8. Energjia, përfshirë sigurinë bërthamore

Sektori i energjisë është i rregulluar sipas legjislacionit, politikave dhe institucioneve përkatëse. Kosova ka kornizën ekzistuese legjislative të energjisë në përputhje me pakon e dytë të ligjeve të BE-së dhe obligimeve ndaj Komunitetit të Energjisë (KE). Kjo kornizë përmban gjashtë ligje kyçe, siç janë: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Eficiencën e Energjisë, Ligji për Gazin Natyror dhe Ligji për Ngrohjen Qendrore. Këto ligje synojnë rregullimin e sektorit, gjegjësisht përcaktojnë parimet dhe rregullat e të gjitha aktiviteteve brenda sektorit. Përpos energjisë, përparim të përafritimit është shënuar edhe në fushën e sigurisë bërthamore me miratimin e Ligjit në fuqi për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore, ligj ky që synon realizimin e normave dhe konventave ndërkombëtare të këtij lëmi si dhe krijimin e një mjedisi të shëndoshë.

Qeveria e Kosovës mbetet e angazhuar drejt zhvillimit të këtij sektori me rëndësi vitale për zhvillim të gjithëmbarshtëm të vendit, duke konsideruar në të njëjtën kohë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Andaj, duke pasur bazë këto, përpos kornizës ligjore, janë aprovuar edhe Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018, dhe Strategjia e Ngrohjes së Republikës së Kosovës 2011-2018 ku përcaktohen politikat që përkasin me zhvillim të sektorit të energjisë.

Strategjia e energjisë orienton zhvillimin e politikave më të përshtatshme për shndërrimin sa më parë të këtij sektori në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetëfinancueshëm që ofron shërbime cilësore energjetike ekonomikisht të favorshme për konsumatorët. Po ashtu identifikon politikat dhe masat kryesore që duhet të ndërmerren për avancimin e reformave në sektor për ta mundësuar kështu tërheqjen e investimeve private dhe integrimin sa më të plotë dhe më të

shpejtë të sistemeve energjetike të Kosovës me ato rajonale dhe evropiane. Strategjia e Ngrohjes ka për synim të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ngrohjes duke u bazuar në shfrytëzimin racional dhe eficient të burimeve të energjisë, veçanërisht burimeve natyrore të energjisë në mënyrë që të arrihet furnizim i qëndrueshëm dhe cilësor i ngrohjes së hapësirave dhe ujit sanitar për konsumatorët, e në të njëjtën kohë duke mbrojtur mjedisin. Përpos strategjive, Kosova ka edhe dy Plane Nacionale kyçe, atë të Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.

Duke konsideruar që sektori përket me çështje komplekse, kërkohet një strukturë institucionesh, si qeveritare ashtu dhe rregullative për hartim, monitorim dhe zbatim të legjislacionit dhe politikave. Kjo strukturë është e themeluar dhe është funksionale, dhe udhëhiqet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), pasuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). Drejt zhvillimit të sektorit, në veçanti fushës së eficiencës së energjisë dhe sigurisë bërthamore tanimë janë themeluar Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE) dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRrSB). Përpos këtyre, në sektorë operojnë edhe ndërmarrjet siç janë Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), dhe Distribucioni dhe Furnizimi i Energjisë Elektrike (KEDS), si dhe kompanitë në operim për ngrohje qendrore, Termokos-i në Prishtinë, Ngrohtorja e qytetit në Gjakovë, Termomit në Mitrovicë dhe Ngrohtorja në Zvečan.

Kosova, edhe me progresin e fundit që ka shënuar, ka ende për të bërë drejt përmbushjes së obligimeve drejt MSA-së, e në rend të parë është përgatitja për implementimin e pakos së tretë të legjislacionit të tregut të brendshëm të energjisë nga viti 2015 e tutje. Transpozim të mëtutejmë të acquis mbetet të bëhet edhe në fushën e sigurisë bërthamore duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, përfshirë edhe legjislacionin sekondar. Obligime tjera duhet përmbushë edhe në implementimin e rregullave të BE-së mbi rezervat e obligueshme të naftës, si dhe integrimin në rrjetat energjetike të BE-së. Megjithatë, përpos sfidave në kornizën legjislative, sfidë tjetër mbetet edhe fuqizimi dhe funksionalizimi i institucioneve të sektorit, apo më saktësisht fuqizimi i ZRrE-së me resurse, kompletimi i AKMRrSB-së me zyrtar, dhe kompletimi me staf i AKEE-së. Përpos këtyre, Kosova mbetet t'i përmbushë edhe obligimet që ka ndaj TKE-së, siç është vazhdimi me zhvillimin dhe ristrukturimin e sektorit, përkatësisht zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të cilat edhe mundësojnë mbylljen e termocentralit Kosova A, si dhe shthurjen dhe privatizimin e mëtutjeshëm sipas rregullave të Komunitetit të Energjisë.

Bashkëpunimi për MSA në mes Kosovës dhe BE-së në fushën e energjisë do të duhej të konsiderojë parimet e ekonomisë së tregut dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Bashkëpunimi do duhej në veçanti të përqendrohet në formulimin dhe planifikimin e politikave energjetike, përmirësimin e interkoneksioneve dhe modernizimin e infrastrukturës, krijimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike, përmirësim dhe ofroj diverzitet në furnizim me energji, menaxhim më të mirë të shërbimeve të energjisë elektrike, fuqizimin e rolit të rregullatorit, përmirësimin e menaxhimit të kërkesës, zhvillimin e burimeve energjetike dhe energjinë e ripërtërishme, promovimin e ruajtës dhe eficiencën e energjisë, promovimin e sigurisë bërthamore dhe menaxhimin e mbeturinave bërthamore.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimi*, korniza ligjore dhe rregullative në fuqi, gjegjësisht pesë ligjet e lartpërmendura do të plotësohen në përputhje me pakon e tretë për energji të BE-së, e cila duhet filluar me implementim nga viti 2015; do të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, e po ashtu edhe sektori i derivateve do të rregullohet me miratimin e Ligjit të Ri për tregti me naftë dhe produkte të naftës që do të mundësojë fillimin e implementimit të rregullave të BE-së mbi rezervat e obligueshme. Më tutje, Qeveria e Kosovës do të miratoj legjislacionin sekondar që përket me transpozimin e mëtutjeshëm të këtyre tre fushave. Që këto zhvillime të mund të kryhen me përpikëri, institucionet e sektorit do të themelohen, fuqizohen si dhe funksionalizohen duke ngritur kapacitetet e tyre profesionale dhe resurseve. Thënë më saktësisht, themelimi i operatorit për menaxhim të mbeturinave bërthamore, si dhe themelimi i divizionit për rezerva obligative të naftës në kuadër të MTI-së . Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Agjencioni për Siguri Bërthamore dhe ai për Eficiencë të Energjisë do të kompletohen me zyrtarë të ri dhe ngritje të kapaciteteve dhe resurseve. Ristrukturimi i sektorit do të vazhdojë duke përfshirë vazhdimin e projektit të TC Kosova e Re si dhe zhvillimin e kapaciteteve të BRE-ve në gjenerimin e energjisë elektrike. Që të mund të realizohet furnizimi nga këto burime dhe integrimin në rrjetin e BE-së, do të vazhdohet me përmirësimin e infrastrukturës së transmissioinit duke ngritur kapacitetet e transmissioinit në të tre nivelet.

3.7.9. Mjedisi

Në sektorin e mjedisit është miratuar një pjesë e konsiderueshme e legjislacionit sektorial duke shënuar një progres substancial sa i përket përafrimit të kornizës legjislative horizontale me *acquis communautaire*. Në këtë kontekst, disa nga ligjet thelbësore të miratuara në fushën e mjedisit janë: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Ligji i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, dhe Ligji për Mbeturina. Më tej, është vendosur korniza ligjore për zbatimin e standardeve të BE-së për cilësinë e ajrit. Po ashtu, në funksion të hartimit të politikave efektive në fushën e mjedisit, MMPH është duke rifreskuar dhe implementuar paralelisht Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit. Me këtë strategji synohet përmirësimi i gjendjes së mjedisit duke ndjekur parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, për të kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së popullatës. Krahas progresit të shënuar në legjislacion, duhet theksuar faktin që institucionet përgjegjëse për implementimin e politikave kanë arrit të ndalojnë operimin e gurëthyesve ilegal dhe ndalimin e eksploatimit të materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve duke rehabilituar dhe përmirësuar gjendjen e tyre.

Sa i përket organizmit dhe përgjegjësive institucionale sektoriale, institucionet përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe implementimin e legjislacionit në fuqi dhe politikave mjedisore, janë të themeluara dhe funksionale. Institucioni kyç për politikën mjedisore është MMPH e cila përkrahet nga AMMK- përgjegjëse për monitorimin e mjedisit, mbledhjen e të dhënave mjedisore dhe raportimin e tyre, që me kapacitetet e tyre administrative, si pjesë e shumë aktiviteteve tjera përgatisin raportet vjetore për gjendjen e mjedisit, natyrës dhe raportet tjera sektoriale në territorin e Kosovës. Vitet e fundit MMPH ka rritur edhe numrin e inspektorëve me qëllim të adresimit të sfidave në implementimin e politikave mjedisore. Ndërsa si organ i pavarur për rregullimin e shërbimeve për ujësjellës dhe kanalizim është Zyra Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim (ZRRUK).

Përkundër arritjeve substanciale, sektori i mjedisit ende ballafaqohet me sfida shumë dimensionale në procesin e integritimit evropian. Në këtë kontekst, megjithëse buxheti për këtë

sektor është rritur gjatë dy viteve të fundit, ai është ende i ulët dhe i pamjaftueshëm për të zbatuar politikat për mbrojtjen e mjedisit. Për më tepër, buxheti i ulët për këtë sektor, e vështirëson edhe procesin e miratimit të strategjive sektoriale. Edhe përkundër faktit që legjislacioni horizontal është pothuajse tërësisht i transpozuar, sfidë mbetet zbatimi i legjislacionit që është në fuqi, si në rastin e implementimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ku cilësia e raporteve ende mbetet e dobët dhe kërkon përmirësim. Ngritja e kapaciteteve institucionale, administrative dhe njerëzore është një nga sfidat më të rëndësishme për të mundësuar implementimin e standardeve evropiane. Sfidë tjetër e rëndësishme në këtë sektor është përfshirja dhe harmonizimi i politikave mjedisore dhe klimatike në politikat e sektorit të energjisë, transportit, industrisë, bujqësisë dhe në sektorin e arsimit (edukimi mjedisor).

Ndër të tjera, sfiduese mbetet transpozimi i legjislacionit për ndryshime klimatike si dhe përpilimi i dokumenteve nacionale siç janë: Strategjia për Ndryshime Klimatike, plani kombëtar për zbutjen e ndryshimeve klimatike, kompletimi i inventarit me të dhënat e gazërave serrë nga të gjithë sektorët, sfidë kjo e cila do merr kohë për tu adresuar.

Sipas MSA-së, Kosova duhet të forcoj bashkëpunimin e saj me BE-në në luftën kundër përkeqësimit të mjedisit me theks në kualitetin e ajrit dhe ujit, menaxhimit të mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, mbikëqyrjen dhe zvogëlimin e shkarkimeve industriale, promovimin e efikasitetit të energjisë dhe sigurisë në të gjitha stabilitetet industriale, mbrojtjen e tokës, klasifikimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve dhe planifikimin urban.

Bashkëpunimi sipas MSA-së do të përdoret gjithashtu për të zhvilluar politikën e Kosovës për klimën dhe për të ndihmuar përfshirjen e Kosovës në përpjekjet globale për të zbutur dhe adaptuar me ndryshimin e klimës. Një bashkëpunim me i ngushtë do të ndihmonte Kosovën në miratimin e legjislacionit të nevojshëm si dhe krijimin e një organizimi të duhur administrativ. Kjo do të ndihmojë Kosovën në përfshirjen e rrjedhave në energjetikë, transport, industri, bujqësi dhe politikat e arsimit.

Në anën tjetër, për të përmbushur obligimet dhe përgjegjësit që rrjedhin nga MSA, Kosova duhet të intensifikoj përpjekjet për kompletimin e kornizës ligjore në harmoni me *acquis communautaire*. Në këtë drejtim, Kosova do të miraton një numër të konsiderueshëm të ligjeve, ndër më të rëndësishmit: Projektligji për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit; Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesve të ujit me shumicë; Projektligjin për Eko-fondin, i cili do mundëson investimet kapitale për implementimin e politikave mjedisore; Projektligjin për Ujërat e Kosovës; Projektligjin për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, me qëllim të fuqizimit të inspektoratit i cili do monitoroj zbatimin e politikave mjedisore; Projektligjin për Planifikim Hapësinor; etj. Gjithashtu, fusha e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së do të plotësohet me miratimin e Strategjisë së Përafrimit të legjislacionit mjedisor dhe planit të investimeve në këtë sektor. Me qëllim të përmirësimit të politikave sektoriale, Qeveria do të miratoj strategjitë dhe planet e veprimit të cilat rregullojnë fushën e ajrit, menaxhimit të mbeturinave, ujit, pellgjeve lumore dhe planet hapësinore e urbanistike.

Në rrafshin operacional, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit në Kosovë, institucionet përgjegjëse do të funksionalizojnë plotësisht rrjetin për monitorimin e cilësisë së ajrit, duke harmonizuar të dhënat dhe duke ngritur edhe cilësinë e raportimit të të dhënave mjedisore, si dhe do të funksionalizoj shtatë impiantet për sterilizimin e mbetjeve infektive

spitalore. Krahas kësaj, Qeveria do të krijon strukturat vendimmarrëse dhe programet e nevojshme për mbrojtjen e ujit të pijshëm, monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nën tokësore duke realizuar studimet e fizibilitetit në disa qendra të Kosovës për trajtimin e ujërave të zeza. Për më tepër, Qeveria në vijimësi do t'i forcoj dhe zhvilloj kapacitetet administrative dhe profesionale në nivel qendror dhe lokal, duke bërë që institucionet përgjegjëse të jenë të përgatitura për të menaxhuar dhe koordinuar në mënyrë sa më të suksesshme sfidat e procesit të integritit në BE.

3.8. Bashkëpunimi financiar

Kosova ka përmirësuar dukshëm strukturat për bashkëpunim financiar dhe është rritur kapaciteti i institucioneve të Kosovës për koordinimin e asistencës së jashtme. Në vitin 2011, është miratuar një rregullore për koordinimin e donatorëve, e cila përcakton përgjegjësitë e institucioneve në këtë proces.

Ministria e Integritit Evropian është institucioni kryesor për koordinimin horizontal, ndërsa janë themeluar strukturat e nevojshme për koordinimin e donatorëve në tri nivele: Forumi i Nivelit të Lartë ku përfshihet niveli më i lartë politik, grupet punuese sektoriale dhe grupet punuese nënsektoriale për koordinimin e donatorëve, të cilat mbajnë takime të rregullta. Gjatë programimit të IPA 2012 dhe IPA 2013, është përmirësuar cilësia dhe niveli i përgjithshëm i programeve dhe është rritur fokusi i asistencës financiare në sektorë të veçantë. Ministria e Integritit Evropian ka rritur kapacitetet e saj për të bërë përzgjedhjen e programeve dhe projekteve për financim nga asistenca e BE-së dhe nga donatorët e tjerë. Sa i përket komponentit të IPA për Bashkëpunimin Nderkufitar (BNK), Kosova merr pjese në tri programe të Bashkëpunimit Nderkufitar me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Me të tri këto shtete janë nënshkruar marrëveshjet financiare bilaterale për implementimin e programit BNK 2011. Strukturat e përbashkëta operative janë krijuar për programet me Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe është në fazën finale edhe krijimi i tyre me Malin e Zi. Programi me Shqipërinë ka filluar të implementohet. Institucioni kyç për implementimin e këtyre programeve është Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal e cila edhe ka rolin kyç në punën e strukturave të përbashkëta operative nga ana e Kosovës për këto programe.

Shuma e alokuar nga BE-ja për Kosovën, në kuadër të asistencës financiare të dhënë si pjesë e IPA-s, për programet 2007-2013, arrin mbi 630 milionë euro.

Megjithëse ka pasur përmirësim të vazhdueshëm në drejtim të bashkëpunimit financiar, sfida kryesore mbetet planifikimi i pamjaftueshëm i politikave dhe ndërlidhja e asistencës financiare me politikat shtetërore. Vështirësia kryesore qëndron në mungesën e një kornize të përgjithshme orientuese për politikat shtetërore, e cila do të integronte politikat e veçanta sektoriale dhe prioritetet e financuara nga asistenca e jashtme.

Masat për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Kosovën do të parashihet përkrahje të vazhdueshme financiare nga BE-ja për të ndihmuar Kosovën që të arrijë objektivat e kësaj marrëveshjeje. Një asistencë e tillë do të mund të fokusohet më tutje në fushat e ndryshme të përafrimit të legjislacionit dhe politikave të bashkëpunimit të mbuluara nga MSA.

Me qëllim të përmbushjes së *kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit*, institucionet Kosovës duhet të vazhdojnë të përmirësojnë kapacitetet për planifikim dhe programim të asistencës së BE-së, nëpërmjet mbajtjes së trajnimeve për stafin përgjegjës. Per implementimin efektiv te programeve te bashkëpunimit ndërkufitar, jane parapre aktivitetet e nevojshme per implementimin e projekteve te programit, aktivitetet lidhur me monitorimin e implementimit te programeve, dhe funksionalizimi i strukturave perkatese per kete qellim (me Malin e Zi dhe Maqedonine). Gjithashtu, duhet të intensifikohen përpjekjet për koordinimin efektiv të donatorëve, nëpërmjet mbajtjes së takimeve të strukturave për koordinimin e donatorëve dhe përfshirjes së prioritetëve të financuara nga donatorët në dokumentet strategjike qeveritare dhe proceset buxhetore. Institucionet e Kosovës në veçanti duhet të rrisin ndërlidhjen e asistencës së jashtme me prioritetet që dalin nga procesi i stabilizim-asociimit me BE-në.

	Veprimi	Indikatorët e Outputit(Treguesit e Produktit)	Afati	Institucioni Pergjegjes	Institucioni Mbeshtetës	Dokument Referuese	Totali	BKK	Donatorët	Zbrazëtira
	1. KRITERET POLITIKE									
	1.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit									
	1.1.1. Legjislacioni									
	Te forcohen parimet demokratike te qeverisjes. Te respektohen parimet e ligjeve nderkombetare dhe sundimit te ligjit ne pergjithesi.									
1	Te perfundohet reforma zgjedhore duke marre parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian si dhe praktikrat me te mira nga BE	1. Amandamenti i Kushtetutes, i miratuar 2. Plotsim-ndryshimi i Ligjit per Zgjedhjet ne pajtim me rekomandimet e KE-se 3. Ligji mbi financimin e partive politike, i rishikuar	K4-2013	Kuvendi	KQZ					
2	Te perforcohet kapaciteti administrativ dhe legjislativ i Kuvendit, vecanerisht Departamentit Ligjor dhe per Ceshtje Procedurale, si dhe te permiresohet procedura legjislative per te siguruar ekspertize legjislative dhe perputhshmeri me Acquis	1. Projektligji mbi statusin e shërbyesve civil të administratës së Kuvendit, i miratuar 2. Plani strategjik per menaxhimin e burimeve njerezore, i miratuar 3. rregullorja e re e Kuvendit, e miratuar 4. Numri i stafit te rekrutuar ne pajtim me Rregulloren per Pergjegjesite dhe Organizimin e	K4-2013	Kuvendi						

		Administrates se Kuvendit ne Departamentin Ligjor dhe per Ceshtje Procedurale 5. Numri i trajnimeve								
3	Te permiresohet koordinimi dhe planifikimi i perbashket mes Kuvendit dhe Qeverise	1. Koordinatorët për harmonizimin e agjendes legjislativë nga Kuvendi dhe Qeveria, të emëruar 2. Plani legjislativ i harmonizuar në mes të Qeverisë dhe Kuvendit	K1-2013	Kuvendi	ZKM					
4	Kuvendi të përforcojë funksionet mbikeqyresë ndaj ekzekutivit	1, Numri i raportimeve me shkrim nga Ekzekutivi 2. Numri i interpelancave 3. Numri i raporteve të Kuvendit, mbi vlerësimin e implementimit të legjislativës 4. Numri i raporteve të institucioneve të pavaruara të shqyrtuar dhe miratuara nga Kuvendi	K4-2013	Kuvendi	ZKM					
5	Te sigurohet llogaridhenja dhe shqyrtimi I shpenzimeve te buxhetit te Kuvendit pergjate vitit fiskal	1. Numri i Raporteve për shpenzim të buxhetit të Kuvendit, të shqyrtuara në Komisionin Parlamentar për Buxhet	K4-2013	Kuvendi						

		dhe Financa								
6	Te konsultohet Kuvendi gjate procesit te modifikimit te draft buxhetit te tij, para se te dergohet per miratim ne Kuvend	1. Propozim buxheti per 2013-2014 ne harmoni me ligjin per menaxhimin e financave publike	K4-2012	Kuvendi	ZKM MF					
	<i>1.1.2. Ekzekutivi dhe presidenti</i>									
Te respektohen dhe te implementohen parimet demokratike te qeverisjes. Te sigurohet nje ekzekutiv me efikas dhe me i pershtatshem ne te gjitha nivelet e administrates.										
